

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

949.65.083

17140



# *KURVELESH ZEMRA IME*

Xhafer Matuka

949.65.088

1140

S


XHAFER MATUKA

# KURVELESH ZEMRA IME

(Memo Meto)



SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT POLITIK



Memo Meto



## TRI TË SHTËNA PUSHKE

Një natë janari të vitit njëmijë e nëndëqind e dhjetë në fshatin Kuç të Kurveleshit u dëgjuan tri të shtëna pushke. Një burrë me moshë të thyer, që e kishte shtëpinë pak më larg nga të tjerët, doli shpejt jashtë e po shikonte. Ai në fillim hodhi sytë nga disku i artë i hënës, i cili vazhdonte qetë rrugën e tij përmes kupës së kthjellët të qiellit, se mos qe përgjakur. Kur ai u bind se hëna shkëlqente me tërë bukurinë e saj, u kthye e mbajti vesh se mos në ndonjë-rën nga kopetë e fshatit kishte rënë egërsira. Po prapë s'dëgjoi asgjë.

Burri i moshuar e dinte se pushkët në fshat nuk hidheshin kot. Ato hidheshin kur kishte rrezik dhe jepej kushtrimi për t'u mbledhur me armë, kur errësohej dhe përgjakej hëna, kur binte egërsira në kopetë e bagëtive, si dhe kur në fshat lindte ndonjë djalë...

— Ç'është ashtu more, pse qëlloni? — thirri burri i moshuar dhe zërin e tij gryka e malit që qe afër e bëri më të fuqishëm dhe e shpuri larg e më larg...

— Ç'ka ndodhur, more? — u dëgjua edhe një thirrje tjetër nga lagjja tjetër e fshatit.

Heshtje. Pastaj prapë pyetje. Nata ishte e qetë. Herë-herë veriu shkundte me një zhurmë të thatë



degët e zhveshura të pemëve. Në përgjegje të shumë pyetjeve, që nga grumbulli i shtëpive ku u hodhën pushkët, u përhap një zë i fortë:

— Meto Durros i lindi djalë!

Burri i moshuar, që rrinte në pritje të merrte vesh shkakun e armëve, mbushi mauzerin, që mbante në të dyja duart, dhe, para se sa të tërhiqte gishtin, thirri me sa zë që kishte:

— T'i rrojë dhe të bëhet trim, more, trim!

Krisma e pushkës u dëgjua bashkë me zërin e tij.

Meto Durros i kishte lindur djali i tretë.

Atë natë, në dhomën ku qe lehona, u bë zhurmë e madhe. Gratë përpiqeshin për të qetësuar lehonën. Dikush i rrinte asaj te koka dhe herë pas here ftohte një peshqir në ujë dhe ja vinte mbi ballin që avullonte nga djersët, dikush ngrohte ujët që duhej për larjen e foshnjës.

Fëmijën e priti një grua në moshë mesatare.

Foshnja filloi të qante me të madhe. Mamisë i bëri përshtypje shëndeti i mirë i të porsalindurit dhe veçanërisht flokët e tij të gjatë. Ajo grua kryente detyrat e mamisë prej kohësh dhe kishte qenë edhe në shumë lindje të tjera, po foshnjë kaq të shëndoshë dhe me ata flokë aq të gjatë e të zez kishte parë rrallë.

— Djalë! — dëgjoi lehona të thonë nëpër shtëpi.

— Djalë! — i pëshpëriti asaj dikush te veshi.

Mëmës ja kishte qejfi që, pas dy djemve, të kishte edhe një vajzë dhe për këtë po mendohej, kur dëgjoi tri të shtënat e pushkës që ranë njëra pas tjetrës aty mbi qoshen e shtëpisë.

Kur djali mbushi javën, sipas zakonit u bë darka për vënjen e emrit, në të cilën u ftuan miqtë më të

afërt dhe vëllezëria. Dhomat e mëdha u mbushën plot me njerëz. Andej nga burrat vazhdonte rakia dhe biseda me zë të lartë.

Mëma e kishte mbështjellë foshnjën në gji dhe po priste t'i thoshin emrin e vogëlushit të saj.

Biseda po zgjatej, zhurma po shtohej.

— Ç'thonë për emrin? — pyeti ajo një nuse, e cila shërbente në dhomën e burrave.

— Akoma.

Pas pak më plaku vendosi.

— Memo, ja vunë emrin, — i tha nusja lehonës.

Mëma e mbështolli më fort foshnjën dhe e puthi. Ndryshe nga emrat e dy djemve të tjerë, asaj ky emër i pëlqeu më shumë. Ajo kishte dëshirë, që djemtë e saj të kishin emra, të cilët i mbanin ose i kishin mbajtur burra të tjerë të njohur si trima dhe të zotë. Dëshironte që emrat e djemve të saj të njiheshin si emra të përmendur për mirë. Dhe tani, kur i thanë si do të quhej djali i tretë, ju kujtua se kishte dëgjuar për një trim që kishte mbajtur këtë emër.

«Memo është emër i mirë, e gëzofsh dhe u bëfsh trim!» — i pëshpëriti ajo foshnjës dhe, pasi e mbështolli mirë, e shtrëngoi në gji.



## I. FËMIJNI E HIDHUR

Memo Metua lindi në një familje me gjendje të mirë ekonomike dhe të njohur për ndjenja patriotike.

Mëma e tij, Filja, nga familja e Sinan Banush Gerveshit, prej Nivicës së Kurveleshit, qe një grua e bukur, e dashur dhe e sjellshme me të gjithë. Filja punonte pa u lodhur për të mbajtur në rregull shtëpinë, fëmijët, djersitte edhe në arë, edhe në stan. Cilësitë e saj si grua e mënçur, punëtore dhe mëmë e mirë, ajo i tregoi kur i vdiq i shoqi dhe i mbeti mbi supe barra e mbajtjes së shtëpisë dhe e rritjes së katër fëmijëve të vegjël, që i mbetën jetimë.

Tregojnë se Filja, veç cilësive që u thanë më lart, kishte edhe aftësinë për të mbajtur mend ngjarje dhe episode nga e kaluara luftarake e popullit, këngë trimërie dhe përralla nga më të ndryshmet. Ajo, mbrëmjeve, kur fëmijët mbaronin së ngrëni bukë, i mblidhte rreth vatrës dhe u tregonte nga ato që dinte. Nëpërmjet gojës së saj në fantazinë e fëmijëve hynë bëmat dhe trimëritë e Gjolekës, Hodo Nivicës, dymbëdhjetë Bilbilejve, lufta me kuçedrën që i kishte zënë ujët popullit e të tjera...

I ati i Memos, Meto Durrua, qe një burrë i urtë, i patrazuar në punët e të tjerëve, i mënçur e punëtor.



Ai rriste bagëti dhe merrej me punimin e tokës. Memua që një baba i mirë, që mundohej t'i edukonte fëmijët që në vogëli me virtyte të mira dhe sidomos me dashurinë për punën.

Memua lindi më 1 janar 1910 në një kohë të turbullt. Në Shqipëri ziente lufta për pavarësi. Pas shpalljes së pavarësisë filluan përpjekje nga ana e shteteve shoviniste për t'i zënë vendin Turqisë së mundur dhe lufta e vendosur e patriotëve për ta mbrojtur lirinë e fituar me gjak e sakrificë. Të gjitha këto nuk ndjeheshin vetëm në shkallë kombëtare, por edhe në çdo krahinë, në çdo fshat, në çdo shtëpi.

Memua ishte katër vjeç kur familja e tij, ashtu si gjithë familjet e tjera të fshatit, e detyruar prej ushtrive shoviniste greke, u largua drejt fshatrave të Mesaplikut. Atë e kishin vënë mbi samarin e një mushke të ngarkuar me plaçka. Djali i vogël, duke mbajtur në dorë një shufër shelgu, me të cilën herë pas here godiste mushkën për të ecur sa më shpejt, habitej me karvanin e gjatë të muhaxhirëve, që ecte si rrëke që zbret nga mali. Pamje e dëshpëruar. Fëmijët qanin nga uria, pleqtë mbeteshin në vend nga lodhja dhe të pangrënët, gratë e helmuara nga humbja e vendit dhe e pasurisë, me shamitë e zeza të shtrënguara për gushe, ecnin me durim drejt fshatrave të pashkelura nga armiqtë. Burrat kishin mbetur e po luftonin kundër shkelësit.

Familja e Memos u vendos në fshatin Gjormë, në një shtëpi mikpritëse, e cila e priti me bujari dhe ndau kafshatën e bukës bashkë me të për tërë kohën që qëndroi aty.

Pasi kaloi furtuna e luftës, familja e Memos u shpërngul për disa muaj në Borsh, ku kishte shpresë se do të gjente bagëtinë e humbur, dhe nga fundi i

vitit 1915 u vendos përfundimisht në fshatin Kuç.

Kjo qe kohë e vështirë. Bukë s'kishte, bagëtia pothuajse qe dëmtuar krejt, shtëpitë qenë djegur, pemët qenë prerë të gjitha. Kudo shikoje ara të papunuara dhe të mbuluara nga barërat dhe gjembat.

Familja e Memos qe varfëruar e shkatërruar ekonomikisht. I ati i tij nuk kishte mundësi që të ndërtonte më shtëpi në fshat, prandaj ngriti shpejt e shpejt një kasolle në një arë rrëzë malit të Kunjovës dhe aty, larg fshatit, vendosi familjen.

Të gjithë jetonin të uritur, po fëmijët e vegjël, të cilët nuk e kuptonin as skamjen dhe as arësyet e saj, ngjiteshin pas mëmës së tyre dhe i kërkonin bukë. Bukë e jo gjë tjetër!

Po ku ta gjente Filja bukën? Ajo lidhte përmezi futën dhe dilte nëpër ara e troje për të mbledhur lakra të egra, labote, hithëra, shtërpinj, që pasi i ziente me ujë e kripë, ua jepte fëmijëve. Kënaqësi e madhe qe për mëmën, kur ajo mundte të siguronte një grusht miell thekre apo misri, që e trazonte me barishtet.

Pas luftës, në fshat u përhap epidemia e gripit. Sëmundja bëri kërdrinë. Të gjallët nuk po ia dilnin dot të varrosnin kufomat.

Memua i vogël po shikonte të atin, i cili po dergjej në qoshe të kasolles, duke rënkuar e duke u tretur. Pastaj, ai pa edhe kur e varrosën atë që kishte qenë shtylla e shtëpisë. Vdekja e kryetarit të familjes e keqësoi edhe më tepër gjendjen ekonomike. Tani Filja duhej të punonte shumë më tepër për të mbajtur dhe rritur tre djemtë e vegjël dhe vajzën e mitur.

Një ndër ato ditë Filja mblodhi rreth vetes fëmijët. Megjithëse ajo qe e re, ishte dobësuar aq shumë saqë qe ndërruar fare; sytë i qenë zmadhuar, fytyra i qe zverdhur, lëkura e duarve i qe holluar dhe ngji-



tur pas eshtrave. Gjendjen e saj të rëndë e kuptonte vetëm djali i madh, i cili qe më i məkëmbur nga të tjerët.

Atë ditë Memua kërkoi t'i jepnin për të ngrënë, po, pasi s'i dhanë gjë, qau e bëri zhurmë. Vëllai i madh e thirri të dilte jashtë, e hoqi mënjanë dhe i tha:

— E do ti mëmën?

— E dua shumë.

— Ajo do të vdesë, — vazhdoi ai me kokë të ulur e me lot në sy.

Memos ju drodh zemra nga fjala e tmerrshme që dëgjoji. Megjithatë pyeti:

— Pse?

— Sepse ajo s'ka të hajë dhe ti s'e lë rehat, duke i kërkuar bukë.

Edhe Memos ju mbushën sytë me lot.

— Po sikur të mos kërkoi më bukë do të vdesë? — e pyeti ai.

— Jo!

Memua u kthye në kasolle, u ul pranë të ëmës dhe po e shikonte atë në sy. Megjithëse i vogël e kuptonte domethënjen e atyre fjalëve që i tha i vëllai. Memua, që atë ditë u dha fund përkëdheljeve dhe bashkë me to edhe fëmijnisë. Tani ai vetë mundohet të bënte diçka për të ushqyer veten dhe të tjerët. Memua nuk i kërkonte më për të ngrënë së ëmës, po, ashtu si bënëin edhe dy vëllezërit e tjerë, hidhte një trastë në sup dhe dilte tutje për të mbledhur ç'të gjente.

Pas vdekjes së të shoqit, Filja bëri si bëri dhe me ndihmën e fshatarëve e të të afërmve mundi të largohej nga kasollja ku banonte në arë larg fshatit dhe të vendosej në një haur pranë familjeve të tjera.



Me gjithë të këqiat që i kishin zënë, fshatarët patriotë e arsimdashës të Kuçit, në ato vite zie e plot turbullira, mundën të hapnin në fshat shkollën fillore.

Memua që regjistruar në shkollë që kur banonte në kasollen larg fshatit. Po ai e kishte shumë vështirë ta ndiqte; se çdo ditë duhet të bënte afërsisht një orë e gjysmë rrugë për të vajtur në shkollë dhe po aq për t'u kthyer. Këtë rrugë, në dimër apo në verë, ai e bënte zbathur, ose duke përdorur si këpucë zhapa prej lëkure lope.

Memua kishte vullnet të madh për të mësuar. Ai që në klasën e parë u dallua për zgjuarësi dhe për përvetësimin e mësimeve. Po nuk kishte para për të blerë libra, fletore, lapsa, e të tjera sende, të cilat i duheshin nxënësit. Prandaj, që i detyruar, që më shumë t'i mbante mend mësimit gjatë shpjegimit, se sa t'i mësonte jashtë klasës. Këtë gjendje të tij të asaj kohe Memua e përshkruan qartë në një vjershë të shkruar më vonë:

*...Këtu në fshat si jetim,  
Vjedhazi mësova shkrim,  
Se si vetë e dini, shkolla,  
Duaj miq edhe të holla...*

Mësuesi, çdo vit, me mbarimin e shkollës, kur i dorëzonte atij dëftesën, e puthte në ballë dhe i thoshte me dashamirësi: «Mirë u pafshim!»

Në fund, Memua mori dëftesën e lirimimit nga dora e mësuesit, i cili nuk i tha më: «Mirë u pafshim!» por e pyeti:

— Ke dëshirë të vazhdosh shkollën?

— Kam, — ju përgjegj Memua.

— Po njeri që të të ndihmojë ke?

Memua nuk foli, ai uli kokën dhe po priste ç'do t'i thoshte mësuesi.

Po mësuesi i mirë s'kishte çfarë t'i thoshte tjetër. Ai i raportoi parisë së fshatit mbi mbarimin e vitit shkollor dhe mbi nxënësit që kishin dhënë rezultate të shkëlqyera, të cilët, sipas mendimit të tij, duhej të ndihmoheshin për t'i vazhduar mësimet në ndonjë qytet. Midis këtyre nxënësve, mësuesi të parin për-mendi Memon.

Shkolla në atë kohë nuk vazhdohej kollaj. Edhe sikur paria e fshatit të donte, që djemtë të ndiqnin shkollën, ajo s'kishte ç'të bënte. Djem e vajza të zgjuara kishte shumë, po shkolla të mesme s'kishte ose kishte fare pak dhe vetëm për ata që kishin para dhe njerëz me poste të larta.

Memua, me hidhërim të madh, u largua nga shko-lla dhe mori në dorë kërrabën e bariut. Por gjatë gjithë jetës e merrte malli për bankat e shkollës dhe dëshira e zjarrtë për të mësuar nuk ju shua asnjë-herë.

Memua që ende në shkollë kur shqiptarët nxua-rën dhe një herë shpatat nga milli, për të hedhur në det italianët, që ende qëndronin në disa vende të jugut.

Në Kuç, në emër të Komitetit të mbrojtjes kom-bëtare, erdhi patrioti i shquar dhe revolucionari i zjarrtë Halim Xhelua nga Tërbaçi. Halimi nuk e pati vështirë të merrej vesh me popullin e këtij fshati, i cili sa herë kishte qenë nevoja t'i kthehej pushka armikut, nuk kishte pyetur për asgjë, po kishte luf-tuar edhe kishte ngritur lart traditat luftarake të kra-hinës.

U vendos të bëhej një mbledhje në vendin e



quajtur Grabovë. Aty, bashkë me burrat e armatosur,  
qajtur Grabovë; me, bashkë me burrat e armatosur,  
këtë edhe shumë rëmbje. Për herë të parë në atë  
mbledhje, Memua pa atë burrin me flokë të gjatë të  
hedhur pas, të cilin pleqtë e fshatit e mbanin në mes të  
tyre dhe e respektonin. Halimi që ulur këmbëkryq  
midis popullit, kurse Memua qëndronte më këmbë  
anash tij, disa hapa larg. Djali kureshtar po dëgjonte  
me vëmendje ato që flisnin të mëdhenjtë. Atë ditë  
atij ju skalit për tërë jetën në kujtesë ajo fytyrë e  
gjerë, e ashpër e burrërore e Halim Xhelos që nuk e  
harroi kurrë, megjithëse nuk pati mundësi ta shikon-  
te herë tjetër.

Halimi foli disa herë. Fjalët e tij qenë thirrje  
lufte që buronin nga zemra dhe mendja e një luftë-  
tari të paepur.

Memua i hoqi sytë nga i dërguari dhe vështroi  
Arif Mëhillin, bashkëfshatarin e tij, i cili ju drejtua  
Halim Xhelos dhe i tha:

— Ne do të shkruhemi në çeta dhe do të vijmë të  
gjithë në luftë. Jepini të fala komitetit dhe sigurojeni  
atë për pjesëmarrjen e popullit të Kuçit në luftën për  
çlirimin e Vlorës...

Memua i pa edhe çetat patriotike, të cilat u kri-  
juan me burra nga fshati Kuç, kur u nisën poshtë për  
në Vlorë.

Një propagandë e madhe bëhej në ato vite në  
fshatin Kuç për fitimin e lirive demokratike. Shumë  
djem kuçiotë qenë anëtarë të shoqërisë «Bashkimi»  
të Avni Rustemit. Ata kudo e kur gjenin rast përhap-  
nin idetë për të drejtat e popullit, idetë e lirisë dhe të  
demokracisë. E gjithë kjo luftë politike, që po bë-  
hej gjatë viteve njëzet, la mbresa të pashlyera te  
Memua i vogël dhe luajti një rol të madh në formimin  
e tij ideologjik të mëvonshëm.





dhe u fut brenda, u vërsul mbi të ëmën e shtrirë pa jetë dhe me thirrjet e tij dhe lotët i mallëngjueu të gjithë ata që u ndodhën aty. Ai e përqafonte mëmën e dashur, e puthte, i fliste. Pas dy ditësh vdiq edhe vëllai i madh i Memos, po nga ajo sëmundje që i vdiq e ëma.

Tani në haurin e vogël jetonin tre jetimë të ve-gjël, dy djem e një vajzë. Më të rrallë ndonjë burrë ose grua e dhembshur u fliste fjalë të mira e përkë-dhelëse, u çonte ndonjë pjtë me miell ose ndonjë kupë me dhallë. Po me këtë nuk mund të jetohej gjatë.

Vëllai i Memos u fut shërbëtor për të ushqyer veten; Memua duhej të punonte për të mbajtur veten dhe të motrën, Hatemen. Për t'i përballuar nevojat e jetës, atë e ndihmuan të afërmit e tij, duke e pajtuar në një shtëpi tjetër për të ruajtur bagëtinë, për një-zet lekë në muaj. Me ato njëzet lekë ai do të ushqehet dhe vishej vetë i dytë, do të blente vajguri e kripë... Po Memua s'kishte rrugë tjetër.

Nganjëherë, kur e shikonte që motra e vogël vu-ante dhe tërë ditën mbante gishtin në gojë, si tërë fë-mijët e uritur, atij i këputej shpirti dhe e merrte me vete andej nga ruante bagëtinë. Aty, duke e mbajtur me fjalë e duke i mbledhur manafera, e bënte që ajo të harronte urinë dhe të kalonte ditën.

Duke qenë vazhdimisht në luftë me urinë dhe vuajtjet e përhershme, te Memua u formua një ka-rakter jo i zakonshëm për moshën e tij. Ai jashtë treg-ohet krenar, nuk i ankohej askujt për vuajtjet dhe nevojat, nuk shkonte te as njeri për të kërkuar ndih-më, e porositte edhe të motrën që edhe ajo të mos tregonte që s'kishin për të ngrënë. Askush nuk e dinte në se jetimët hanin apo jo. E vërteta që që



vëlla e motër shpeshherë flinin pa futur gjë në gojë. Por djalit të vogël, me gjithë fatkeqësitë që e goditën njëra pas tjetrës, asnjëherë nuk ju shua në shpirt etja për të mësuar, dëshira për të marrë dije. Ai mundohet të merrte ndonjë libër nga ata djem, të cilët vazhdonin shkollat në qytete dhe gjatë pushimeve ktheheshin me leje në fshat. Pasi merrte librin që i binte në dorë, e lexonte dhe, kur e mbaronte, ua tregonte shokëve të tjerë përmbajtjen e tij.

Memua lexonte mirë, mbante shumë mend dhe kuptonte përmbajtjen e librave që lexonte. Këtë aftësi dhe zotësi, ai e ruajti deri në fund të jetës së tij.

Në këtë kohë Memua, duke u rritur në mes të maleve të larta dhe lumenjve zhurmëshumë, duke parë vuajtjet e njerëzve të varfër dhe duke provuar në kurrizin e tij urinë dhe skamjen më të madhe, filloi të ngrinte këngë dhe të shkruante vjersha.

Në fshatin Kuç kishte shumë këngëtarë popullorë, të cilët me këngët e tyre u bënë jehonë ngjarjeve historike, trimërive të luftëtarëve të shquar, jetës së vendit, punës së përditshme, natyrës së bukur dhe dashurisë. Mbi të gjithë ata shquhej i mirënjohuri Tartar Zeka, një fshatar shumë i varfër, me mendime demokratike dhe me një talent të mirë poetik.

Djali i ri i dëgjonte me qejf dhe i këndonte me shokët këngët e këtyre këngëtarëve popullorë për Gjolekën, për Hodo Nivicën, për dymbëdhjetë Bilbilejtë e të tjerë. Memon e tërhiqte shumë natyra. Duke qenë gjithmonë jashtë, majave të maleve, rrëzave të kodrave, pyjeve të dendura, lëndinave me trëndelinë tërë aromë, ai u mësua me zërin e bilbilit dhe të thëllëzës, që më vonë i këndoi në krijimtarinë letrare, ai kishte parë me sy shkrepimën e tmerrshme të



rrufesë duke goditur ndonjë lis aty afër, kishte duruar mbi trupin e tij kokrrat e breshërit, shiun e vjeshtës dhe të dimrit, kishte dëgjuar bubullimën shurdhuese para shtrëngatës, kishte parë shkëlqimin verbues të vetëtimave. . .

Në fillim Memua shkruante në pllakat e zeza prej guri, duke gërvishtur ato me stërrall, pastaj filloi të shkruante në copa letre dhe, ato që shkruante, ua lexonte shokëve.

Zgjuarësia e tij dhe dëshira e madhe për të mësuar ra në sy të të gjithëve. Disa njerëz të mirë ju lutën një të afërmi të Memos, i cili në atë kohë qe me punë në Gjirokastër, që ta ndihmonte djalin për të vazhduar shkollën.

Memua, me gjithë dëshirën e tij për të vazhduar studimet më tej, e kishte vështirë të vendoste që të largohej nga puna ku qe pajtuar si bari me njëzet lekë në muaj, sepse ai kishte në ngarkim motrën e vogël. E motra, e këshilluar nga të tjerët, ju lut vetë të vëllait që ai të shkonte e të vazhdonte shkollën, pa ajo do të bënte si të bënte aty në fshat. Sigurisht, ajo ja thoshte me dhimbje në zemër ato fjalë, sepse e dinte se sa vështirë do ta kishte të jetonte vetëm ose në shtëpitë e të tjerëve.

Memua me të motrën duheshin shumë dhe s'ndaheshin nga njëri-tjetri. Pavarësisht që Memua qe pak më i madh nga ajo, ai kishte bërë aq shumë për të saqë dukej sikur e kishte rritur ashtu si do ta kishin rritur mëma dhe babai.

— Ikë në shkollë, mos u bëj pishman, — i tha atij e motra një ditë.

Ajo sytë i kishte ngulur aty para saj në tokë e vështronte këmbët e zbathura të vëllait, të çara nga plagët.

— Jo, nuk iki. Po ty me kë të të lë, vetëm? — ju përgjegj ai, dhe një lësh mallëngjimi ja pushtoi grykën, kurse sytë e tij të zez ju mbushën me lot.

— Ikë ti, vështro për vete, se je djalë. Për motrën mos ki merak, se do ta mbajmë ne si vajzën tonë, — i tha Memos një nga fisi i tij, që mudohej për të mirën e djalit.

Dhe djali i ri u nis nga fshati. Por përpjekjet e para për ta rregulluar atë në shkollë, në Gjirokastër, nuk patën sukses. Ai, pasi qëndroi atje pak kohë, u kthye prapë në vendlindjen e tij. Kjo ndodhi në radhë të parë për arsye të karakterit të Memos, i cili qe mësuar të jetonte i varfër, po i lirë dhe me sedër të paprekur, kurse atje në qytet edhe do ta qortonin, edhe do ta urdhëronin...



## II. DUKE KËRKUAR SHTIGJE TË REJA NË JETË

Pasi u kthye nga Gjirokastra, Memua kaloi edhe një kohë aty në midis fshatarëve. Por ai s'mund të qëndronte më në fshat. Prandaj, një ditë vjeshte të vitit 1927 me një trastë në krahë dhe veshur mos më keq, u nis për Shkodër për të kërkuar shtigje të reja në jetë. Që të regjistrohej në shkollë dhe të vazhdonte mësimet, duhej që dikush ta mbante dhe ta ushqente. Kjo qe shumë e vështirë. U mendua që të futej në ndonjë punë, mirëpo nevoja për krahë pune nuk ndihej aspak, ndërsa me atë shkollë fillore që kishte ai, as që mund të mendonte për të trokitur në derën e ndonjë zyre.

Megjithatë, kishte një punë, të cilën në atë kohë mund ta bëje edhe pa pasur shumë shkollë, por që të vendoseshe atje duhej rekomandimi i ndonjë të afërmi me post të rëndësishëm.

Kështu ndodhi, që më 15 janar të vitit 1928, Memo Metua u fut nënoficer në zyrën e rekrutimit të Shkodrës. Aty ai u mësua shpejt me detyrën e re, e çdo ditë e më tepër dallohej nga shokët për punë të kujdesshme dhe për zell në të mësuarit e atyre gjë-

rave që dinin ata më me eksperiencë. Në moshën tetëmbëdhjetë vjeç, i veshur me petkun ushtarak, filloi shpejt ta ndjejë nevojën e shfrytëzimit të kohës që kishte për t'u ngjitur më lart në horizontin e dijes.

Më 1929 Memua transferohet nga Shkodra në Tiranë me detyrë llogaritar baterie në artileri. Transferimi i tij në Tiranë pati një rëndësi të madhe në përcaktimin e rrugës dhe të veprimtarisë së tij në të ardhmen.

Në Tiranë, ai gjeti edhe nënoficerë të tjerë si dhe disa oficerë nga krahina e tij. U miqësua me ta dhe filloi të bisedonte për gjërat më të ndryshme duke shkëmbyer mendime.

Midis ushtarakëve të rangut të ulët kishte një-rëz me pikëpamje të ndryshme ndaj regjimit të mbretit Zog. Shumica, të kënaqur nga postet që kishin zënë dhe nga rrogat që merrnin, nuk shikonin më larg, mendimet e tyre qenë nga më reaksionaret. Po kishte edhe disa ushtarakë, të cilët ruanin një urrejtje për regjimin dhe mbretin shtypës të popullit. Me këta të fundit Memua gjeti gjuhën e përbashkët dhe u bë shok i ngushtë në luftën kundër tiranisë.

Ai nuk e kishte harruar dhe as që mund ta harronte jetën e tij plot vuajtje, atë jetë që kishte kaluar duke ecur zbathur mbi gurët e mprehtë dhe mbi gjembat për të mbledhur lakra të egra... E dinte se si motra e tij, ashtu edhe fshatarët e tjerë, vuanin për bukën e gojës. Prandaj, Memua, në fjalët e atyre nënoficerëve dhe oficerëve që i flisnin kundër regjimit, që i qanin hallet popullit të varfër, shikonte edhe mendimet e veta.

Veç asaj të kaluare plot vuajtje që solli me vete që nga fshati i Labërisë, Memua, edhe këtu ku qe



tani, shihte diçka të çuditshme: nënoficerët dhe ushtarët trajtoheshin keq nga regjimi dhe eprorët e tyre. Ata fyheshin, përbuzeshin, shaheshin me fjalët më të këqia për gjërat më të vogla, ose për teket e oficerëve.

Përgjithësisht nënoficerët në regjimin e Zogut trajtoheshin keq. Memua këto nuk i duronte dot dhe desh të largohej nga ushtria. Po ku të shkonte? Me se të merrej? Tani ai qe burrë dhe duhej të merrej me diçka për të jetuar. «Kudo që të veç njësoj është, — i tha atij një shok i ngushtë. — Kudo do të të shajnë. Prandaj rri aty ku je, se tani për tani s'ke ç'bën tjetër».

Nënoficeri i ri nuk pranonte që ta fyenin dhe ta shanin. Këtë ai ua kishte bërë të qartë edhe eprorëve të tij, të cilët nuk e duronin dot këtë djalë të ri me një krenari të tillë, e cila nuk i përshtatej pozitës së tij në shoqëri.

Po Memua përvetësonte gjithnjë më mirë edhe një armë tjetër për të shprehur revoltën dhe urrejtjen kundër padrejtësive që i bëheshin atij dhe shokëve të tjerë, si dhe për të demaskuar regjimin e prapambetur anadollak. Kjo armë ishte poezia.

Memua u njoh shpejt nga shokët e tij si vjershëtar i zoti dhe me talent. Me vargjet e tij, ai u këndonte dashurisë, natyrës dhe trimërisë së të parëve. Qysh në atë kohë, tregoi një aftësi të veçantë edhe në përdorimin e satirës. Disa nga vargjet e tij satirikë shpejt u bënë të njohura dhe u përhapën dorë më dorë e gojë më gojë ndër ushtarët dhe nënoficerët. Në vjershat e tij satirike Memua vinte në lojë oficerët, të cilët silleshin keq me vartësit, kritikonte dallkukët, të cilët i kishin fituar postet jo nga zotësia, po vetëm duke i shërbyer regjimit të mbretit qorrçë, merrte

episode dhe anekdota nga jeta e përditshme, ku tregohet injoranca, servilizmi, arroganca dhe të tjera vese dhe i vinte në lojë. Shpeshherë fshikëllima e vjershave të tij drejtohej edhe më lart...

Për një vjershë të tillë më 1930 e thirrën në komandë.

— Ti e ke shkruar atë vjershë tallëse? — e pyeti eprori.

Memua nuk u përgjegj, po kjo s'kishte rëndësi.

— Po të pyes, ti e ke shkruar apo jo? — e përsëriti pyetjen eprori.

Memua nuk e pranoi që ta kishte shkruar ai atë vjershë, po u detyrua të pohonte se shkruante vjersha.

— Pse shkruen?

Kësaj pyetjeje Memua nuk ju përgjegj. Megjithatë, komanda e kishte nxjerrë konkluzionin e saj. Atë e arrestuan dhe e futën në burgun e Tiranës. Kjo që ndeshja e tij e parë e hapur me autoritetet e regjimit të Zogut dhe burgimi i parë i tij.

Memon e mbajtën në burg një muaj; pastaj, me ndërmjetësimin e një oficeri fanolist, që qe me detyrë në komandën e garnizonit të Tiranës, e liruan, me porosi të rreptë që të hiqte dorë nga rruga e tij dhe të mos merrej më me vjersha.

Po Memua qe poet dhe poeti nuk mund të rrijë pa kënduar.

Vjershat e tij të reja, që të mos zbuloheshin e të binin në dorë të autoriteteve, mësoheshin shpejt nga ushtarët e nënoficerët dhe disa prej tyre këndohehin nga ata labçe.

Ishte më se e qartë që Memo Metua, veç një djali me ndjenja patriotike dhe demokratike, qe edhe një poet me talent. Prandaj shokët e tij e këshilluan që të merrej edhe me studimin e gjuhës dhe të letërsisë.



Memua edhe më parë lexonte libra të ndryshëm, që i binin në dorë. Por shokët e këshillonin që të lexonte libra të zgjedhur, në bazë të një kriteri. Shokët e tij të ngushtë kallëzojnë që ai tregonte këmbëngulje në mësimin e matematikës, gjeometrisë dhe zgjidhte ushtrimet e ndryshme që shërbenin për përvetësimin e lëndëve. Ai punonte me të gjitha forcat dhe studjonte shumë për të marrë një kulturë të mirë të gjithanshme, po mbi të gjitha thellohej në librat e historisë, gjeografisë dhe veçanërisht të lehtësisë. Në këtë kohë paguante edhe një profesor, i cili i jepte mësim në shtëpi.

Me vullnetin e tij të pashoq, Memua mundi të mësonte vetë edhe muzikë. Shokët e tij e dëgjonin mbrëmjeve t'i binte violinës.

Ai hodhi trup të gjatë, me shpatulla të gjera, fytyrë me tipare të rregullta, në të cilën dalloheshin sytë e zez e të mëdhenj, balli i drejtë, vetullat si gjysmëkurorë prej gajtani të zi. Të gjitha këto e tregonin atë një djalë të pashëm, që të tërhiqte vëmendjen. Veç këtyre Memua kishte një mënyrë të ecure pothuajse origjinale. Një «të ecur me supe», si thonë në Labëri. Ai ecte shpejt duke e mbajtur trupin drejt, kokën lart dhe gjoksin e nxirrte përpara.

Në vitin 1931 në Tiranë do të hapej kursi i radhës për oficerë në Shkollën mbretërore. Shokët e këshilluan Memon që të regjistrohej në atë shkollë. Një gjë të tillë nuk e kishte qejf dhe në fillim nuk pranoi. Shërbimin në ushtrinë e Zogut e urrente dhe kishte qëllim që të largohej fare për t'u futur në ndonjë punë tjetër. Pasi u mendua gjatë dhe duke mos parë rrugë tjetër, më në fund pranoi këshillat e shokëve. Po që të regjistroheshe në atë shkollë nuk qe e lehtë. Atje pranoheshin studentë, të cilët duhej

të kishin mbaruar jo më pak se katër deri në gjashtë klasë gjimnaz. Si përjashtim mund të pranoheshin edhe nënoficerë, të cilët duhej të paraqitnin një rekomandim nga një njeri me pozitë të lartë. Por regjistrimi i nënoficerëve në shkollë bëhej pasi ata t'i nënshtroheshin konkursit.

Memua, duke patur vetëm arësimin fillor, u përgatit seriozisht për konkursin. Ai, duke punuar vetë e duke kërkuar edhe ndihmën e shokëve, të cilët kishin arësim civil të plotë, arriti të zgjeronte horizontin e dijenive të tija. Për këtë qëllim atij i shërbeu gjithë përvoja e jetës së tij, gjithë studimet dhe leximet që kishte bërë që në vogëli.

Gjatë provimeve Memua dha përgjigje të tilla, me të cilat habiti anëtarët e komisionit dhe bëri që ata të mos besonin se ky djalë i pashëm e shtatlartë që ishte tani para tyre, të kishte mbaruar vetëm shkollën fillore. Prandaj pyetjet plotësuese binin si breshër mbi të. Po edhe përgjegjet e tij qenë në majë të gjuhës dhe qenë të shkurtëra, të sakta, të prera dhe bindëse.

Në përfundim të provimeve si me shkrim ashtu edhe me gojë mori notën «shkëlqyeshëm». Dëshirën e tij, që të regjistrohej në degën e artilerisë, nuk ja muarën parasysh dhe e regjistruan në degën e intendencës.

Më pesëmbëdhjetë tetor të vitit 1931 Memo Metua hyri në klasë dhe zuri vend prapa bankave të radhës së parë. I gjithë grupi përbëhej prej rreth njëzet vetësh, shumica e të cilëve qenë nxënës gjimnazi, po kishte edhe disa nënoficerë, të cilët qenë futur ashtu si edhe Memua.

Mësimet qenë të rënda. Aty jepej kontabilitet i përgjithshëm i shtetit, kontabilitet ushtarak, merceo-



logji, logjistikë, shërbim kazermimi, veterinari e të tjera. Pjerëmarrësit e grupit duhej të bënin shumë përpjekje për përvetësimin e lëndëve. Po, sigurisht, më vështirë nga të gjithë e kishin nënoficerët, të cilët i dëgjonin për herë të parë ato përkufizime shkencore dhe ato lëndë të panjohura.

Shoku i grupit të Memos, veterani i Luftës nacionalçlirimtare Preng Uli tregon: «Gjatë procesit të mësimin ai u dallua nga të tjerët për një studim serioz, të thellë, për një qëndrim korrekt ndaj shokëve. Përparimi i tij në mësim nuk qe i zakonshëm për arësimin e përgjithshëm që kishte. Memua dallohej edhe për shprehjen e bukur dhe të qartë të mendimeve të tij, për logjikën e fortë me të cilën i detyronte të tjerët që ta dëgjonin me respekt dhe t'i bindeshin».

Memua, veç përpjekjeve në mësim, bënte edhe një punë të mirë për të mos lejuar grindje dhe përçarje midis njerëzve të krahinave të ndryshme, gjë që në atë kohë ndodhte dhe nxitej nga agjentët e regjimit të Zogut. Gjithashtu ai luftonte që të mos kishte përçarje dhe përbuzje midis njerëzve me nivel të ndryshëm kultural.

Përgjithësisht nxënësit që vinin nga gjimnazet kishin mendime të këqia për nënoficerët dhe mbanin qëndrim përbuzës ndaj tyre; kjo ndodhte sepse nënoficerët kishin pak arësim të përgjithshëm dhe qenë të shtresave të ulëta, kurse shumica e nxënësve qenë nga shtresa të larta dhe të mesme.

Por sukseset e Memo Metos në mësim e detyronin nxënësit gjimnazistë të kishin respekt për të dhe të shikonin në personin e tij një shok të pjekur e të zotin, te i cili duhej të merrnin shembull dhe të mësonin shumë prej tij. Kjo u bë shkak që të ndryshohej mendimi edhe për nënoficerë të tjerë dhe të

mos quheshin më me epitete ofenduese si më parë.

«Duke parë Memon kur ngrihej në mësim, — tregon përsëri Preng Uli, — dhe duke e dëgjuar atë, ne që kishim arësim të përgjithshëm shumë më tepër nga ai, habiteshim dhe na lindte sedra që t'ja kalonim atij patjetër në mësim. Mirëpo kjo qe e pamundur. Ai çdo ditë e më tepër ngrihej më lart dhe paraqitej para nesh më i mënçur nga të gjithë, më i zoti, më studjuesi dhe, sigurisht, më i gojës për t'i shprehur bukur mendimet e tij».

Memua gjatë gjithë kohës së mësimëve qe një ndër të parët e klasës dhe, si i tillë, qe caktuar për një periudhë kujdestar i grupit, ku bënte pjesë.

Aty në shkollë u përforcua në ndërgjegjen e Memos urrejtja kundër regjimit të Zogut, si dhe kundër fashizmit italian.

Në historikun e fshatit Kuç thuhet: «Memua në shkollë dallohej jo vetëm si nxënës i shkëlqyer në mësim, por dhe si njeri me tendenca përparimtare, që e urrente regjimin feudoborgjez të Zogut, i cili shtypte dhe shfrytëzonte pa mëshirë popullin shqiptar. Po dhe ky regjim shikonte në personin e Memo Metos një kundërshtar të rrezikshëm dhe mori masa persekutimi karshi tij, duke e burgosur, etj.»

Në shkollën ku mësonte ai, drejtori dhe disa pedagogë qenë italianë. Oficerët italianë në atë kohë kishin hyrë në të gjitha sferat e ushtrisë shqiptare dhe loznin rolin kryesor në jetën e asaj ushtrie, si në pregatitjen luftarake, në organizimin sipas tipit të ushtrisë së tyre e në futjen e ideologjisë fashiste.

Pedagogët si detyrë të tyre kryesore nuk kishin dhënë e lëndëve të ndryshme në shkollë, po spiunazhin dhe propagandën për përhapjen e ideo-



logjisë fashiste në ushtri. Interesant është fakti i mëposhtëm:

Mësimin e veterinarisë në klasën ku mësonte Memua e jepte një farë Bon Figlio, i cili, veç detyrës së pedagogut në shkollën e intendencës, kryente edhe rolin e këshilltarit në seksionin e veterinarisë në Ministrinë e Luftës. Disa vjet më vonë, kur Italia fashiste pushtoi vendin tonë, po ky Bon Figlio ishte komandant i karabinierisë së qarkut të Shkodrës. Si ky rast pati edhe të tjerë.

Gjatë kohës që Memua studjonte në këtë shkollë aty kishte shumë oficerë, me detyra komandimi ose instruktorë, të cilët bënë shumë padrejtësi, mbanin me hatër, intrigonin, kërkonin ryshfete e të tjerë. Kundër këtyre padrejtësive dhe sjelljeve të ulëta të oficerëve dhe nëpunësve të regjimit, nxënësit flisnin dy e nga dy e vesh më vesh, duke shprehur një pakënaqësi të thellë. Memua që ndër ata që revoltuhej më tepër dhe shpërthente shpejt; ai, bashkë me shokët më të përparuar, përhapte në nxënësit të tjerë lajmet që dëgjonte nga krahinat e ndryshme, fliste për vuajtjet e popullit e për kundërshtimet e tij ndaj shtypjes.

Krahas ndjekjes së mësimëve, Memua nuk pushoi asnjëherë së lexuari libra të ndryshëm, të cilët i vlenin për përgatitjen dhe zgjerimin e horizontit të tij kultural, si dhe për të gjetur përgjegje për ato çështje që e shqetësonin në atë kohë.

Më një korrik të vitit 1932 Memua mbaroi pjesën teorike të kursit dhe u dërgua gjashtë muaj në reparte për të bërë praktikën. Në janar të vitit 1933 u gradua oficer dhe u caktua me detyrë në Berat.

### III. KUNDËR REGJIMIT TIRANIK TË ZOGUT

Në ato vite në ushtrinë e Zogut vepronin disa oficerë patriotë, të cilët qenë kundër regjimit, si dhe disa elementë komunistë. Memo Metua ra shpejt në sy të tyre, si njeri me ide përparimtare dhe i pakënaqur nga jeta dhe rregullat që ekzistonin. Një nga këta, i cili e njihnte mirë Memon, filloi t'i fliste e t'i propagandonte idetë komuniste. Ai vuri re që Memua jo vetëm që i kuptonte ato që i thoshte, por edhe diskutonte me të, duke shfaqur mendimin e tij. Memo Metua u afrua me ata elementë dhe, duke filluar nga viti 1934, që një nga ushtarakët që simpatizonte idetë komuniste.

Duke qenë bir fshatari, i rritur jetim e me vuajtje, i edukuar në gji të popullit me mendime demokratike e të lira, Memua shprehej hapët kundër rregullave që ekzistonin atëhere në ushtrinë e Zogut, të cilat e ndalonin oficerin që të shoqërohej me ushtarët, nënoficerët dhe shtresën e varfër të popullit. Ai vetë kurrë nuk i zbatonte ato rregulla. Në kohën e lirë ulej shpesh këmbëkryq me ushtarët dhe nënoficerët dhe u propagandonte idetë përparimtare.



Me gjithë kujdesin e tij dhe të shokëve me të cilët bisedonte, ra shpejt në sy dhe në vesh të spiunëve dhe u raportua si njeri i rrezikshëm.

Memua qe ndër ata oficerë të paktë, të cilët nuk u gënjyen as nga rrogat, as nga gradat dhe as nga propaganda dhe presionet që bënte mbi ta qeveria e Zogut. Ai qe midis atyre oficerëve, të cilët, duke qenë në ushtri, e shikonin më mirë kalbësinë e regjimit, dallaveret që bëheshin në kurriz të popullit, shikonin punën e ndyrë që bëhej pë ta përdorur ushtarin dhe oficerin qorrazi në shërbim të pushtetit reaksionar.

Erdhi një kohë që u mendua të kalohej nga fjalët në vepra. Po shfaqeshin mendime të ndryshme, po bëheshin plane për t'i dhënë goditje regjimit të mbretit. Pas gjithë këtyre po përgatitej një kryengritje. Kjo më vonë, për kushtet konkrete si u zhvillua, u quajt Kryengritja e Fierit. Memo Metua gjatë kryengritjes qe caktuar të vepronte në Berat me forcat që do të drejtonte militanti komunist Riza Cerova. Kryengritja e Fierit dështoi. Lidhur me këtë në Historinë e Partisë thuhet:

«Komunistët që morën pjesë në lëvizje, ndonëse ishin të vendosur ta çonin deri në fund, nuk arritën të dilnin në krye të lëvizjes, ta përgatisnin atë në mënyrë të gjithanshme dhe ta pajisnin me një program të qartë politik... Megjithatë, ajo ishte një shfaqje e zemërimit dhe e pakënaqësisë kundër regjimit shtypës çifligaro-borgjez. Ajo pati rëndësi politike dhe jehona e saj i kaloi kufitë e Shqipërisë... — Nga ana tjetër, kryengritja, siç shkruante Ali Kelmendi, ishte «pagëzimi i zjarrit dhe guri i provës» për komunistët shqiptarë. «Këtë provë, — vazhdoi ai, — ata e kaluan me nder dhe e treguan veten e tyre si vë-

llezër të denjë të komunistëve të vendeve të tjera».

Pas dështimit të kryengritjes regjimi i Zogut u hodh në sulm dhe mori masat më të rrepta shtypëse. Po, ndërsa kundër popullit, ushtarëve dhe nënoficerëve që luftuan me armë shpërtheu një terror i vërtetë, kundër oficerëve që dyshoheshin për pjesëmarrje në kryengritje mbajti një qëndrim më ndryshe. Ai arrestoi, burgosi e dënoi ata oficerë, të cilët qenë më të njohur dhe më me influencë, si Asim Vokshin e të tjerë, kurse pjesën tjetër e mbante nën vëzhgim të rreptë.

Qëllimi i tij ishte që të zbulonte nëpërmjet tyre deri në fund fijet e organizatës dhe të shikonte deri ku kishin mbërritur punët. Për frenimin e arrestimeve njëfarë roli luajtën edhe protestat që u bënë në shumë vende të botës kundër terrorit që po shpërthente në Shqipëri për t'u hakmarrë kundër kryengritësve.

Memo Metua që një ndër ata oficerë, të cilët, në atë kohë, nuk u arrestuan. Po tani, ai ndiqej dhe raportohet rregullisht nga spiunët e Zogut.

Gjatë kohës që që në Berat, Memua mbante lidhje të ngushta me shumë punëtorë të Kuçovës që qenë nga ana e tij, të cilët i njihte si njerëz të ndershëm dhe me bindje politike kundër regjimit të Zogut.

Duke qenë në listën e njerëzve kundër regjimit dhe kundër fashizmit italian, më 1937, kur ministri i jashtëm i Italisë konti Çiano bëri një vizitë në Kuçovë, Memon, ashtu si dhe shumë të tjerë, i muarën nën vërejtje dhe i mbajtën të izoluar përderisa zgjati vizita e ministrit fashist. Kjo u bë me qëllim që të evitohet organizimi dhe shpërthimi i ndonjë trazire.

Në këto vite qeveria e Zogut i hapi edhe më



tepër dyert e vendit tonë për propagandën fashiste. «Instruktorët» italianë ndërhyjnë më hapur në gjithë jetën e ushtrisë shqiptare. Veçanërisht pas fillimit të Luftës së Spanjës, kërkohej nga ana e tyre që elementët komunistë dhe ata me mendime demokratike të pastroheshin nga ushtria.

Mbreti i shitur u bind. Goditja që pritej u dha.

Nga fundi i muajit prill të vitit 1937 filluan ndër oficerët arrestimet që vazhduan edhe gjatë muajit maj.

Më 19 maj 1937 Memo Metua, bashkë me shokë të tjerë nga elementët komunistë e patriotë, u arrestua në Berat dhe, pasi u mbajt disa ditë atje, u dërgua në burgun e Tiranës. Aty u kërkuar prej tij të tregonte shokët me të cilët kishte lidhje dhe aktivitetin e tyre. Po qëndrimi i Memos që burrëror, i papërkulur. Ai nuk u frikësua as nga kërcënimet, as nga provokacionet e njëpasnjëshme që i bënin duke i vënë para tavolinës së hetuesisë deklarata të rreme, të fabrikuara nëpër zyra, as nuk u gënjye nga premtimet që i bënin si shpërblim në rast se do të tradhëtonte shokët.

Pas tre muajsh e ca hetimesh të vazhdueshme, kur autoritetet u bindën se nga goja e tij nuk mund të nxirrnin gjë, dhe pasi s'kishin prova për ta dënuar, më 31 gusht vendosën nxjerrjen e tij nga burgu. Po në atë kohë me dekretin mbretëror numër 502 datë 20.8.1937 atij ju hoq gradat e u qit në lirim.

Në bisedat e asaj kohe me shokët Memua thoshte me gjithë zemër: «Tani që hoqa ato rripa dhe hekura nga supet e ndjej veten më të lehtë se zogu i malit».

Memon e nxorën në lirim si antizogist, duke qënë në listën e njerëzve të rrezikshëm për regjimin;

kështu, ai i kishte të mbyllura dyert e zyrave për të gjetur ndonjë punë sa për të jetuar. Në këto kushte shkoi në fshatin Perondi të Beratit, ku ndodhej edhe vëllai i tij dhe u vendos aty.

Në Perondi, Memua u muar me punë nga më të ndryshmet: korrte bar, shiste qumësht, punonte me pendët e qeve e të tjera. Po mbi të gjitha merrej me punë propagandistike, duke folur kundër regjimit të Zogut që e kishte çuar popullin në pikë të hallit. Ai jetonte gju më gju me të varfërit, i pikonte zemra gjak kur shikonte ata fëmijë të dobët e të leckosur, ata burra e gra që ropëtoheshin ditë e natë për bukën e gojës e bukë s'kishin dhe që banonin në kasollet prej balte duke qenë të zbathur e të veshur me lecka.

Memua fliste hapët me ta. Ai, duke prekur plagët e popullit, godiste në shenjë. Njerëzit e varfër që e dëgjonin habiteshin me fjalët që dëgjonin nga goja e tij dhe thoshin për të: «Ja ai labi që e ka dënuar qeveria».

Për punën e Memo Metos kundër regjimit në atë periudhë flasin shumë bashkëkohës. Veç këtyre ka dokumenta arkivale, të cilat tregojnë rëndësinë që i jepte regjimi aktivitetit të tij. Memua ndiqej këmba-këmbës. Ngado që shkonte, ai kishte pas syrin e spiunit dhe të xhandarit. Në muajin dhjetor të vitit 1937 Memua shkoi në Vlorë për disa ditë. Qarkkomanda e Vlorës, pasi e mbajti atë nën një vëzhgim të rreptë, me shkresat e saj numër 14/23 Rez. datë 13 dhjetor 1937, numër 14-4/4 Rez. datë 31 dhjetor 1937, numër 14-4/5 Rez. datë 1 janar 1938 dhe numër 14-4/9 Rez. datë 2 janar 1938 drejtuar Qarkkomandës së Beratit e njoftuan atë për aktivitetin e tij në qytetin e Vlorës ato ditë që qëndroi aty.

Në të njëjtën kohë nga aktiviteti i tij edhe pre-



fektura shqetësohej. Ja se ç'farë shkruan prefekti i Vlorës në shkresën numër 326/6 prot. Rez. datë 4 janar 1938 «Mbi survejimin e ish-nëntoger Memo Metos», drejtuar prefekturës Berat dhe për njoftim Ministrisë së Punëve të Brendshme, zyrës sekrete:

«...Meqenëse sjelljet e tij na venë në dyshim, kemi urdhëruar organet e sigurimit për të vazhduar hetimet rreth qëllimit të ardhjes së tij këtu, si edhe për t'u mbajtur nën survejim të ngushtë sa herë që të vijë këtu.

Do të ishte shumë e vlefshme që të porositet komanda e gjindarmërisë qytetëse aty, që sa herë që të largohet i përmenduri qoftë për Vlorë, qoftë për ndonjë vend tjetër, të njoftojë në mënyrën më të shpejtë, direkt, komandën e gjindarmërisë së vendit ku shkon, e bile do të ishte mirë të njoftoheshin edhe postat gjatë udhëtimit, në mënyrë që posa të zbresë në ndonjë vend të ndodhet nën vëzhgimin e organeve të sigurimit...»

Gjatë kohës që ai qëndroi në Perondi dhe Berat u njoh dhe vendosi kontakte me shokë, të cilët më vonë, gjatë Luftës nacionalçlirimtare, zhvilluan një veprimtari të gjerë, si me Muhamet Gjollëshën, Kristaq Tutulanin e të tjerë. Me Muhametin dhe Kristaqin, Memua mbajti lidhje edhe më pas, pasi u largua nga ai qark.

Memua qëndroi për një vit e gjysmë pa punë. Por më 20 nëntor të vitit 1938, i ndihmuar nga shokët dhe të njohurit, u emërua zëvendëssekretar komuneje, në komunën e Levanit të Fierit.

#### IV. VEPRIMTARIA E TIJ PAS PUSHTIMIT FASHIST TË VENDIT

Pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste Memo Metua, ashtu si i gjithë populli shqiptar, e priti me urrejtje të madhe. Ai me shokët e tij e kishin para-djerë me kohë këtë rrezik. Memos i kujtohej demost-rata navale që bëri flota italiane në Durrës më 1934, si presion kundër qeverisë së Zogut, për të siguruar lë-shime të reja; i kujtoheshin marrëveshjet e ndryshme skllavëruese që kishte lidhur qeveria e Zogut me qeverinë e Musolinit. Ai e dinte mirë edhe gjendjen e ushtrisë shqiptare, e cila, e pastruar nga elementët patriotë e përparimtarë, kishte mbetur në duart e njerëzve të shitur e injorantë.

Fluturimet e aeroplanëve italianë nga perëndimi në lindje, duke kaluar edhe atje ku ndodhej Memua, i shikonte me grusht të shtrënguar. Ai po shikonte me sytë e tij urrejtjen popullore ndaj tradhëtisë, shikon-te lotët, thirrjet, britmat... Të gjitha këto i pasqyroi në një vjershë të gjatë me titull: «Viti më tridhjetë e nëntë», ku midis të tjerave lexohet:

*Viti më tridhjet'e nëntë,  
Fryn një erë e një stuhi,  
Gjithë skelat se ç'u nxinë,  
Zbret fashizmi n'Shqipëri!..*



Autoritetet fashiste, pasi vendosën kudo administratën e pushtimit, e thirrën Memon ndër të parët, duke i bërë lajkat e zakonshme e duke e cilësuar si «patriot të vërtetë, që e kishte bërë detyrën e tij, duke qenë kundër mbretit Zog» dhe i propozuan që të futej prapë në ushtri si oficer me gradë më të lartë nga ajo që kishte pasur më parë.

Memua refuzoi në mënyrë të prerë të shërbente në ushtrinë e pushtuesit.

Nga ana tjetër autoritetet fashiste e mbajtën në evidencë si njeri të rrezikshëm e me ide komuniste. Vepriktaria e tij e përditshme ishte vënë nën një kontroll të rreptë. Çdo aktivitet i tij, me kë takohej, kush qenë shokët e tij, ç'farë bisedonte e ku shkonte raportoheshin dhe merreshin vesh shpejt në zyrat e spiunazhit ushtarak italian.

Për të mos i dhënë kohë atij që të njihej mirë me masat, autoritetet fashiste përdorën edhe kundër tij metodën e njohur e të vjetër, që përdorej në këto raste. Ata e transferonin Memon vazhdimisht nga njëra qendër në tjetrën.

Më 15 korrik 1939 atë e transferuan si sekretar komuneje nga Levani i Fierit në komunën e Sheperit të Zagorisë.

Në fshatin e Andon Zako Çajupit Memua gjeti një popull mikpritës dhe shpejt u bë i dashur për të. Në këtë fshat ai u interesua për vjershat e shkruara nga poeti i shquar dhe shumë prej tyre i mësoi përmendësh.

Po edhe autoritetet fashiste nuk flinin. Duke parë aktivitetin e tij, më 3 tetor të vitit 1939 e transferuan përsëri, këtë radhë në komunën e Gusmarit, qendër e nënprefekturës së Kurveleshit.

Kishin kaluar më tepër se dymbëdhjetë vjet, që

nga ajo kohë, Kur Memo Metua, djalë jetim, kishte lënë kërrabën e bariut dhe që larguar nga Kuçi, fshati i tij i dashur. Tani ai po kthehej në qendrën e krahinës burrë i pjekur e me një kalitje të madhe nga jeta.

Në Gusmar si kryetar komuneje, domethënë shef direkt i Memos, që emëruar Hasan Bajraktari, nga Elbasani, njeri me ide komuniste, më vonë dëshmor i Luftës nacionalçlirimtare. Memua, që në fillim të punës së përbashkët, vendosi kontakte me Hasanin, e dëgjonte dhe mësonte prej tij, duke e çmuar atë si shok të pjekur dhe të përgatitur si revolucionar.

Këtu, mes maleve të Kurveleshit, në mes të popullit të tij që e njihte mirë, Memua merrte frymë më lirisht dhe nisi një punë të gjerë me masat e popullit, duke propaganduar kundër fashizmit. Për këtë ai shfrytëzonte çdo rast, takimet me popullin për arësye pune, bisedat e organizuara qëllimisht, ndodhjen nëpër festa të ndryshme e të tjera.

Memua, duke shkuar nga njëra shtëpi te tjetra, bisedonte me burra e gra. Me ato fjalët e tij të goditura dhe shakatë e kripura, bënte që fshatarët ta ndjenin veten se kishin afër tyre një njeri të mirë, të dashur, shokun e tyre, një nëpunës jo qibar po të thjeshtë, ashtu si është populli; prandaj ata i hapeshin dhe i flisnin për ato që mbanin në zemër. Ai atëhere u shpjegonte me fjalë të thjeshta shkaqet e vuajtjeve të popullit e të këqijat e fashizmit dhe bënte fjalë për detyrat e çdo shqiptari në atë kohë të vështirë.

Memua kishte zotësi të rrallë për të punuar me të rinjtë. Dhe kjo zotësi e bëri atë pak më pas njeri shumë të dashur për rininë e Kurveleshit. Që në atë periudhë të jetës së tij i kushtonte shumë kohë punës



me rininë dhe të vegjëlit. Bisedonte gjatë me ta, u fliste atyre, i dëgjonte, i mësonte si të punonin, si të lexonin e çfarë të lexonin. Metodat e punës së tij qenë nga më të ndryshmet, sipas rastit e sipas rrethanave.

Një mbrëmje bashkë me një shokun e tij ishte në një familje. Po bisedonin me të mëdhenjtë. Memua, gjatë kësaj kohe, vuri re se në dhomën tjetër kishte shumë fëmijë, të cilët herë pas here zgjatnin kokën te dera, për të parë miqtë, dhe pastaj largohehin prapë. Memua nguli këmbë që të gjithë fëmijët të mblidheshin aty ku qenë edhe të mëdhenjtë. Ashtu u bë. Memua, për një kohë vazhdoi të bisedonte me fëmijët.

Të vegjëlit, duke parë atë burrë të panjohur, të veshur ndryshe nga fshatarët e tjerë, kishin turp e nuk e zbërthenin gojën. Po Memua kishte me vete një çelës magjik, me anën e të cilit jua hapte gojën edhe fëmijëve më të turpshëm e më kryeneçë. Ja filloi me shaka, pastaj tregoi një përrallë të bukur nga jeta e kafshëve, të cilën të vegjëlit e pëlqyen shumë, dhe një nga një po ngrinin kokën e po e shikonin atë në sy. Memua vazhdoi prapë me shaka, të cilat i bënë fëmijët të qeshnin me të madhe. Pas përrallës së dytë ja arriti që fëmijët t'i afroheshin e të mos ndjenin më ndrojtje.

Memua e ndërroi temën e bisedës. Ai kërkoi të mësonte nga fëmijët si mësonin në shkollë.

— Mirë! — ju përgjegjën të gjithë.

— Po kush mëson më mirë? — pyeti ai.

— Unë, — i tha shpejt një djalë nja dhjetë vjeç.

— Edhe unë, — u mburr një tjetër.

Mirëpo Memua kërkonte fakte e jo fjalë.

— Pa m'i jepni dëftesat e shkollës t'i shoh, — u tha ai.

Ja dhanë dëftesat. Memua i pa me kujdes dhe vu-ri re se ai që qe përgjegjur i pari nuk kishte thënë të vërtetën; ai nuk qe i pari në rezultate po i fundit, kurse një djalë tjetër, që s'kishte folur fare, në dëftesë kishte notat më të mira.

Memua qortoi ata që mburrreshin pa të drejtë dhe lavdëroi ata që kishin mësuar më mirë pa bërë zhurmë. Pas këtij episodi me fëmijët, ai u tregoi një fabulë, e cila i përshtatej rastit, sepse vinte në lojë ata që e kishin kokën bosh e mburrreshin dhe lavdëronte ata që punonin e mësonin me zell e pa mburrje.

— Kush mund të na thotë përmendësh ndonjë vjershë? — i pyeti ai fëmijët dhe, papritur përgjegen e tyre, ju drejtua djalit që kishte mësuar më mirë nga të tjerët: — Pa na thuaj ti ndonjë vjershë!

Djali u çua në këmbë e nisi të recitonte vargje nga Historia e Skënderbeut të Naimit. Kur kaloi ndrojtja e parë, djali harroi që para tij ndodheshin miq dhe të mëdhenjtë e shtëpisë. Ai me mend jetonte atje në ato skenat e përshkruara aq bukur nga Naimi. Dhe si mbaroi u ul thjesht midis të tjerëve. Memua vazhdoi të qëndronte për një kohë pa folur. Ai qe i përqëndruar dhe kushedi se ç'mendonte. Pastaj e pyeti djalin:

— Po Hymnin e flamurit e di?

— E di.

— Pa thuaje edhe atë.

Djali këtë radhë, më me guxim, u çua dhe filloi:

*«Rreth Flamurit të përbashkuar,  
Me një dëshirë me një qëllim...»*

— Të lumtë! — i tha Memua, kur ai mbaroi dhe i shtrëngoi dorën.



Memua, kur mësoi nga fëmijët se ata dinin edhe këngën e balilave (organizatë fashiste për të vegjëlit), i qortoi ata dhe u tha se nuk duhej të mësonin këngë italiane, sepse fashistët italianë qenë armiq të Shqipërisë.

— Ç'u thua atyre nga këto gjëra? — i bëri vërejtje shoku i tij. — Ata mund të flasin edhe jashtë dhe pastaj merret vesh nga të gjithë.

— Po, po kështu duhet të bëjnë dhe t'u thonë edhe shokëve të tyre që këngë italiane të mos mësojnë. Ta përhapim kudo që fashizmi është i lig. — Pastaj ai u kthye nga fëmijët: — E muarët vesh? Duhet të mësoni këngët tona, këngët e Çajupit e të Naimit, po jo këngë fashiste dhe tu thoni shokëve tuaj që fashizmi është armiku ynë...

Aty nga muaji gusht i vitit 1940, në kohën kur Italia fashiste po përgatitej për të sulmuar Greqinë, në shtyp dhe në radio, si dhe me anën e agjentëve po bëhej një propagandë e madhe për të ndezur gjakrat e shqiptarëve dhe për t'i nxitur ata kundër grekëve.

Si bazë e kësaj propagande, përdorej veprimtaria e trupave shoviniste greke kundër popullsisë së jugut në vitet trembëdhjetë-katërmëdhjetë, si dhe masakrat e tyre kundër popullsisë çame, të kryera në kohë të ndryshme. Për këtë qëllim, botoheshin deklarata të atyre që kishin vuajtur vetë ose kishin qenë dëshmitarë të ngjarjeve.

Memo Metua, bashkë me Hasan Bajraktarin e të tjerë, të cilët punonin me popullin për t'i futur atij urrejtjen kundër pushtuesit fashist, i dualën përpara kësaj gjendjeje. Ata shikonin më larg dhe e kuptuan ku donte të dilte propaganda fashiste me këtë

fushatë. Prandaj i tregonin popullit qëllimet e qeverisë fashiste të Musolinit.

Një herë në një fshat, gjatë bisedës me një njeri të njohur në të kaluarën si patriot, po që tani ishte shërbëtor i pushtuesit, Memua pati një diskutim interesant.

— Pse ju, — i tha Memua atij, — propagandoni që populli të shkruhet në milicinë fashiste?

— Për të mirën e Shqipërisë, — ju përgjegj ai.

— E ç'e mirë do t'i vijë Shqipërisë prej milicisë fashiste?

— Do t'i vijë ajo që Shqipëria do të bëhet me të vërtetë Shqipëri.

Ata që ishin aty dëgjonin me vëmendje fjalët e shkurtëra e të prera që shkëmbente sekretari i komunes me «patriotin e njohur» dhe po habiteshin me shprehjen e urrejtjes për njëri-tjetrin, që tregohej në fjalët e ashpra dhe në shikimin e tyre.

— Si ta kuptojmë këtë? — e pyeti Memua.

— Ne nga Italia do të na jepet Çamëria, — ju përgjegj rëndë tjetri.

— E çuditshme shumë kjo logjika juaj! — i tha Memua. — Italia fashiste na ka pushtuar dhe na ka marrë edhe këtë Shqipëri që kishim, kurse ju dhe disa zotërinj të tjerë na thonë se ajo do të na japë edhe Çamërinë. Këto janë gënjeshtër fashiste e asgjë tjetër! — shpërtheu tërë inat ai dhe u bë prush në fytyrë.

— Fashizmi nuk na ka marrë asgjë. Ne e kërkuam vetë atë që të vinte e të na shpëtonte prej regjimit shtypës të Zogut, — ju përgjegj kundërshtari.

— E dëgjoni? — thirri Memua, duke u drejtuar nga të tjerët që u ndodhën aty. — Këta e kanë thirrur vetë Italinë «që të na shpëtonte prej regjimit shtypës të Zogut!» Sa qesharakë! Sa dallkaurë këta «pa-



triotët» tanë! Po këta deri ditën e fundit qenë me Zogun! Këta janë tradhëtarë e jo patriotë! Asgjë tjetër nuk janë!

Pas kësaj bisede vetëkuptohet që fjalët e Memo Metos u raportuan më lart. Mirëpo ngjarjet që rrokulliseshin shpejt nuk u dhanë kohë autoriteteve fashiste të merreshin me këtë nëpunës të vogël, sepse para tyre tani qenë detyra më të mëdha. Po bëheshin përgatitje të ethshme për sulmin kundër Greqisë.

Memua në atë kohë mbajti një qëndrim të hapët dhe të qartë. Ai e dënoi sulmin kundër Greqisë dhe bënte propagandë në popull kundër luftës, kundër tradhëtarëve, të cilët bëheshin vegla të fashizmit, kundër atyre që kërkonin t'u mbushnin mendjen njerëzve që të bëheshin milicë.

Ja se ç'shkruan ai në një vjershë të tij të asaj kohe:

*...Tradhëtarët zbatojnë urdhërat,  
Veshin horrat milici,  
Dhe fillojnë masakrimet,  
Si në Jugë e në Veri...*

Memua u thoshte fshatarëve: «Kush ndihmon Italinë fashiste në luftën e saj kundër Greqisë, ndihmon pushtimin e vendit tonë dhe si i tillë bëhet tradhëtar i atdheut, tradhëtar i Shqipërisë».

Memua dhe shokët e tij në këtë çast delikat punonin me popullin dhe i shpjegonin atij se detyra e çdo shqiptari në këtë luftë ishte që të mos e ndihmonte Italinë fashiste. Ata e kuptonin drejt që humbja e Italisë fashiste në luftë që në interes si të popullit grek, ashtu edhe të popullit shqiptar.

Po bëhej një propagandë e madhe nga të dyja

anët. Në një rënë anë, emisarët e fashizmit kalonin fshat më fshat e punonin për të ngritur njerëzit që t'i regjistronin «vullnetarë» për krijimin e «Shqipërisë etnike», dhe, në anën tjetër, patriotët e vërtetë futeshin në popull dhe i tregonin të vërtetën dhe rrugën që duhej të ndiqte për të mos rënë në kurthin e propagandës së fashizmit. Si rezultat i kësaj pune sqaruese planet e shërbëtorëve të fashizmit për mbledhjen e «vullnetarëve» dështuan.

Me afrimin e forcave greke në krahinën e Kurveleshit, ndërsa administrata e nënprefekturës dhe e komunës kaluan Qafën e Kreshës dhe shkuan në prapavijën e ushtrisë italiane, Memo Metua u largua në anën e kundërt. Ai, me një revolver «beret» për brezi, kaloi në zonën e pushtuar nga ushtria greke.

Memua shkoi në fshatin e tij, në Kuç. Aty që vendosur komanda e një regjimenti të ushtrisë greke.

Gjatë bisedave që pati me oficerët grekë, Memua u bind shpejt që qeveria greke, pasi e kishte zbrapsur agresionin nga vendi i saj, tani kishte synime të tjera karshi Shqipërisë. Ai u deziluzionua nga ky qëndrim, sepse kishte tjetër mendim si për karakterin e luftës që bënin grekët, ashtu dhe për trajtimin e shqiptarëve që qenë kundër fashizmit.

Po nuk që vetëm Memua ai që po habitej dhe nuk e kuptonte një qëndrim të tillë të komandës greke!

Komanda greke vepronte sheshit. Ushhtarët shqiptarë, të cilët kishin dezertuar nga radhët e ushtrisë italiane dhe qenë hedhur në zonat e pushtuara nga ana e forcave greke, ose patriotë të tjerë, të cilët qenë treguar hapët kundër Italisë fashiste, po arrestoheshin e po internoheshin në ishujt e Greqisë.



Atëhere Memua zgjeroi aktivitetin e tij në radhët e popullit. U thoshte bashkëfshatarëve se si fashizmi italian ashtu dhe qeveria greke ndiqnin qëllime për pushtimin e tokave të huaja, sepse që të dy janë agresorë. «Shqiptarët, — u thoshte ai, — do t'i nxjerrin vetë gështenjat e tyre nga zjarri».

Ushtria greke, e mundur nga gjermanët, u tërhoq nga vendi ynë. Në Kurvelesh erdhi prapë ushtria italiane dhe bashkë me të edhe administrata e pushtuesit.

Autoritetet fashiste e thirrën menjëherë Memon dhe kërkuan shpjegime në lidhje me qëndrimin e tij në zonën e pushtuar nga ushtria greke.

Memua me zotësinë e tij mundi të vërtetonte se, gjoja, ai kishte mbetur në zonat e pushtuara pasi kishte qenë i sëmurë dhe ushtria italiane që tërhequr aq shpejt nga Gusmari, sa që ai nuk kishte patur kohë të largohej. Me këto justifikime dhe me informatat që kishin marrë autoritetet nëpërmjet kryepleqësisë së fshatit, sipas të cilave grekët e kishin përdorur keq Memon dhe bile e kishin burgosur, mundi t'i shpëtonte gjyqit ushtarak dhe bashkë me të edhe burgut.

Pasi e lanë ca kohë pa punë, autoritetet e hoqën më në fund nga krahina e Kurveleshit dhe e transferuan, po sekretar komuneje, në Therepel të Skraparit. Këtu e gjeti Memon themelimi i Partisë Komuniste Shqiptare.

## V. PARTIA I TREGON RRUGËN

Lajmi për krijimin e Partisë Komuniste Shqiptarë e mbushi shpirtin e Memos me një gëzim aq të madh, saqë nuk dinte se si ta shprehte. Shokët e tij më të ngushtë thonë se ai në ato ditë të paharruara thoshte me bindje të plotë: «Tani populli ka zot, vendi ka zot».

Pas asaj ngjarjeje të madhe vinin lajme të tjerë për zgjerimin e luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesit. Memua ndjeu një gëzim të veçantë, kur mori vesh se në malet e Kurveleshit kishin dalë ilegalët e parë të partisë. Duke qenë me punë në Therrepel, ai dëgjonte vetë pushkën e partizanëve të parë në malet e Skraparit që luftonin kundër pushtuesit, ndërsa në kodrat e Pezës heroike një grusht trimash, nën udhëheqjen e partisë, po i kallnin tmerrin armikut mu te praku i kryeqytetit. Në këtë kohë dhe pikërisht në dhjetor të vitit 1941 Memua shkroi një vjershë, e cila bëri jehonë për krijimin e partisë dhe luftës që po shpërthente kudo.

Ja se ç'shkruan ai midis të tjerave:

*...Komunistët u mblodhë,  
Dhe formuan partinë,  
Gjithë popullit i thanë:*



— Luftë, luftë për liri!  
Kudo u ndez luftë e rreptë,  
Skrapar, Pezë e Labëri...

Memua, edhe aty midis popullit trim të Skraparit, megjithëse që nën mbikqyrje të rreptë, gjente mënyrat për të punuar dhe propaganduar kundër fashizmit. Sigurisht, ai këtu duhej të tregohej më i kujdesshëm, sepse e shikonte që spiunët e ndiqnin si hije hap pas hapi dhe autoritetet fashiste donin t'i gjenin vetëm rastin që ta varrosnin të gjallë brenda mureve të burgjeve. Por shumë fakte dhe episode tregojnë si ai, kur gjente rast, fliste hapët kundër pushtuesit para shumë njerëzve.

Në fshatrat e Therepelit Memua u njoh dhe lidhi miqësi me shumë patriotë të ndershëm, të cilët, megjithë vuajtjet që kishin hequr, u qëndronin besnikë ideve të luftëtarit të flaktë për çështjen e komunizmit, Riza Cerovës.

Duke u futur në masën e gjerë të popullit, duke ndënjur gju më gju me fshatarët, Memua dëgjonte nga goja e tyre episode nga jeta dhe lufta e Rizait. Ai vinte re se zemrat dhe mendjet e këtyre burrave që kishte para tij nuk e kishin harruar as Rizanë dhe as qëllimin e luftës së tij. Përkundrazi Memua vinte re se, kur ata flisnin për atë kohë, për luftën, për lirinë, sytë e tyre ndizeshin dhe lëshonin shkëndija.

Patriotët e fshatrave të komunës së Therepelit shikonin te Memo Metua një shok të tyre, një luftëtar të papërkulur për çështjen e lirisë së popullit. Ata u afruan me të dhe së bashku punuan për të ngjallur në popull urrejtjen kundër fashizmit dhe shërbëtorëve të tij. Vait Kakruka, veteran i Luftës nacionalçlirim-

tare, tregon me respekt për punën e madhe që ka bërë Memua atje:

«Ne, — thotë ai, — e njohëm shpejt Memo Meton si njeri të vendosur për të luftuar fashizmin. Memua që i zgjuar, me fjalët e tij të mbushte mendjen dhe të bënte për vete. Nuk ruhej nga ne që kishim qenë kundër Zogut dhe tani ishim kundër Italisë, po fliste hapët. Një herë bëri një mbledhje me disa nga ne. Ishim ulur të gjithë nën hijen e një peme. Kur Memua fliste erdhi një karabinier italian dhe i tha që të shkonte në komunë. Ai jo vetëm që s'e përfilli fare, po ju sul karabinierit me të shara dhe e ndoqi. Ky i habitur u largua. Por edhe ne u habitëm dhe i thamë se mos i bënin ndonjë gjë të keqe kur të shkonte atje, sepse ai që ende sekretar i komunës. «Nuk durohen më italianët në vatrën tonë» — na u përgjegj ai. Pasi punoi edhe pak kohë aty, Memo Metua u takua me shokët më të ngushtë të tij dhe pastaj u largua. Më pas dëgjua se ai që një nga drejtuesit e Luftës nacionalçlirimtare në Kurvelesh».

Vait Kakruka tregon edhe një episod tjetër nga puna e Memos me të rinjtë:

«Bëhej një dasmë. Memon e kishin ftuar dhe ai ndodhej aty, midis burrave. Ato ditë në atë fshat kishin lajmëruar shumë djem që të shkonin ushtarë. Veç kësaj kërkoheshin edhe njerëz për t'u veshur milicë. Aty në dasmë u hap fjala që djemtë do të shkonin ushtarë.

— Sa veta duhet të shkojnë nga fshati juaj? — pyeti Memua.

I thanë numrin.

— Ka ndonjë nga ata këtu? — pyeti prapë ai.

— Po, ka, — ju përgjegj një burrë që kishte afër. Ata janë disa e jo një.



Memua bëri një rreth me ta dhe filloi të bisedonte shtruar. Për t'u larguar atyre ndrojtjeve, pse ky qe sekretar i komunes, ja nisi me shaka, duke vënë në lojë ushtrinë fashiste. Pastaj menjëherë, për habitje jo vetëm të të rinjve, po edhe të të mëdhenjve, të cilët nuk e njihnin mirë Memon, filloi të fliste hapët kundër fashizmit e ta quante atë pushtues të vendit tonë dhe armikun tonë kryesor. «Detyra e djemve shqiptarë, — tha ai në atë takim, — nuk është kryerja e shërbimit ushtarak, por lufta e vendosur kundër fashizmit».

Bisedën e bëri të lirë dhe për çdo gjë që thoshte kërkonte mendimin e të rinjve. Pas dasmës thirri prapë disa nga ata djem dhe i porositi që të punonin për të mos shkuar ushtarë. Qëllimi u arrit, shumica dërmuese e djemve të fshatit nuk pranuan të shkonin ushtarë. Ata, pasi ndenjën një kohë të fshehur, muarën pushkët dhe dualën partizanë».

Veteranë të tjerë të luftës mbajnë mend aksionet e kryera nga njësitet e fshatrave të komunes së Therepelit, në të cilat direkt apo indirekt merrte pjesë dhe Memo Metua. Patrioti Pertef Ali Zoti nga fshati Therapel tregon se Memua bëri një punë të mirë duke u dhënë shokëve të lëvizjes informata, që dëgjonte prej nëpunësve të tjerë të administratës dhe të postës së karabinierisë. Një herë, për shembull, ai mësoi se ushtria italiane do të transportonte një sasi municioni nga një vend në tjetrin. Ai njoftoi shokët. U vendos që të bëhej pritë dhe municioni të merrej. Aksioni u krye me sukses dhe municioni kaloi në duart e luftëtarëve të lirisë.

Shoku Vait Kakruka, i cili e ka njohur mirë Memon, tregon:

«Një ditë Memo Metua, si sekretar komuneje

që qe, kishte mbledhur kryepleqtë e gjithë fshatrave të komunes së Therepelit. Qëllimi i mbledhjes qe për të shtrënguar popullin të dorëzonte armët, të paguante taksat, të sigurohej qetësia e të tjera. Po Memua, sa hapi mbledhjen, për habinë e të gjithëve, u foli kryepleqve kundër fashizmit, kundër Italisë. «Detyra e popullit, e të gjithë neve, — u tha ai, — është të sabotojnë fashizmin, të luftojmë, të armatosim popullin dhe ta ngrëmë atë në luftë kundër pushtuesit».

Por ditët kalonin dhe Memua e kuptonte gjithnjë më qartë se ai nuk mund të vazhdonte më në ato kondita. Gjoksi i tij i digjej zjarr nga urrejtja për fashizmin dhe nga dashuria për lirinë e popullit e të atdheut. Ai nuk mund të kënaqej me ato biseda që zhvillonte, me atë punë propagandistike, duke qenë i rrethuar jo vetëm nga shokë, por edhe nga armiq, të cilët e ndiqnin hap pas hapi dhe e raportonin për çdo gjë që bënte.

Nga fillimi i vitit 1942 Memo Metua vendosi të dilte malit dhe t'i kthente pushkën fashizmit. Prej mjaft kohe ai qëndroi si gjysmë ilegal. Herë pas here largohej nga qendra e komunës, shkonte nëpër fshatra e merrej me punë propagandistike ose kalonte në krahina të tjera si në Fier, Berat e gjetkë...

Tani që mori rrugën për në fshatin e tij të lindjes, ecte më i lirë, më i qetë, më i gëzuar dhe me një vendim të prerë: të bashkohej me popullin e tij kundër pushtuesit fashist.

Me të mbërritur në Kuç Memua u takua me shokët, të cilët e kishin filluar aktivitetin me kohë dhe njiheshin nga populli si njerëz që propagandonin vijën e partisë. Biseda me ta e futi Memon në atmosferën e luftës antifashiste që kishte nisur dhe përditë merrte përpjesëtime më të gjera.



Pas disa ditësh, më një prill të vitit 1942, në malet e Kurveleshit u krijua çeta partizane me komandant Bexhet Memën dhe komisar Mustafa Matohitin.

Memua u takua me komandantin dhe komisarin e çetës. Me Mustafanë ai njihej prej kohësh qëkur kishin qenë bashkë oficerë kundërshtarë të regjimit në ushtrinë e Zogut. Mustafai e priti ngrohtë shokun e tij të vjetër dhe i foli atij hollësisht për punën që ishte bërë gjer atëhere, për gjendjen shpirtërore të popullit dhe për perspektivat e luftës.

Pas takimeve e bisedimeve me shokët e fshatit, me Mustafanë dhe Bexhetin, Memua u thirr nga shokët e qarkorit të partisë për Gjirokastrën, të cilët e njihnin mirë aktivitetin e tij kundër regjimit të Zogut dhe kundër fashizmit.

S'kaloi shumë kohë dhe Memua kaloi përfundimisht në ilegalitet. Ngjeshi përmezi një gjerdan me fishekë, hodhi në sup një maliher të shkurtër dhe u bë një nga ata, të cilët, nën udhëheqjen e partisë, luftonin me të gjitha forcat e tyre për lirinë e popullit.

Armiku e nuhati shpejt që Memo Metua i rrëshqiti nga duart dhe bëri ç'mos për ta kapur. Drejtoria e përgjithshme e policisë me shkresën numër 0993, datë 23 mars 1942, drejtuar kuesturës mbretërore Gjirokastër, i kërkonte asaj që të ndiqte dhe të merte masa kundër Memo Metos. Meqenëse kuestura mbretërore e Gjirokastrës nuk mundi dot ta hidhte në dorë luftëtarin e lirisë, drejtoria e përgjithshme e policisë më datën 26 prill po të vitit 1942 e përsëriti prapë kërkësen e mësipërme. Por ishte tepër vonë. . .

Aktiviteti i gjatë i Memo Metos kundër regjimit të Zogut e kundër fashizmit, cilësitë e rralla të tij si njeri me horizont të gjerë si dhe talenti i tij poetik

e bënë atë figurë të njohur të partisë, në fillim në krahinën e Kurveleshit dhe pastaj në gjithë qarkun e Gjirokastrës.

Memua, duke kaluar fshat më fshat e shtëpi më shtëpi, propagandonte vijën e partisë për Luftën nacionalçlirimtare dhe nevojën e ngritjes në luftë. I fliste popullit me gjuhën e thjeshtë e të kuptueshme të komunistëve, po dinte të bënte që kjo gjuhë, këto fjalë, të hynin në zemrën e popullit. U kujtonte fshatarëve vuajtjet që kishin hequr e që po hiqnin, u fliste për trimëritë e të parëve e për detyrën e çdo shqiptari në kohën e tanishme, kur pushtuesi ishte ulur këmbëkryq në vatrën tona. . .

Muaji maj i vitit 1942 solli një ngjarje të rëndësishme për Kurveleshin. Në atë muaj u formua celula e parë e partisë në atë krahinë, e cila do të udhëhiqte luftën e popullit kundër pushtuesit fashist. Muaji maj shënoi edhe një ngjarje të madhe në jetën e Memo Metos. Ai që lajmëruar nga shokët që të shkonte në një shtëpi, e cila ishte njëra nga bazat e partisë në Kuç. Kur shkoi në bazë, pa se atje ishin mbledhur aktivistë të njohur të luftës dhe shokë nga komitetet qarkore të partisë të Vlorës dhe të Gjirokastrës.

Në mbledhje raportoi Mustafa Matohiti mbi situatën në krahinë e për aktivitetin e gjertanishëm të aktivistëve dhe të çetës. Pas diskutimeve dhe shkëmbimit të mendimeve u vendos që të formohej celula e partisë.

Në celulën e parë të partisë për krahinën e Kurveleshit në fillim bënë pjesë Mustafa Matohiti, Memo Metua, Shefqet Peçi, Bexhet Mema, Ago Çeli dhe Ali Lala. Sekretar i celulës u zgjodh Mustafa Matohiti dhe zëvendëssekretar Memo Metua.

Besimi që tregoi partia ndaj Memo Metos që plo-



tësisht i bazuar. Për të kaluarën e tij luftarake kishte fituar dashurinë e shokëve dhe besimin e popullit.

Pas pranimit në parti dhe zgjedhjes së tij si zëvendëssekretar i celulës së krahinës, Memua e kuptonte që tani barra që më e rëndë dhe detyrat më të mëdha; prandaj punonte ditë e natë pa u lodhur, duke kaluar nga njëri fshat në tjetrin, nga njëra mbledhje në tjetrën, nga njëri aksion në tjetrin. Në historikun e fshatit Kuç thuhet:

«...Që atëhere ai u bë një nga organizatorët më të talentuar të krahinës së Kurveleshit. Në fshatrat e kësaj krahine çonte fjalën e partisë dhe ndizte kudo flakën e urrejtjes për pushtuesit dhe tradhëtarët në çdo zemër kurveleshase...»

Gjatë kësaj kohe te Memua u zbuluan cilësitë e tij më të mira si organizator i shquar, propagandist i zoti dhe orator i talentuar.

Në këtë kohë detyrë kryesore e partisë për krahinën që puna propagandistike dhe organizative për krijimin e njësiteve guerrile dhe për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare në çdo fshat. Memua, bashkë me shokët e tjerë të celulës, ju përvesh punës dhe pati suksese të rëndësishme.

Një punë të madhe, gjatë verës së vitit 1942, Memua bëri me rininë. Sipas vendimeve të celulës së partisë, shkante nëpër fshatra dhe me elementët më të mirë e më revolucionarë formonte grupe edukative dhe organizata rinie. Kjo nuk që punë e lehtë. Më parë shkante e njihej me njerëzit, bisedonte me ta veç, zgjidhte ata që qenë më revolucionarë, më të vendosur për luftën dhe bënte mbledhje, në të cilat punonte tema edukative dhe shtronte detyra konkrete. Pasi kalonte një kohë, shkante prapë në atë fshat dhe kontrollonte punën që kishin bërë të rinjtë,

sipas detyrave që u kishte vënë më parë. Në këto takime të dyta i shohiste mirë punët, linte mënjanë elementët që nuk tregonin aktivitet ose u trembeshin vështirësive, kurse me të tjerët, që kishin kaluar me sukses provat e para, formonte organizatën e rinisë së fshatit.

Në muajin korrik të vitit 1942, Memua që i deleguar i celulës së partisë për formimin e organizatës së rinisë në fshatin Kuç. Në mbledhje qenë thirrur të rinj të sprovuar në aksione të ndryshme dhe në punën propagandistike, njerëz që kishin punuar një kohë pak a shumë të gjatë dhe ishin treguar trima dhe të vendosur për çështjen e partisë.

Memua u foli të rinjve mbi situatën e jashtme dhe të brendshme; pastaj u përqëndrua në detyrat e organizatës së rinisë, duke i zberthyer këto me punën konkrete që duhej të bëhej nga të rinjtë. Më në fund, pasi diskutuan edhe të rinjtë vetë, mbledhja mori vendime të rëndësishme për gjallërimin e punës propagandistike në fshat, si me të rinjtë e tjerë ashtu dhe me të moshuarit. Memua kërkoi nga të rinjtë, që bënin pjesë në organizatë, që ata vetë të ishin shembull në çdo drejtim, të parët në çdo aksion e në çdo luftim kundër armikut. Kështu vepronte Memua në çdo fshat për ngritjen e organizatave të rinisë.

Përpjesëtimet e gjera që merrte Lufta nacional-gjirimtare në krahinën e Kurveleshit bënë që qeveria fashiste të intensifikonte veprimtarinë e saj në të gjitha drejtimet. Për të shuar zjarrin e luftës partizane, armiku, përveç ushtrisë, frikësimeve në popull, arrestimeve e kompleteve për të vrarë udhëheqësit e luftës në prita apo pas shpine, përdori në



çdo rast edhe tradhëtarët e atdheut, të cilët në mënyrë të hapur apo të maskuar i shërbenin atij.

Në krahinën e Kurveleshit një nga tradhëtarët kryesorë gjatë kësaj kohe qe edhe Zenel bej Gjoleka nga Kuçi. Qeveria fashiste e dërgoi posaçërisht atë që nga Tirana në vendlindjen e tij. Ai nisi menjëherë nga puna për të përçarë popullin dhe për ta larguar atë nga rruga e drejtë që kishte zgjedhur. Për t'i dalë në krye misionit të tij, Zenel Gjoleka mobilizoi rreth vetes edhe tradhëtarë të tjerë.

Që ta demaskojë Zenel bej Gjolekën nuk qe dhe aq lehtë. Ai qe njeri i gojës, i rafinuar dhe i stërvitur në dhelpëria të çdo lloji. Meqë rridhte nga familja e Gjolekës së parë, i cili në kohën e vet kishte bërë shumë për Shqipërinë, Zenel Gjoleka përpiqej të përfitonte nga emri i mirë që gëzonte fisi i tij. Mirëpo rruga që kishte nisur ndryshonte fund e krye nga ajo e Gjolekës së parë. Ky gjithmonë i shërbente atij që e paguante më shumë. Që nga viti 1924 kishte ikur jashtë shtetit dhe ishte kthyer bashkë me pushtimin e Shqipërisë prej trupave fashiste italiane. Duke shfrytëzuar urrejtjen që kishte populli për regjimin e Zogut, Zeneli hiqej si patriot, i cili nuk qe pajtuar me regjimin shtypës së mbretit tiran. Pra, beu tradhëtar, që hante në grazhdin e fashizmit dhe që u dërgua prej tij për të penguar luftën çlirimtare të popullit duhej demaskuar plotësisht.

Një nga ata që, në emër të partisë dhe të popullit, u përlesh që në fillim ballë për ballë me Zenel Gjolekën, qe edhe Memo Metua. Ai në radhë të parë bëri një punë me popullin, veçanërisht me atë të fshatit Kuç, për t'i treguar se kush qe në të vërtetë «beu patriot».

Polemikat e zjarra dhe të ashpra të Memos me beun politikan, fjalët e tij të zgjedhura që godisnin në shenjë dhe ironia e tij therëse e habitën dhe e hutuan beun mendjemadh. Në bisedat që bënte beu thoshte se mund të pranonte të bisedonte me këdo tjetër nga njerëzit e Luftës nacionalçlirimtare, kurse me «djalin e fshatit që kishte marrë rrugë të ligë», domethënë me Memon, as që donte të fliste me gojë. Në fakt ai bënte çmos që t'i shmangej çdo takimi e çdo ballafaqimi me Memo Meton.

Kuçiotët shikonin me admirim këtë bir të tyre, i cili, kur që ende fëmijë i varfër, kishte hyrë shërbëtor dhe ruante bagëtinë e Gjolekasve, ndërsa tani në mes të fshatit demaskonte beun dhe i vinte në ballë vulën e tradhëtarit, me qëllim që ta njihnin të gjithë.

Në bazë të kësaj pune sqaruese u arrit që propaganda e njerëzve të fashizmit të demaskohej në popull dhe agjentit të tij Zenel Gjolekës të mos i besohej më.

Kjo histori me beun e Kuçit ka edhe vazhdimin e saj. Kur Zenel Gjoleka e pa se fjala e tij nuk zinte më vend në Kurvelesh dhe po i rrëshqiste toka nën këmbët e veta, u shtrëngua të largohej një herë e mirë nga vendlindja. Para se të largohej nga fshati Kuç, u takua me përfaqësuesit e lëvizjes dhe u dha fjalën se nuk do të merrej më me punët e fshatit, por me një kusht, siç tha vetë, «që Memo Metua të mos më nxjerrë ndonjë këngë».

Ky «kusht» që vuri Zenel Gjoleka para se të largohej nga fshati duket pak si i çuditshëm, por ja që është fakt dhe këtë e di i gjithë Kuçi. Kërkesa e tij nuk që e rastit. Memo Metua shumë nga krejt e reaksionit jo vetëm që i kishte demaskuar pa-



ra popullit me oratorinë e tij, por me anë të vjer-  
shave satirike i kishte vënë në lojë.

Memua, kur e mori vesh këtë kusht të beut, qe-  
shi. Pas pak kohe, kur gjeti rastin, ai u ul dhe shkroi  
poemën e tij satirike «Bashkëfjalim me një bej», e  
cila fillon me këto vargje:

Më dëgjo, të lutem shumë,  
o imi bej!  
Do kuvëndoju pak me ty  
e do rrëfej,  
Po përpara se të flas  
e të filloj,  
Oxhakun lart e më lart  
do ta uroj!

.....

Nacionalistë me prova  
jo të lekut!  
Asnjëherë nuk ju shitët  
Jorgo Grekut!..

Memua, pasi rendit dallaveret dhe tradhëtitë  
e tij, i kthehet me shufër fytyrës së beut:

Ajo që përtej detit  
ty të shpuri,  
Me kapistër, tok me shokët,  
prapë të pruri...  
Dhe më poshtë vazhdon:  
Biseda që bëre sot,  
o imi bej,  
Është plot realitet,  
unë s'gënjej.  
Unë jam popull punëtor  
i raskapitur,

*Nuk jam bej, as tradhëtar,  
as i shitur!  
Jam fshatar e dal nga turma  
e papërlyer,  
Rroj me djersë e s'pranoj  
për të gënjyer...*

Poemën e tij të gjatë, Memua e mbyll:

*Qaj, o bej, për ato bahçe  
plot burbuqe,  
Qaj, o bej, ti për meashe,  
për kolltuqe!*

Kjo poemë, ashtu si të gjitha vjershat dhe poemat e tjera të Memos, u përhap shpejt, u mësua përmendësh dhe këndohej e recitohej nga partizanët e nga populli.

Kur e mori vesh se Memo Metua i «kishte ngritur këngë», beu u interesua për përmbajtjen e saj dhe, pasi e mori në dorë, tha: «Më mirë të më kishte vrarë, se sa më ngriti këtë këngë!». Këto fjalë Zenel beu i përsëriti edhe pas mbarimit të Luftës nacionalçlirimtare, kur ai doli para gjyqit si armik i popullit...

Zgjerimi i vazhdueshëm i luftës së popullit, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, krijonte gjithnjë probleme të reja.

Armiku përdorte sipas rastit gjithfarë lloj parullash për të penguar e frenuar luftën e armatosur të popullit. Kështu një ditë, në qershor të vitit 1942, Memua, në një takim që kishte me popullin e një fshati, vuri re se disa kundërshtarë të Luftës nacionalçlirimtare si argumenta të propagandës së tyre përdornin çështjen e pjesëmarrjes së gruas në luftë. Ata e shtrembëronin me qëllim propagandën që bënte



partia, që në këtë luftë duhej të hidhej i gjithë populli, duke përfshirë edhe gratë e të rejat. Në këtë takim shumë gra dhe vajza u ngritën dhe shfaqën mendimin e tyre. Ato demaskuan me forcë shpifjet e tradhëtarëve, të cilët donin të mohonin të drejtën e tyre për të luftuar krah për krah me shokët dhe vëllezërit. Bisedat qenë të zjarra dhe të dyja anët ngulnin këmbë në mendimet e tyre.

Memua, pasi dëgjoi ç'u tha aty, mori fjalën dhe me logjikën e tij të fortë e me ironinë e mprehtë i bëri kundërshtarët të heshtnin. Në pikën kulminante të bisedës, ai ju drejtua një kundërshtari që shkumëzonte më shumë nga të tjerët, duke e quajtur jo të drejtë aktivizimin e vajzave në luftë.

— A ka patur nga ky fshat më 1913-1914 gra që kanë luftuar krah për krah me burrat? — pyeti ai dhe pasi përmendi shumë emra, nxori nga çanta e tij një fotografi të këputur prej faqeve të një libri e ja kaloi atij.

— Të lutem, shikoje pak këtë këtu dhe më thuaj ç'farë pe! — nguli këmbë Memua.

Kundërshtari e mori fotografinë e vjetër e të zverdhur nga koha dhe po e shikonte me kujdes. Në të dukeshin mirë një radhë burrash të moshave të ndryshme të vendosur prapa një ledhi. Ata kishin hedhur supeve në vend të palltove nga një lëkurë dashi, kurse me pushkët e gjata që mbanin ndër duar po qëllonin tutje. Tymi i barutit të djegur kish-te formuar mjegull para tyre. Pranë burrave qenë disa gra, të cilat u zgjasnin atyre që po luftonin kreher me fishekë.

Kundërshtari po e shikonte fotografinë si i hutuar.

— Jepua edhe shokëve të tjerë ta shikojnë, —  
i tha Memua.

Fotografia kaloi dorë më dorë.

— O, kjo është një nga çetat patriotike të Shqipërisë së Veriut, — tha me zë të lartë një plak patriot, sa e pa fotografinë.

— Po, po, ajo është, — e vërtetoi një tjetër.

— E shikoni, pra, që gruaja shqiptare gjithmonë është ndodhur përkrah burrave, kur ka qenë puna për të luftuar për liri? — u tha Memua të gjithëve. Pastaj ju drejtua burrit, me të cilin kishte pasur diskutime më të gjata:

— Si thua zotrote, mos kanë qenë komunistë edhe ata patriotët e Veriut që janë aty në fotografi, duke luftuar bashkë me gratë?

Kundërshtari u përtyp pa qenë në gjendje të përgjigjej. Memua vazhdoi të shpjegonte se gratë shqiptare gjithmonë kanë luftuar. «Po kjo luftë që po bëhet sot, — tha ai, — nuk është si të parat. Gratë më parë kanë luftuar për të mbrojtur vatanin, kurse sot do të luftojnë edhe për të çliruar atdheun edhe për të fituar lirinë dhe të drejtat e tyre».

Pas disa ditësh dorë më dorë e gojë më gojë fshatrave të Kurveleshit u përhap një vjershë tjetër e Memo Metos me titull: «Për liri», e cila këndohej nga rinia revolucionare ndër mbledhje, dasma e gostira.

Ajo fillonte:

*Shokë e shoqe të bashkuar*

*gjithë tok,*

*Njësoj jemi si ti unë*

*shoqe e shokë!...*



*Me punën, me djersën tonë  
ne të rrojmë,  
Pa dallime dhe pa klasa  
të punojmë...  
...Të na zhduken gjithë ferrat,  
tradhëtarët.  
T'i marrin punët në dorë  
proletarët.*

Celula e partisë e Kurveleshit, ku bënte pjesë edhe Memua, bëri një luftë të hapët e të ashpër kundër tradhëtarëve, duke i demaskuar ata pa mëshirë dhe duke u treguar se durimi i popullit për punën e tyre të ndyrë kishte një kufi.

Autoritetet fashiste dhe «paria e krahinës» vazhdonin të vinin «rregull» në Kurveleshin, që ziente nga lufta e armatosur dhe propaganda e partisë. Ata kalonin fshat më fshat dhe me demagogjinë e tyre të stërholluar mundoheshin ta largonin popullin nga lufta që kishte nisur. Kur ata e shikonin se propaganda e tyre nuk zinte vend, kalonin në kërcënime të hapta.

Një zell të madh si shërbëtor i fashizmit tregoi në këtë kohë nënprefekti i Kurveleshit Nevruz Taçi. Ai u paralajmërua disa herë që ta mbyllte gojën e të ndërpriste veprimtarinë e tij antipopullore, po tradhëtari e kishte shitur një herë e mirë lëkurën. Celula e partisë dhe çeta e dënuan atë me vdekje. Më 5 qershor Nevruz Taçi po kthehej nga fshati Golem, ku kishte shkuar për të përcjellë tradhëtarë të tjerë me në krye prefektin e Gjirokastrës, të cilët kishin qenë për të propaganduar kundër luftës në Kurvelesh dhe për zhdukjen e çetës partizane.

Në mes të rrugës, në vendin e quajtur Qafa e

Koçes, një njësit i përbërë nga komandanti i çetës Bexhet Mema dhe partizanët Dalip Seferi, Xheladin Beqiri dhe Dilaver Poçi zbatuan vendimin e marrë. Nevruz Taçi e pagoi tradhëtinë e tij. Ky akt ishte si një paralajmërim edhe për tradhëtarët e tjerë, të cilët i priste i njëjti fat.

Guximi i çetës partizane i tërhoi armiqtë. Ata organizuan dhe kryen një operacion ushtarak në gjithë krahinën, të cilin e drejtoi vetë prefekti i Gjirokastrës, fashisti i tërbuar Tahir Kolgjini.

Memo Metua, bashkë me komunistët e tjerë, punonte ditë e natë për të ngjallur në popull edhe më tepër urrejtjen kundër fashizmit dhe për ta ngritur atë në luftë të vendosur e gjer në fund. Si rezultat i një pune të madhe që kryen komunistët e patriotët të tjerë, populli i Kurveleshit në ditët e operacionit armik u bashkua më tepër me partinë dhe u hodh më me vendosmëri në luftë.

Gjatë operacionit dhe pas tij forcat e pushtuesit dhe tradhëtarët shpërthyen një fushatë të gjerë duke propaganduar e shpifur kundër shokëve të çetës dhe kundër aktivistëve të dalluar. Veç këtyre përdorën frikësime dhe terrorin më të egër. Në ato ditë në qiellin e kaltër të krahinës së Kurveleshit dukeshin aeroplanë që, pasi bënë disa rrotullime mbi fshatra, lëshonin pas një tym të bardhë që formonte një rreth të madh që donte të thoshte se krahina që e rrethuar nga të gjitha anët. Pastaj ata hidhnin fletushka me përmbajtje propagandistike. Veç këtvre në muret e ndërtesave dhe në trungjet e pemëve ngjiteshin lajmërimet, ku thuhej se do të bëheshin bombardime të egra nga aviacioni dhe artileria, do të hidheshin gazra helmuese e të tjera.



Krahas këtyre veprimeve agjentët e fashizmit përhapnin lloj-lloj parullash.

Fashizmi bënte shumë që ta frikësonte popullin e Kurveleshit.

Një ditë gjatë këtij operacioni të madh, që drejtohej nga Tahir Kolgjini, Memua ishte duke zhvilluar një bisedë në një fshat të Kurveleshit. Ai po fliste me zjarr kundër veprimtarisë kriminale të prefektit fashist e parullave të tij djallëzore, vinte në dukje veprimtarinë e çetave partizane në krahina të ndryshme të vendit. Kur ai ishte duke folur, një fshatar aty para tij po shikonte një copë letër nga ato të armikut. Memua e pa.

— Ç'e ke atë? — e pyeti ai fshatarin.

— Na, shihe, — ju përgjegj ai dhe i zgjati fletushkën.

— Unë jam ngopur me gjepurat e fashizmit, — ju përgjegj Memua, pa e prekur fare letrën me dorë. Pastaj ju drejtua të tjerëve: — Besoj që të gjithë jemi ngopur me parullat e armikut, apo jo?

— Përmendësh i dimë ç'shkruajnë, s'ka nevojë t'i lexojmë, — ju përgjegjën disa zëra së bashku.

— Edhe plaka ime që s'di shkollë i ka mësuar më mirë nga unë, t'i thotë një për një të gjitha gënjeshtrat që shkruhen aty, — bëri shaka një burrë i moshuar.

Ky shembull i vogël tregon se parullat e armikut qarkullonin nëpër fshat, po as gratë e as burrat, as pleqtë e as të rinjtë, të cilët qenë lidhur me luftën, nuk donin t'ja dinin nga kërcënimet e premtimet boshe të fashizmit.

Kjo frymë e lartë luftarake e populit, e cila qe arritur në bazë të punës së partisë, e frymëzoi Memo Meton që të shkruante një nga vjershat e tija më të

bukura të asaj kohe. Kjo vjershë luftarake, titullohet «Kurvelesh, zemra ime», u bë një nga këngët e tij më të njohura jo vetëm në krahinën e Kurveleshit dhe në qarkun e Gjirokastrës, por edhe gjetkë.

Ja si e përshkruan poeti atmosferën e luftës së asaj kohe në Kurvelesh.

*Kurvelesh, zemra ime  
Kurvelesh,<sup>1)</sup>  
Ç'janë këto lajmërimi?  
Na dërgon Duçja lëvdime,  
Dita-ditës frikësime:  
«Do të bëhen bombardime,  
Zjarr e flakë e shkatërrime,  
Shtëpitë copë e thërrime,  
Do mbeten foshnjat jetime!...»*

Si përgjegje e gjithë këtyre kërcënimeve vjen përgjegjja:

*...Rrofsh moj djalëria trime!..*

Tahir Kolgjini, që drejtonte personalisht operacionin ushtarak në krahinën e Kurveleshit, kaloi fshat më fshat duke bërë një propagandë fashiste, po shumë të rrafinuar dhe të maskuar. Demagogjia e tij e shfrenuar arriti në një pikë të tillë, sa të thoshte me hipokrizi prej fashisti: «Edhe unë jam komunist, por kur të vijë koha ama,» «Edhe unë jam kundër fashizmit, që na ka pushtuar vendin, po luftën duhet me e fillue kur të vijë koha», «Unë nuk due me i kap ata partizanët hajduta, se po të due, brenda ditës i bie para kambëve të mia» e të tjera. Memua

---

1) Përsëritet pas çdo vargu.



u jepte menjëherë kundërpërgjegje të goditura këtyre parullave falso dhe vinte në lojë prefektin fashist.

Fjalët e Memos me gojën e ndonjë djali të guximshëm apo patrioti arrinin gjer te veshi i prefektit dhe i përplaseshin atij në fytyrë si një përgjegje nga gjithë populli i Kurveleshit.

Duke ndeshur kudo në urrejtjen dhe qëndresën e popullit të Kurveleshit, duke mos mundur të shtjerrë dot në dorë asnjë nga ata që kërkonte me çdo kusht, sidomos Mustafa Matohitin, Bexhet Memën, Dalip Seferin dhe të tjerë, prefekti fashist u detyrua të mernte rrugën e kthimit për në Gjirokastër i turpëruar e duarbosh.

Ai me gjithë mburrjet dhe kërcënimet se do të vriste, digjte, internonte e burgoste përkrahësit e komunistëve, tani nisi të kujdesej për kokën e tij, sepse e dinte mirë që s'behej shaka me ata që qenë malit.

Gjatë rrugës së kthimit, ai ra një mbrëmje në një shtëpi në Gusmar. Atje zhvilloi një bisedë me ca fshatarë. Diku, aty afër, u rrëzua një mur i vjetër, i cili bëri zhurmë të madhe. Një nga pjesëmarrësit e bisedës thirri: «Më duket se po vijmë partizanët!» Prefektit ju duk sikur dëgjoi se «po sulmojnë partizanët»; me vrap doli jashtë dhe u fut në një haur aty afër shtëpisë, ku ndodhej edhe një gomar. Pastaj, thonë sikur i zoti i shtëpisë shkoi në haur për të kërkuar prefektin, por ai ishte fshehur në një qoshe dhe në vend të tij paskej kapur për veshi gomarin dhe ky ja paskej dhënë të pallurit.

Nga kjo e thënë Memo Metua gjeti rastin ta demaskonte e ta bënte qesharak në sy të popullit prefektin e fashizmit. Për këtë episod ai shkroi vjer-

shën satirike të njohur dhe të përhapur shpejt me titull «Prefekti në haur», e cila midis të tjerave thoshte:

*...Ky prefekti nur, o nur,  
Gjysma turk, gjysma kaur.<sup>1)</sup>  
Një natë që ra një mur,  
Vate u fut në haur!..  
Pati frikë? A ç'farë pati?  
Atje ishte dhe veshgjati...*

Kjo vjershë e re e Memos që u përhap shumë shpejt këndohej si këngë labe dhe recitohej nga të vegjëlit. Kur e dëgjoi Tahir Kolgjini, kërkoi t'ja përsërisnin edhe një herë. Pasi e kuptoi mirë, ai shtrëngoi dhëmbët. Po prefekti fashist, me gjithë xhindosjen e tij, s'kishte ç'të bënte. Poeti, që e kishte shkruar këngën, ndodhej në malet e lira të Kurveleshit; ai me kohë ja kishte kthyer pushkën si pushtuesit fashist, ashtu edhe Tahir Kolgjinit, i cili i shërbente fashizmit.

Memo Metua që njeri me horizont të gjerë. Ai jo vetëm ndiqte luftën e popullit tonë në krahina të tjera, po ndiqte edhe luftën dhe përpjekjet e popujve të tjerë, në radhë të parë të atyre fqinjë, që bënin kundër të njëjtit armik. Ai propagandonte në popull fitoret e Ushtrisë së Kuqe, luftën e popullit sovjetik, luftën e popujve të tjerë.

Duke bërë konferenca me fshatarët, Memua u zbulonte atyre të vërtetën e gjendjes në frontet e ndryshme dhe pastaj tallej me mburrjet e fashistëve.

---

1) Lodër fjalësh me emrin dhe mbiemrin e prefektit.



«Trupat glorioze fashiste po sulmojnë prapa!» ose:  
«Trupat e pathyeshme fashiste, duke marshuar me  
shpejtësi të madhe prapa, kanë çliruar tokat që kishin  
okupuar vetë!» e të tjera.

Ai shkroi vjersha, ku ngrë lart heroizmin e po-  
pullit sovjetik e të popujve të robëruar të Evropës.  
Respekt të madh kishte Memo Metua për luftën e  
ashpër e heroike të popujve të Ballkanit.

Një vjershë të bukur me përmbajtje të lartë ideo-  
artistike shkroi Memua në shtator të vitit 1942 me  
titull: «Jemi trimat e Ballkanit». Ja se si shkruan  
poeti, midis të tjerave:

*...Cilët janë ata që vdesin  
për liri?  
Gjithë ç'kanë, edhe jetën  
bëjnë fli?  
Me këngë në gojë vriten  
malazeztë,  
Si sovjetët kthyen vendin  
n'një fortesë!..*

Dhe më poshtë:

*...Edhe trimat e Greqisë  
derdhin gjak,  
Gjithë me armë u ngritën  
djalë e plak...*

Kurse për vendin e tij të dashur, Memua thuri  
vargjet më të bukura dhe më të goditura:

*Për lirinë zjarr u ndezën  
shqiptarët,*

*Trimërinë e trashëgojnë*  
*nga të parët,*  
*Jemi pak, po djem stërralli*  
*dhe luftojmë,*  
*E armatat e fashizmit*  
*i coptojmë...*

Memo Metua, talentin e tij poetik e përdori në radhë të parë për t'i kënduar popullit të tij që po ngrihej në Luftën nacionalçlirimtare. Po njëkohësisht ai e përdori edhe për të goditur e demaskuar armiqtë e popullit.

Veip Runa me kohë që vënë në shërbim të pushtuesit fashist. Ai e priti mirë ardhjen e Italisë, pranoi nëpunësira prej qeverisë deri në detyrën e prefektit, u tregua i zellshëm për të propaganduar kundër Luftës nacionalçlirimtare. Po ky njeri gjatë kohës së Zogut që treguar besnik i mbretit dhe kish-te qenë i gatshëm të shërbente atje ku ta çonin.

Veipi nganjëherë shkruante edhe vjersha. Kësh-tu ai në korrik të vitit 1941 botoi në gazetën e fashizmit «Tomorri» një vjershë të gjatë, në të cilën mallëkonte e shante popullin e Kurveleshit, që nuk e dëgjoi atë gjat Luftës italo-greke për të mbajtur anën e fashizmit, për t'u regjistruar «vullnetarë» kundër grekut. Pasi mburr veprimet e italianëve, përfundon me një lavdërim të thellë për Duçen dhe Hitlerin dhe thotë në mbyllje se Duçes do t'i ngrihet monument në malet tona.

Memo Metua, në kohën kur Veip Runa u aktivizua shumë kundër Luftës nacionalçlirimtare, shkroi një vjershë të gjatë, e cila u përhap shpejt dhe luajti rol të madh si për demaskimin e Veip Runës, ash-



tu edhe të propagandës së tij, e cila drejtohej nga zyrat e fashizmit.

Në fillim Memua vë në dukje se «poeti i zgjedhur» është kredhur në të gjitha llumet. Pastaj vazhdon:

*...Jeniçer nga të sulltanit,  
Që nuk di se ç'është frika,  
«Patriot nga të vatanit»,  
Me jataganë e me thika.  
Kur dilte dhuronte shpata  
«Heroinave të Atdheut»<sup>1)</sup>,  
Shpata dy metra të gjata,  
Armatim i Hodo Beut.<sup>2)</sup>*

E njohur është edhe poema tjetër satirike e Memo Metos prej nëntëdhjetë e gjashtë vargjesh me titull: «Aziz Strategu». Kjo poezi ka një bukuri të veçantë nga ana e thurjes dhe një ndërtim të gartë e të kuptueshëm. Në këtë poemë Memo Metua demaskon pa mëshirë një nga krerët e forcave të «Ballit Kombëtar» Aziz Çamin, i cili e hiqte veten si njeri trim dhe njohës i zoti i artit të luftimit. Po kur atij i ra rasti që ta tregonte trimërinë dhe zotësinë e tij kundër partizanëve, atëhere u bë gazi i botës, sepse iku nga sytë këmbët, duke mos pyetur fare për shokët e tij. Le t'ua lëmë vendin strofave të Memo Metos:

---

1) Gjatë një vizite që bënë princeshat në Jug më 1937 Veip Runa si shenjë respekti u dhuroi atyre një shpatë.

2) Hodo Aliu nga Nivica, një nga drejtuesit e kryengritjes në vitet dyzetë të shekullit të kaluar.

*Atje përposh në Tragjas,  
U shqye fshati në gaz,  
Me një batalion të Ballit,  
Që përroit u përplas...*

*Një përroit afër zallit,  
Kishte pritën çeta e Ballit,  
Mirëpo nuk bëhej shaka,  
Me ata që zbrisnin malit.*

Pastaj vazhdon:

*Qëndrim komandanti mori,  
Zërin më me forcë e çorri:  
— O burrani, se na zunë,  
T'ikim poshtë nga Izvori!..  
Po ballistët të edukuar,  
Nga çdo gjë ishin shkarkuar,  
Pa dhënë urdhër komandanti,  
Ishin sosur në Izvor...*

Më poshtë Memua përshkruan shturjen në stabin e armikut:

*Urdhëri hala pa dhënë,  
Si mos qoftë për të thënë,  
Një pjesë e çetës balliste,  
Karaburunin kishte zënë.  
Lanë dyfek e fishekë,  
Revanë në këmish e brekë,  
U mbetën kërcinjtë jashtë,  
Tamëm si haxhilelekë.  
Komandant Aziz Strategu,  
Që ishte fshehur pas një bregu,*



*Fluturonte me të katra,  
Nuk shikonte ku ishte shtegu...*

Më në fund, kur tradhëtarët të shpartalluar u grumbulluan në strofkullën e armikut, Memua i goditi me një ironi të goditur:

*Shyqyr që shpëtoi çeta,  
Se ishte e madhe si bleta,  
Batalion a ç'dreq i thonë,  
Me Azizin njëzet veta...*

Memua tani gëzonte dashurinë e popullit dhe të shokëve, kishte fituar autoritet dhe qe bërë figurë e njohur e luftës jo vetëm në krahinën e Kurveleshit, po edhe në gjithë qarkun e Gjirokastrës. Atë mund ta shikoje kudo, duke zhvilluar biseda e konferenca me popullin, me anëtarët e këshillave nacionalçlirimtare, me rininë. Puna e tij organizative dhe propagandistike jepte rezultate të mira dhe partia e çmonte duke e aktivizuar Memon në drejtime të ndryshme.

Nga ana tjetër qeveria fashiste e konsideronte atë një nga kundërshtarët e rrezikshëm të saj. Ajo e kuptonte që aftësia e Memos për të demaskuar fashizmin si dhe zotësia për të tërhequr masat e gjera të popullit në rrugën e Partisë Komuniste i prishnin shumë punë dhe po i nxirrnin telashe jo të vogla.

Ndaj nisi të kurdiste plane dhe komplete kundër kuadrove kryesore të luftës në këtë krahinë. Ja një shembull që dëshmon fare mirë për këto plane të errëta të qeveritarëve fashistë.

Në gusht të vitit 1942 prefekti i Gjirokastrës që kishte ardhur në Kurvelesh në krye të forcave ope-ruese, një natë të errët thirri një burrë nga Progonati

dhe pati me të një bisedë vetëm për vetëm. Prefekti Tahir Kolgjini i propozoi fshatarit që të vriste Mustafa Matohitin dhe për këtë do t'i jepej një shumë e madhe të hollash. Ai tregoi edhe mënyrat se si duhej ta vriste, si të afrohej në çetë e të tjerë. «Paratë mund t'i marrësh qysh tash, mjaft që ti ta vrasësh Mustafanë», i tha prefekti. Burri u mendua pak dhe ju përgjegj: «Dua të mendohem nja dy ditë». Më të nesërmen, ai burrë shkoi dhe u takua me të vërtetë me Mustafa Matohitin, po jo për ta vrrarë, po për ta lajmëruar atë mbi intrigat e fashistit Tahir Kolgjini. Raste të tilla pati edhe të tjera.

Duke parë se zhdukja e shokëve kryesorë të luftës në atë krahinë s'mund të bëhej as me pushkë, as me atentate prapa shpine, agjentët fashistë nuk hoqën dorë nga qëllimet e tyre, por u përpoqën të krijonin shkaqe të rreme për t'i armiqësuar ata me popullin, duke u hequr kështu mbështetjen e tyre kryesore.

Në këtë kohë fashizmi aktivizoi shërbëtorët e tij, që vepronin të maskuar dhe loznin rolin e atyre njerëzve që s'i kuptonin drejt çështjet e luftës. Ata hidhnin parulla disfatiste dhe shpifnin kundër drejtuesve të luftës, duke dashur që t'i diskreditonin para syve të popullit. Një nga këta ka qenë Jupe Brahimi, nga Kuçi i Kurveleshit.

Ky qe një njeri i degjeneruar, spiun, pijanec dhe kumarxhi, i cili qe, vënë tërësisht në shërbim të pushuesit fashist. Aty nga tetori i vitit 1942 Jupe Brahimi zuri të fliste hapur para popullit kundër Luftës nacionalçlirimtare, duke sharë aktivistët e lëvizjes dhe duke deklaruar se ai do t'jau tregonte vendin komunistëve. Për këtë aktivitet të tij në favor të armikut ishin vënë në dijeni edhe shokët drejtues



të partisë për qarkun e Gjirokastrës. Dhe që marrë vendim që ai të vritej. Kështu ditët e tij qenë të numëruara.

Në ato ditë tetori në Kuç bëhej një dasmë, në të cilën merrnin pjesë, veç të tjerëve, edhe shumë aktivistë të Luftës nacionalçlirimtare. Aty kishte ardhur edhe Jupja, i cili sapo që kthyer nga Gjirokastra, ku kishte vajtur për të raportuar mbi ngjarjet që zhvilloheshin në Kuç. Ai, duke ju drejtuar shokëve të lëvizjes, i kërcënoi ata dhe mu aty në mes të fshatit revolucionar u përpoq të këndonte një këngë për Duçen.

Përgjegjja e shokëve që e menjëhershme. Jupja u përzu nga dasma dhe çështja ju raportua një shoku të qarkorit të partisë, i cili u ndodh atë kohë në Kuç. Pa mbërritur ende në shtëpinë e tij, tradhëtari u vra. Kështu u zbatua vendimi i marrë qysh më parë nga shokët e partisë.

Kjo ngjarje u bë objekt diskutimesh e polemikash, sidomos për mënyrën se si u krye vrasja. Disa nga fshatarët, që nuk e dinin mirë veprimtarinë e Jupes në favor të armikut, të nisur nga forca e zakonit, e dënuan kryerjen e vrasjes në kohën e një feste të tillë gazmore, siç është dasma dhe në një vend që nuk ishte as dyqind metra larg nga shtëpia, ku kishte njerëz të pirë nga farefisi i tij.

Të afërmit e Jupes, të nxitur nga armiqtë e Luftës nacionalçlirimtare, reagues menjëherë dhe kërkuan të merrej haka e njeriut të tyre, duke vrarë aktivistë të luftës. Gjakërat u ndezën keq dhe çështja mund të kishte përfunduar në një tragjedi me shumë viktima, sikur të mos kishte fituar arësyeja e patriotëve kuçiotë, të cilët edhe në këtë rast treguan pjekurinë e tyre të njohur prej kohësh.

Po megjithëse gjakderdhja u shmang, këtë gjë armiku e kapi mirë dhe e shtjelloi më tutje. Njerëzit dhe farefisi i Jupe Brahimit u përgatitën që të hidheshin me vendosmëri kundër Luftës nacionalçlirimtare. Ata deshnin të vrisnin «fajtorët kryesorë, e në radhë të parë Memo Meton».

Kështu Memo Metua ishte vënë në shenjë dhe gjurmohej vazhdimisht nga tradhëtarët. Atë që armiku nuk e bëri dot në fushën e luftës kërkonte ta bënte nga pusitë e zëna prapa ferrave.

Komunistët e krahinës dhe të fshatit bënë një punë të madhe sqaruese me popullin për ta bërë të qartë tradhëtinë e spiunit. Dhe kjo u kuptua drejt nga shumica dërmuese e fshatarëve. Po armiku i kishte futur kthetrat e tij te disa pak tradhëtarë dhe nuk i lejonte që të ktheheshin nga rruga e krimit që kishin nisur...



## VI. KURVELESHI JA BËRI FORRA!

Memo Metua tregoi një aktivitet të gjithanshëm gjatë sulmit që u krye nga populli i Kuçit kundër administratës së komunës, forcave të karabinierisë dhe milicisë fashiste që ndodheshin në atë fshat.

Në Kuç, pas vrasjes së Spiunit Jupe Brahim i dhe pas aktiviteteve të tjera të organizatës së partisë, të këshillit nacionalçlirimtar dhe të njësiteve guerrile, autoritetet fashiste u hodhën në sulm. Ata, më 10 nëntor, arrestuan në mënyrë të befashme dy sho-kë dhe i futën në burgun e postkomandës.

Shokët e tjerë lajmëruan menjëherë të gjithë komunistët. Në këtë kohë ndodhej aty edhe sekretari i celulës e komisar i çetës së Kurveleshit Mustafa Matohiti.

Mustafai kërkoi të mblidhej celula. Në këtë mble-dhje u bënë diskutime të gjalla, ku çdo njeri dha mendimin e tij për situatën e krijuar. Në përfundim celula vendosi që goditjes fashiste t'i përgjigjeshin me një goditje më të fortë: të zhdukeshin adminis-trata e komunës, posta e karabinierisë dhe reparti i milicisë fashiste që qenë në fshat.

Ky vendim i celulës nuk që i rastit, apo i marrë me gjaknxehësi. Kishte ardhur koha t'i jepej një goditje e fortë armikut. Në atë etapë të luftës nuk

mund të ecej më përpara e të kryheshin aksione më të rëndësishme, duke pasur pas shpine karabinierët dhe milicët fashistë.

Prandaj, celula dha kushtrimin për mbledhjen e njësiteve guerrile të fshatit dhe të të gjithë simpatizantëve të luftës. Vendi i grumbullimit të forcave u caktua në Buronje. Binte një shi i hollë që të lagte deri në palcë. Fshatarët, me armë në dorë, me xhepat e mbushur me fishekë e bomba e me llabane në kokë, po grumbulloheshin në vendin e caktuar. Mustafa Matohiti e Memo Metua ishin ulur mbi disa gurë dhe nën dritën e një kandili me vajguri po përpiqonin planin e veprimeve. Ata të dy, të pajisur me njohuri ushtarake, përpiqeshin të përgatitnin një plan të saktë e të menduar, që do t'u siguronte suksesin.

Mustafai dhe shokët që kishte përreth tij analizuan faktorët që e ndihmonin aksionin dhe ata që e pengonin. Aty u arrit në përfundim që forcat e popullit qenë të mjaftueshme për ta kryer këtë goditje. Gjithashtu të gjithë qenë të një mendimi se qëndresën më të fortë do ta bënin karabinierët, të cilët ishin më të fortifikuar dhe më të përgatitur për luftë. Kjo gjë u muar parasysh gjatë ndarjes së forcave të sulmit.

Pas diskutimeve të shumta u vendos që goditja të ishte e shpejtë dhe e befasishme me qëllim që armiku të mos mundte të bënte një qëndresë të organizuar. Përveç kësaj u prenë gjithë linjat telefonike që lidhnin Kuçin me qendrat e tjera dhe u zunë prita në ato drejtime nga ku mund t'i vinin ndihma ushtarake garnizonit armik.

Forcat e mbledhura për kryerjen e aksionit u ndanë në katër grupe. Grupi i katërt, që e drejtonte



Memo Metua, u caktua të kryente veprime luftarake nga drejtimi i jugperëndimit.

Aksioni filloi në orën e caktuar. Luftimet qenë të ashpra. Armiku bëri një qëndresë këmbëngulëse. Në mënyrë të veçantë rezistuan forcat e karabinierisë, ashtu siç ishte parashikuar nga drejtuesit e aksionit. Por, përpara sulmit të vendosur të partizanëve e të popullit të Kuçit, forcat e karabinierisë e të milicisë fashiste u shpartalluan; në këtë mënyrë ju dhafund një herë e mirë pushtetit fashist në fshatin më të madh të Kurveleshit. Nga ana e armikut pati të vrarë e të plagosur, kurse shumica dërmuese e forcave të tij u dorëzuan. Në këtë luftim mbeti i vrarë fshatari trim Sulo Lala. Varrimi i këtij dëshmori u kthye në një miting të gjerë, ku muarën pjesë burra e gra, të mëdhenj e të vegjël. Ata me lot ndër sy dëgjuan fjalët e zjarrita e mallëngjyese të Memo Metos, që foli në emër të komunistëve të Kurveleshit.

Pas shpartallimit të armikut në Kuç dhe pas goditjeve të tjera që i jepeshin atij kudo, komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën vendosi të kalonte në aksione të një shkalle më të gjërë, për t'i dhënë armikut grushte më të rënda. Këtë radhë ai u dhafundëzime shokëve që drejtonin luftën në krahinën e Kurveleshit të merrnin masa për dëbimin e administratës dhe forcave ushtarake nga krahina, duke çliruar plotësisht Gusmarin, qendrën e nënprefekturës.

Një punë e madhe politike u bë nga komunistët dhe shokët e çetës për sqarimin e popullit dhe mobilizimin e tij. Aksioni u përgatit mirë dhe u zbatua po më zotësi. Pushteti i pushtuesit dhe forcat ushtarake fashiste u përzunë nga qendra e Kurveleshit më 28 nëntor 1942. Ky aksion bëri një jehonë të

madhe jo vetëm në qarkun e Gjirokastrës dhe të Vlorës, po edhe në gjithë Shqipërinë. Një vlerësim të madh i bëri kësaj lufte gazeta «Zëri i popullit» e asaj kohe në artikullin e saj me titull: «Kurveleshi ja bëri forra!»

Pas kësaj disfate të madhe për armikun prefekti i fashizmit Tahir Kolgjini ndërmori një operacion tjetër dhe u nis vetë për në Kurvelesh në krye të një force të madhe ushtarake. Kurveleshi u push-tua për pak ditë. Ai këtë radhë kishte me vete edhe një urdhër të posaçëm prej kryeministrit Mustafa Kruja, me anën e të cilit prefektit dhe komandantit të operacionit konsullit Korzano u jepeshin fuqi të plota për të pushkatuar dhe internuar kë të donin.

Memua u fut në gji të popullit; ai, me fjalët e tij të zjarrra, ngrinte lart moralin e popullit dhe demaskoi me forcë veprimtarinë tradhëtare të Tahir Kolgjinit.

Gjatë këtij operacioni ndodhi ajo bisedë e shkurtër, por e famshme, që ai pati nëpërmjet telefonit me prefektin Tahir Kolgjinin.

Ishin ditët e vështira të dhjetorit 1942. Prefekti ndodhej në Gusmar. Ai, i mërzhitur në kulm dhe i shtypur nga hija e atyre maleve të larta që rrethojnin Kurveleshin e Sipërm, ndjehej i shqetësuar dhe i alarmuar nga qëndresa e fortë e këtij populli të papërkulur. I dukej se ato male të rënda dhe të zbardhura nga dimri do të rrëzoheshin mbi të dhe do ta varrosnin mu aty ku ishte. Prefekti që në hall të madh. Ai kishte në dorë urdhërin e kryeministrit të shitur për ta shtruar me çdo kusht Kurveleshin dhe për të vendosur atje prapë administratën fashiste. Por qëllimit kryesor nuk ja arriti. Burrat, gratë, pleqtë dhe fëmijët e fshatrave të Kurveleshit



kishin marrë malet, jo të mundur në ndonjë luftim, po me qëllim që të hidheshin në sulm, i cili kushedi se ç'të papritura mund të sillte për prefektin...

Tahir Kolgjini u fut në njërën nga zyrat e ish-nënprefekturës. Aty, në mes të rrëmujës së plaçkave, tavolinave e karrigeve të kthyera përmbys, fotografive të grisura të Duçes e të mbretit, ndodhej edhe një aparat telefonik, të cilin forcat partizane e mbanin për të siguruar ndërlidhjen me fshatrat. Prefekti mori në dorë receptorin e bërë tërë pluhur dhe e afroi te veshi. Zhurma e erërave të dimrit, që transmetohej në aparat përmes telave, ngjante me uturimën e shtrëngatës, kur kalon përmes një gryke të madhe. Ai rrotulloi dorezën për t'i rënë ziles.

Pastaj prefekti bëri këtë bisedë e cila u bë shpejt e njohur në Kurvelesh:

— Kush je ti, more? — dëgjoi prefekti në mikrofon një zë të fortë që vinte nga larg.

Tahir Kolgjini heshti. Atij i dukej sikur aty në atë receptor, që mbante afër veshit, ishte futur ai labi që thirri dhe nga çasti në çast mund t'ja jepte plumbin mu në tamth.

— Kush je ti, more, pse s'flet, apo je shurdh? — u dëgjua prapë zëri i labit.

— Po ti kush je? — e pyeti prefekti.

— Unë jam një kuçiot. Po ti, byrazer, nga je?

— Memo Metua aty është? — e pyeti prefekti në vend të përgjegjes për pyetjen e partizanit.

— E, këtu është.

— Thuaji të dalë në telefon të bisedojë me mua.

— Është në konferencë, more shok, — ju përgjegj fshatari, i cili nuk qe partizan, po u ndodh rastësisht afër aparatit telefonik.

— Thirre kudo që të jetë.

— E ke punën me ngutje? Nuk pret?

— Jo, nuk pret.

Pas pak Memo Metua mori receptorin e telefonit dhe e vuri te veshi, u ul mbi një arkë fishekësh dhe malisherin e hodhi në sup.

— Kush më ka kërkuar në telefon? — pyeti ai.

— Alo, alo, kush je? — dëgjoi ai në vend të përgjegjes një zë të trashë e të çjerrë, si të atij njeriut që dikush e ka kapur për fyti e me zor merr frymë.

— Jam Memo Metua. Po ti kush je?

— A, je ti Memo tradhëtari.

Memua reagoi menjëherë. Ai e kuptoi me kë kishte të bënte dhe ja dha përgjegjen aty për aty.

— Unë jam Memo atdhetari. Tradhëtar dhe i shitur je ti, Tahir Kolgjini, që bashkëpunon me pushuesit fashist.

Pas fjalës së fundit Memua e mbylli telefonin. Prefektit, në anën tjetër të linjës, i mbetën në gojë fjalët që deshte të thoshte. Ditën tjetër prefekti bashkë me të gjitha forcat u tërhoq i turpëruar për në Gjirokastrë.

Pas çlirimit të qendrës së nënprefekturës, Memua kërkonte një rregull të fortë në administrimin e vendit. Veçanërisht ai i jepte rëndësi pastërtisë që duhet të karakterizonte anëtarët e këshillave, drejtësisë në vendimet e tyre. Kujdes i kushtonte ruajtjes së pasurisë së popullit, duke dënuar rëndë ata që shpërdoronin pasurinë që i zihej armikut dhe që bëhej pasuri e përbashkët.

Interesante në këtë drejtim janë raportet që ai i dërgonte Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën në atë kohë, veçanërisht ai i datës 12 dhjetor



1942. Në raport ai i bëri një analizë punës në përgjithësi dhe goditi me të madhe shkeljet sado të vogla që ishin vërtetuar gjatë marrjes në dorëzim të zyrave të nënprefekturës dhe të depove të ushtrisë e të karabinierisë. Ai kërkonte që populli i çliruar dhe veçanërisht partizanët të mbanin një qëndrim korrekt e shëmbëllor, me qëllim që t'i tregohej armikut se kush ishin partizanët dhe populli që i përkrahte ata.

Memua kërkonte me këmbëngulje që një fshatar, i cili kishte marrë pa leje një thes me lesh nga depot e ushtrisë, ta kthente patjetër e ngulte këmbë që një shok, i cili ishte zbatuar dhe kishte marrë një palë çizme në depo, t'i dorëzonte menjëherë dhe një partizan i vjetër që kishte ndërruar armën pa leje, të bënte autokritikë dhe armën ta sillte përsëri në bazë. «Hajdutët janë nga ana e armikut, — thoshte ai në bisedat e tij. — Kurse me ne janë patriotët e ndershëm. Dhe këtë ne duhet ta tregojmë kudo!»

Duke bërë fjalë për frymën revolucionare që mbretëronte kudo në fshatrat e Kurveleshit pas çlirimit të qendrës së nënprefekturës dhe operacionit të armikut Memua në raportin që u përmend më lart shkruante: «I gjithë populli u armatos dhe kërkoi me këmbëngulje front lufte me fashizmin. Burra, gra, pleq, plaka e kalamaj kërkonin të vdisnin para se sa fashizmi të shkelte vatrën e tyre...»<sup>1)</sup>

Duke bërë fjalë për gjendjen e fshatrave të Kurveleshit ai nxitohej që të demaskonte parullat e armikut, të cilat kishin për qëllim të helmonin popullin. Ai midis të tjerave shkruante: «Është e domosdosh-

---

1) Arkivi i Komitetit Qendror të PPSH. Fondi 17, dosja 11, fl. 4.

11.11.44  
S. ut Banorte

Jim' shenon ti...  
L. J. Janis I e" Bat. I...  
nga terosni' ker...  
ne Kamnacione...  
mbot's h' brend' dala... t' ue. v.

115  
210-  
9.11.44

Deleguesi P. Sh. i k'it d' Lins  
P. Kymntok. e Rayshid.

(M. Metos)

Letër e Memo Metos dërguar një partizani.



me një futje e shpejtë në të gjitha fshatrat, meqë Kurveleshi sot është një bombë pa siguresë dhe prandaj s'duhet lënë që të pëlcasë në duart tona, por të përfitojmë shpejt, pse të gjitha portat janë të hapura e në vend që të hyjmë ne, mos na hyjë armiku, sidomos mikrobet e lëna nga Kolgjini në Kurveleshin e Sipërm duhen dizinfektuar shpejt...»<sup>1)</sup>

Në ndonjë rast të veçantë Memua nuk i kuptoi si duhet veprimet e drejta të shokëve drejtues të partisë të krahinës, gjatë operacionit të trupave fashiste. Kjo ndodhi se ai më tepër prirej nga hapja, si të thuash, e një lufte frontale, ku përballë ushtrisë fashiste të mobilizohet dhe të vihet i gjithë populli i Kurveleshit, e jo nga përdorimi i taktikës së luftës partizane, që ndoqi komanda e çetës.

Këto mendime të Memos duket se nuk i quajti të drejta edhe Komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën, bile pati edhe kritikë për të. Këtë e shohim qartë në një letër që vetë Memua i drejtoi Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën më 7 shkurt 1943 nga Kuçi. Ai shkruante gjatë mbi marrëdhënjet e tij me shokët e celulës dhe sekretarin, «Gëzimin», si dhe mbi bisedat me një shok të qarkorit, i cili kishte shkuar në Kuç bashkë me dy shokë të Komitetit Qendror. Pas këtyre komiteti qarkor mendoi që Memo Metua të kalonte me punë në një zonë tjetër. Ja se ç'shkruan Memua: «Nga dialogu që pata me shokun «Gëzim» (përgjegjës i celulës), si mua edhe shokëve të tjerë na u dha të kuptojmë se unë nuk bëja pjesë në atë organizatë... Me këtë rast shoku «Gëzim» më komunikoi që unë duhej të merresha

---

1) Arkivi i Komitetit Qendror të PPSH. Fondi 17, dosja 11, fl. 4.

me punë organizative në rajonin e Delvinës dhe të Sarandës...»<sup>1)</sup>

Por përsëri Memua nuk u shkëput fare nga puna e partisë në Kurvelesh. Në muajin shkurt 1943 ai raporton për punën e tij: «...Kam formuar këtu dy grupe edukative, njëri me elementë më të zgjedhur të luftëtarëve... Në fshatin Fterë janë dy elementë që mund të hyjnë drejtpërdrejt në celulën e këtushme...»

Menjëherë pas çlirimit të qendrës së krahinës u bë riorganizimi i forcave partizane në Kurvelesh. Në bazë të gjendjes së re u krijuan dy çeta: «Avni Rustemi» dhe «Hajredin Tremishti». Krijimi i dy çetave kërkonte edhe daljen e partizanëve të tjerë. Këtë kërkesë së kohës Memua e shprehu jo vetëm nëpërmjet punës agjitative dhe propagandistike, po edhe me vjersha. Kështu ai në dhjetor shkruan këtë vjershë të bukur, e cila shpejt u bë e njohur në popull dhe veçanërisht në të rinjtë.

*Po gjëmon Shuri përperjetë,  
Dëgjohet një çap i lehtë,  
Shkon partizani në çetë,  
Dalë vullnetar vetë...  
Ngrehu Kurvelesh i shkretë,  
Dhe mbroje veten vetë,  
Se ty s'të lënë të çetë,  
Me milicë e me prefekt.*

Problemi i shtimit të radhëve partizane që detyrë kryesore për organizatën e partisë së Kurveleshit. Memua bënte mbledhje me popullin, me të rinjtë, u fliste atyre, tregonte episode nga lufta partizane,

---

1) AKQ PPSH, F. 17. Dosja 12.



akte heroike, u ndizte zemrat atyre që e dëgjonin dhe bënte që shumë nga ata të ngjeshnin gjerdanin, të merrnin pushkën në dorë dhe të bashkoheshin me shokët në çeta.

Duke e çmuar drejt rëndësinë e shtimit të radhëve partizane, ai shkroi edhe vjershën me titull: «Grupi i çetës partizane», ku midis të tjerave thuhet:

*Nëpër kodra, fusha e male  
trumbetohet,  
Zëri i fortë, o shokë, i çetës  
po dëgjohet.  
Anëmbanë po bashkohen  
djalëria,  
Që të gjithë grumbullohen  
nga partia.  
Djem e vajza, gjithë ajkë  
e Shqipërisë,  
Venë e marrin udhëzime  
prej partisë...*

Pak më vonë dhe pikërisht në mars të vitit 1943 shkruan vjershën «Vjen pranvera», e cila fillon me këto vargje:

*Behari që vjen sivjet,  
Të shohim ç'do të na sjellë,  
Të shohim ç'lule na qet,  
Ç'farë lulësh do na bjerë.  
Sivjet shpejt na vjen pranvera,  
Kemi lule të vërteta,  
Do dalin lule të tjera,  
Do mbushet mali me çeta...*

*Nën hijen e mërzimit,  
Do rrijë çeta në vapë,  
Afër ujit të burimit,  
Do shkojë e do kthehet prapë...*

Lufta kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve të vendit që e ashpër e me sakrifica të mëdha. Herë pas here bijtë dhe bijat e popullit, që i kishin kthyer pushkën armikut, po binin në fushën e luftës.

Memo Metua gjithmonë ruajti respekt të madh për luftëtarët dhe luftëtarët e lirisë, të cilët dhanë edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën, për çlirimin e popullit dhe të atdheut.

Më 7 nëntor 1942 në një aksion që kishte kryer një njësit i çetës partizane të Kurveleshit, në fshatin Nivicë që vranë Dalip Seferi, i cili njihej në popull me pseudonimin «Tigri». Ai që një nga partizanët më të vjetër të krahinës së Kurveleshit dhe të qarkut të Gjirokastrës. Dalipi, duke zbatuar detyrat që i ngarkonte partia, i kishte nxjerrë shumë tela-she armikut, prandaj autoritetet fashiste e kishin dënuar me vdekje në mungesë. Ata i ngrinin kurthe për ta kapur ose vranë, vunë një çmim të madh për kokën e tij, i internuan gjithë familjen dhe më në fund e vranë.

Në muajin mars të vitit 1943, në Nivicë, u nxuar trupi i Dalipit dhe u varros në një vend më të përshtatshëm. Këtë e bënë rinia dhe aktivistët e Luftës nacionalçlirimtare të fshatit. Me këtë rast që mbledhur i gjithë populli. Aty, si i deleguar i partisë, për të nderuar luftëtarin e njohur, kishte vajtur Memo Metua.

Memua e donte shumë Dalip Seferin; ata kishin qenë shokë të ngushtë për një kohë të gjatë. Për he-



rë të parë qenë njohur kur Dalipi punonte si punëtor në Kuçovë, kurse Memua ishte në Berat e Perondi. Shoqërinë e tyre ata e ruajtën dhe e forcuan më tepër gjatë Luftës nacionalçlirimtare, kur që të dy nga të parët dualën ilegalë në malet e Kurveleshit.

Tani, ai kishte para tij trupin e pashpirt të shokut. Burra dhe gra, të rinj e të reja kujtonin Dalipin, i cili u kishte shkuar nëpër shtëpi apo haure dhe u kishte folur për luftën kundër fashizmit, atë Dalip të gjallë, të qeshur, shakaxhi dhe të ashpër me armikun.

Qanin gratë labe me ligje sipas zakonisht mbi varrin e partizanit. Memua, duke dëgjuar fjalët prekëse të grave, e kishte ngritur kokën lart drejt majave të maleve. Ai kishte kapur për krahu mëmën e dëshmorit, Gjylson, dhe, duke e mbajtur, po e ngushëllonte:

— Mbahu, nënë Gjylso, durim! — i tha ai.

— Po mbahem, o Memo djali! — ju përgjegj nënë Gjylsua dhe me duart e mbështjella para zemrës, dhe me ballin e rudhur po shikonte të birin që po e ulnin në varr.

Memua dëgjoi edhe ligjet e Gjylsos që tha atë ditë mbi varrin e të birit:

*Dalip leshëra gabuli,  
Pse s'zure një rrzë guri,  
Të vrasje sa të zij plumbi...*

Mbasi u vendosën kurora të bukura me lule të freskëta mali mbi varrin e Dalipit, e mori fjalën Memo Metua. Aty, ai me fjalë të thjeshta e të përzemërta, që i dilnin nga thellësia e zemrës, i bëri të gjithë ata që qenë të përloren e të mbushen me urrej-

tje kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve, të cilët kishin vrarë Dalipin dhe kishin ndjellë kudo prishje e shkatërrime. Fjalët e Memos atë ditë qenë aq të zjarrrta, aq prekëse saqë edhe sot mbahen mend mirë nga niviciotët. Pas këtij akti solemn, Memua shkroi edhe një vjershë të frymëzuar për Dalip Seferin, e cila u përhap shpejt, po për fat të keq nuk ruhet e plotë.

Aty nga fillimi i vitit 1943 çeta partizane «Hajredin Tremishti» bëri një aksion të rëndësishëm kundër një poste armike në fshatin Borsh, ku nga ana e forcave partizane ra dëshmor Fuat Mati nga Fterra. Memua u ndodh atje, dhe e pa me sytë e tij trupin e dëshmorit. Në bazë të zakoneve të vendit në fshat u hap mandata. Luftëtarit të lirisë ju bënë të gjitha nderimet, ashtu si i takonin. Aty Memua pa qëndrimin e fortë, të papërkulur nga helmi, të mëmës së Fuatit. Kjo mëmë labe e frymëzoi atë të shkruante një vjershë tjetër me titull: «U hap lajmi ulurima», në të cilën për herë të parë ai ngrë lart figurën e nënës së partizanit që e kupton drejt detyrën e djemve të Shqipërisë dhe detyrën e saj si mëmë.

*Në Izvuar u hap lufta  
atë natë,  
Dhe në Fterrë ulurima  
një mandatë.  
Plot me vaj e ulurima  
gjithë fshati,  
Sillej trupi i luftëtarit  
Fuat Mati...*

Pasi tregon për mënyrën krenare, me të cilën u ngrit e foli para popullit nëna e dëshmorit, poeti vazhdon:



U flet shokëve dhe shoqeve,  
krenare,  
Siç e kanë zakon mëmat  
shqiptare.  
Dhe u thotë: — Për Fuatin  
mos vajtoni,  
Dhe për ngushëllim te unë  
mos nxitoni,  
Se si djalin tim Fuatin  
këtë herë,  
Qentë e Romës do na vrasin  
dhe të tjerë.  
S'është koha që të qajmë  
djemtë sot,  
S'merret haka, nëna motra  
moj me lot...  
S'vjen liria nga e ulëra,  
të qarët,  
Po me plumba mbi fashistët  
tradhëtarët.

## VII. AKTIVITETI I TIJ JASHTË KRAHINËS SË KURVELESHIT

Memo Metua kalitej çdo ditë e më shumë në zjarrin e luftës kundër armikut dhe bëhej gjithnjë më i dashur në popull. Kjo dashuri dhe interesi për fjalimet e tij shpjegohet nga fakti se Memua i njihte mirë hallet e popullit dhe, kur fliste, u jepte shembulla, me të cilat u prekte zemrat thellë dëgjuesve. Ai, si njeri masovik, kishte aftësinë që të bisedonte me gjuhën e përshtatshme për çdo kategori njerëzish. Kështu, ndryshe bisedonte me të moshuarit, ndryshe me të rinjtë e të rejtat dhe ndryshe me fëmijët. Kur fliste para popullit, Memua i argumentonte mirë ato që thoshte, i zbukuronte mendimet e tij me fjalë të urta, anekdota, shakara, episode të njohura e të tjera. Ai, kur zhvillonte konferenca, në të cilat merrnin pjesë edhe kundërshtarë, parullat e «Ballit Kombëtar» i zbërthente me durim e zgjuarësi dhe arrinte më në fund që njerëzit e Ballit të bëheshin qesharakë e të demaskoheshin para popullit.

Të qeshurit, shakatë, anekdotat, kritikrat, Memua gjithmonë i përdorte për të bërë propagandë në interes të Luftës nacionalçlirimtare. Shpeshherë, gjatë



duelve me kundërshtarët, ai u përgjigjej atyre me vargje satirike, të cilat bënin që populli të qeshte me të madhe, kurse kundërshtarët mbeteshin në pozitë të vështirë.

Memo Metua aktivitetin e tij nuk e kreu vetëm në krahinë e Kurveleshit. Ai, me urdhër të komitetit qarkor të partisë, kalonte nga njëra krahinë në tjetrën, atje ku duhej mendja dhe goja e tij. Kështu, në mars të vitit 1943, Memua, me porosinë e komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën, shkoi për të punuar me popullin e Çamërisë.

Në atë kohë ishte mësuar se krerët e reaksionit të Çamërisë, me në krye feudalit dhe fashistit e njohur Nuri Dinon, po organizonin një mbledhje, e cila kishte për qëllim që ta mbante popullin çam larg luftës kundër fashizmit.

Memua arriti në vendin e mbledhjes në kohën e duhur. Paria ishte mbledhur në një anë, me qëllim që të merrnin vendime dhe pastaj t'ja komunikonin popullit, i cili priste në një vend më tutje. Memua, pa u vënë re dhe pa u njohur nga të gjithë, zuri vend midis njerëzve të parisë. Nuri Dinua, i cili drejtonte mbledhjen, foli gjatë. Gjithë fjala e tij vërtitej rreth asaj që populli çam nuk duhej të hidhej në Luftën nacionalçlirimtare. Pas tij folën edhe të tjerë, të cilët, sigurisht, përkrahën Nuriun.

Më në fund kërkoi fjalën Memua. Ai në dorën e djathtë mbante maliherin, kurse në të majtën një blok të zi, të vogël, ku kishte shënuar ato që i duheshin për të mbrojtur vijën e partisë dhe për të demaskuar fjalët e Nuri Dinos me shokë.

Memua u tha haptazi pjesëmarrësve se ai përfaqësonte Frontin Nacionalçlirimtar. Ata që qenë mbledhur aty u habitën dhe u hutuan kur panë se mi-

dis tyre paskej qenë edhe një komunist, i cili u kishte dëgjuar të gjitha të palarat.

Memua foli gjatë dhe tregoi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së popullit në luftën kundër fashizmit dhe tradhëtarëve. Ai, duke analizuar fjalimin e Nuri Dinos, u provoi të tjerëve se ajo qe propaganda e fashizmit, e cila përhapej nëpërmjet kryefashistit që drejtonte mbledhjen.

Nuri Dinua, njeri i njohur, çifligar i madh dhe nëpunës i lartë fashist, kurrë në të kaluarën nuk e kishte ndjerë veten aq ngushtë sa e ndjeu në atë çast kur u ndodh para komunistit Memo Meto.

Pas fjalës së Memos pozitat e armikut u lëkundën. Paria u hutua, mendimet e saj u ndanë. Me propozimin e Memos u vendos që, ashtu si ishin të gjithë, të dilnin para popullit dhe atje t'i thoshin mendimet e tyre; dhe ashtu u bë.

Para popullit i pari foli prapë Nuri Dinua. Ai, si njeri i stërvitur në demagogji, përsëriti edhe një herë se armiku kryesor për ta nuk qe fashizmi italian, por shovinistët grekë. Ndaj i nxiti dëgjuesit që të mos hidheshin në anën e Luftës nacionalçlirimtare kundër fashizmit, por të ndiqnin rrugën që u tregonte ai. Për disa minuta u duk sikur ai e zotëroi situatën. Nuriu, i kënaqur, po shikonte me bishtin e syrit dhe me një farë përçmimi këtë partizanin e pafutur, i cili u kishte mbirë pa pritur nga dheu.

Në këtë çast kritik e mori fjalën Memo Metua. Ai e filloi shtruar, duke i bërë një përshekrim situatës së luftës si jashtë ashtu edhe brenda vendit. Pastaj kaloi në detyrat e popullit në situatën e krijuar. Duke analizuar një për një ato që tha Nuri Dinua para popullit, ai edhe aty i cilësoi si parulla fashiste që thuheshin nga një fashist i regjur.



— Mos mendon fashisti Nuri Dino, — ju drejtua Memua popullit nga fundi i fjalimit të tij, — se ne, Fronti Nacionalçlirimtar, i themi atij të vijë me popullin për të luftuar fashizmin? Jo, ne atë nuk e themi dhe as që e duam atë. Nuri Dinua do të bëjë mirë të vazhdojë të hajë në çanakun e fashizmit edhe këtë kohë të shkurtër që ka mbetur, sepse së shpejti fashizmi mbaron dhe bashkë me të edhe Nuri Dinua...

Në përfundim të kësaj mbledhjeje të rëndësishme, organizatorët e saj dështuan. Nuri Dinua me një grusht tradhëtarësh të tjerë u larguan të turpëruar, kurse populli u lidh më tepër dhe u hodh më gjallërisht në Luftën nacionalçlirimtare. Kjo fitore e Memo Metos, në mbrojtje të vijës së partisë, në duelin me Nuri Dinon, i gëzoi pa masë shokët e tij. Shoku Qazim Kondi, duke folur për këtë mbledhje, thotë: «Nuri Dinua ishte feudal i madh i Çamërisë e në të njëjtën kohë një intelektual e demagog i regjur në politikë. Ç'ishte Memo Metua para tij? Vetëm drejtësia e vijës së partisë e shprehur nëpërmjet talentit dhe zgjuarësisë së Memos bëri që ky feudal i Çamërisë të ikte me bisht në shalë nga ajo mbledhje, e cila bëhej, si të thuash, në shtëpinë e tij...»

Memo Metua bashkë me shokë të tjerë të partisë një punë të madhe bëri gjatë muajve mars e prill të vitit 1943 në Vurgun e Delvinës. Në atë kohë në këtë krahinë, si rezultat i veprimtarisë tradhëtare të Haki Rushitit, kishin lindur vështirësi në punën propagandistike dhe organizative të partisë. Gjatë kohës që qëndroi atje, Memua punoi me komunistët, me këshillat nacionalçlirimtare atje ku kishte, kurse atje ku nuk qenë formuar ende, punoi

për t'i formuar, bëri biseda e konferenca me partizanët e me popullin.

Të njëjtën gjë bëri ai edhe në fshatrat e Rrëzomës. Aty, ai ndeshi në një propagandë të fortë të reaksionit, e në radhë të parë të klerit musliman.

Në një letër që i dërgonte «Voglit»<sup>1)</sup> më datën 16 prill 1943 nga Vergoi, Memua midis të tjerave shkruante: «Lajmi i luftës së Kurveleshit më gjeti në Kopaçezë... Fshatrat Palavli, Kopaçezë dhe Vergo... kanë deklaruar se teqeja u ka dhënë urdhër që të mos e luftojnë armikun po ta presim me të mirë...»

Në këtë kohë armiku, që e kishte vënë me kohë në shenjë Memo Meton, filloi të vepronte. Një bandë mercenarësh, e armatosur mirë dhe e maskuar, kishte mundur t'i fshihej syrit të popullit dhe të jetonte nëpër shpella e pyje duke pritur rastin për të vrarë Memo Meton, duke e ndjekur luftëtarin e lirisë si hije prapa.

Memua e kishte vështirë të ruhej nga pritat. Ai si punëtor partie në terren duhej të kalonte vazhdimisht nga njëri fshat në tjetrin e nga njëra krahinë në tjetrën. Nga ana tjetër lëvizjet e tij i merrnin vesh si të mirët ashtu edhe të ligjtë, sepse ai bënte konferenca me popullin dhe populli duhej të lajmërohej për mbledhje.

Në prill të vitit 1943, Memua me një shok tjetër ishte duke shkuar në një nga bazat kryesore të partisë në Kuç. Në vendin e quajtur Plihër, në afërsi të bazës, dy tradhëtarë kishin zënë pritë. Vendi që shumë i përshtatshëm për një atentat të tillë.

Memua ecte para, maliherin e kishte hedhur në sup dhe shikonte me kujdes vendin e pyllëzuar.

---

1) Pseudonimi i shokut Haki Toska.



Shoku i tij ishte disa metra prapa. Kur Memua doli në një qafë dhe bëri të vazhdonte tutje, në një shesh të vogël, përmes të cilit kalonte rruga, u dëgjuan bataretë e pushkëve.

Të dy shokët, duke ruajtur gjakftohtësinë, zunë vend me shpejtësi pas disa trungjeve dhe drurëve të prerë dhe u kthyen pushkën armiqve. Zjarri i Memos dhe i shokut të tij bëri që tradhëtarët të largohen të mundur pa ja mbërritur qëllimit kriminal.

Në qershor të vitit 1943 Komiteti qarkor për Gjirokastrën, duke marrë parasysh zgjerimin e Luftës nacionalçlirimtare dhe nevojën për një udhëheqje më efektive të krahinave, vendosi krijimin e komitetit të partisë së rajonit, në të cilin përfshiheshin Kurveleshi, Tepelena, Rrëzoma, Kardhiqi dhe Bregdeti i Sipërm. Në këtë komitet Memo Metua u caktua sekretar organizativ.

Tani, ai kishte detyra më të shumta dhe më me përgjegjësi. Duke bërë përpjekje që t'i plotësonte sa më mirë këto detyra, kalonte nga njëra krahinë në tjetrën, bisedonte me popullin, udhëzonte komunistët si të punonin, bënte mbledhje me grupet edukative dhe me simpatizantët e lëvizjes nacionalçlirimtare.

Nga mesi i verës së vitit 1943 Memua, në krye të disa forcave partizane, ndodhej në Qafën e Kreshës në Kurvelesh. Aty mori një letër nga Komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën, me anën e të cilës ngarkohej nga partia me detyrë të shkonte në një mbledhje të rëndësishme, që po organizonte reaksioni në Rrëzomë të Delvinës dhe atje të përfaqësonte Frontin Nacionalçlirimtar.

Mbledhja që caktuar që të bëhej të nesërmen në vendin e quajtur Vau i Dafinës midis Rrëzomës dhe

Bregdetit të Sipërm. Qenë ftuar që të merrnin pjesë njerëz të ndryshëm nga fshatrat e Rrëzomës dhe të Bregut. Këtë mbledhje e kishin organizuar krerët e «Ballit Kombëtar» Koço Muka, Hasan Pilafi, Ismail Haki Tatzati, Avdulla Rama e Hasim Kalasa, që kishin për qëllim ta largonin popullin e këtyre dy krahinave nga Lufta nacionalçlirimtare e ta hidhnin në krahun e reaksionit.

Memos i mbetej pak kohë deri në fillimin e mbledhjes, prandaj mori me vete çetën e Bregut dhe u nis, duke ecur me shpejtësi. Udhëtimi bëhej natën. Memua shkante në krye. Ai, me maliherin në sup, po çante malet dhe grykat, duke kaluar andej nga binte rruga më e shkurtër. Vendi i mbledhjes qe larg, orët mbeteshin të numëruara. Po duhej të mbërrinte patjetër në mbledhje. Atje duhej të dëgjohej zëri i partisë e jo i tradhëtarëve. Shokët partizanë që e ndiqnin pas habiteshin me të. Të gjithë e kuptonin se do të kishte ndonjë punë shumë të rëndësishme.

Kaluan Nivicën, Rexhinën, Gusmarin, bënë disa orë rrugë, mbërritën në malin e Golemit. Djersa u kullonte që të gjithëve.

— Të pushojmë pak, — thirri dikush nga mesi i kolonës.

— Përpara! Pushojmë nesër, — u përgjegj Memua.

Ai herë pas here nxirrte orën dhe e shikonte. I dukej sikur këmbët s'leviznin hiç, kurse agrepat në fushën e bardhë vraponin.

— Më shpejt, shokë! — u foli edhe një herë Memua partizanëve, duke çarë përpara.

Mbërritën në Golem, kaluan Kaparjelin. Aty ku



qenë disa burime, partizanët, në errësirën e natës, dëgjuan zërin e fortë të Memos:

— Mos pini ujë! Vazhdoni përpara!

Nata e gushtit qe e qetë, vetëm yjet, si prush i shpërndarë, kishin stolisur kupën e qiellit. Aty nga mëngjezi partizanët kaluan Zhulatin, Fushë-Bardhën dhe mbërritën në Qafën e Skërficës. Vetëm aty Memua, pranë një burimi me ujë të ftohtë, u dha leje partizanëve që të çlodheshin pesë minuta.

Kur mbërritën te Vau i Dafinës, mbedhja e organizuar nga krerët e reaksionit sapo kishte filluar. Memua, në krye të partizanëve, përshëndeti i pari:

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — ju përgjegjën shumë veta nga populli.

— A pranoni luftëtarë të lirisë në këtë mbledhje? — ju drejtua ai me një buzëqeshje ironike organizatorëve të mbledhjes.

— Nga vjen ti? — e pyeti një nga ata.

— Nga malet, — ju përgjigj Memua.

Ardhjen e Memo Metos në atë mbledhje krerët e «Ballit» nuk e pritën mirë. Ata e dinin që ai s'vinte kurrë për të mirën e tyre, po tani s'kishin ç'të bënin.

Partizanët që qenë me të, sipas urdhërit të tij, zunë vende të përshtatshme për të qenë gati për çdo të papritur e për të mos rënë në ndonjë grackë të reaksionit.

Memua u ul këmbëkryq midis popullit, vuri ma-liherin para gjunjëve, nxori blokun e tij të vogël dhe, pasi e mbështeti mbi kondakun e pushkës, filloi të mbante shënim ato që thoshin krerët e reaksionit që flisnin njëri pas tjetrit.



Memo Meto partizan.



Një nga ata, Hasan Pilafi, e vuri re që mbante shënime. Ai kishte dëgjuar për Memo Meton, po personalisht nuk e kishte parë ndonjëherë.

— E, ti atje, — ju drejtua ai Memos, — pse i mban shënime ato që themi ne?

Memua u çua shpejt, që ta shihnin të gjithë, dhe ju përgjegj.

— Koka jote, zotëri, është e madhe kaq, — ai zgjati para duart dhe i bashkoi në formë rrethi, — prandaj s'ka nevojë për shënime, kurse koka ime është kaq, — dhe preku me gisht kokën e tij.

Të gjithë qeshën me të madhe. Hasani mbeti i fyer.

Memua u ul prapë dhe vazhdoi të dëgjonte e të mbante shënime ato që i interesonin. Krerët e «Ballit Kombëtar» i thanë të gjitha ç'kishin për të thënë. Të gjithë i ranë avazit: «Është ende shpejt të ngrihemi në luftë. Italia dhe Gjermania janë të forta, ne nuk hahemi dot me to. Po të ngrihemi në luftë, si thonë komunistët, do të vritemi e do të digjemi. Prandaj, ne duhet të presim derisa ato t'i mundin fuqitë e mëdha. Populli i Rrëzomës dhe i Bregut duhet të japë fjalën se do të lidhet me organizatën e «Ballit Kombëtar».

Në fund e mori fjalën Memo Metua. Fjalimi i tij prej rreth tri orësh në atë mbledhje është një shembull i shkëlqyer i oratorisë së tij të rrallë. Populli e dëgjonte me vëmendje. Çdo minutë që kalonte dhe pas çdo fjale të tij qendra e gravitetit të mbledhjes zhvendosej majtas, nga pikëpamjet dhe idetë e partisë që parashtronte Memua. Demaskimi që u bëri ai krerëve të Ballit që i ashpër, i hapët dhe i argumentuar më së miri.

— Ja, — tha Memua, — le të marrim zotim

Koço Muka. A mund të luftojë ai kundër fashizmit, kur ai është vetë fashist dhe kuestor i prefekturës së Gjirokastrës?

Koço Muka s'kishte si të mbrohej. Ai edhe në atë mbledhje kishte vajtur me detyrën e kuestorit fashist. Memua thoshte të vërtetën.

Pasi mbaroi së demaskuari parullat e «Ballit Kombëtar» dhe i quajti ballistët si njerëz në shërbim të pushtuesit fashist, të cilët edhe në atë mbledhje kishin vajtur me porosi të tij, Memua ju drejtua popullit.

— Ku jetojnë këta «patriotë», të cilët munden t'jua mbushin mendjen juve nëse duhet të bashkoheni me Frontin Nacionalçlirimtar apo jo? Krerët e tyre i kanë në Tiranë bashkë me pushtuesin. Po edhe këta zotërinj që kini përpara, me të mbaruar mbledhja, do të nisen e do të venë në Delvinë e Gjirokastrë, ku janë pushtuesit. E shikoni kush janë këta?

Populli u entuziazhua prej fjalëve të Memos. Dikush nga ata që kryesonin mbledhjen i kundërshtoi akuzat e Memos. Memua, me tërë zotësinë e tij, e vuri atë në shenjë.

— A jeni ju ballistët për luftë? — e pyeti atë Memua.

— Po, domosdo që jemi.

— Bukur fort! Atëhere, që sonte, të gjithë siç jemi këtu hajdeni të nisemi e të sulmojmë Delvinën që kemi më afër. Si thotë populli, dakord jeni ju ta sulmojmë Delvinën?

— Shumë mirë! — thirrën nga turma.

— S'ka ardhur koha, — ndërhyri prapë ballisti, që kishte filluar polemikën me Memon.



Qeshje të përgjithshme nga ana e popullit në shenjë talljeje për fjalët e ballistit.

— E shikoni, ju popull, kush janë këta? — go-diti në shenjë Memua.

Populli që merrte pjesë në atë mbledhje mori anën e Memos. Në këtë mënyrë qëllimi i krerëve të Ballit nuk u arrit. Jo vetëm kaq, por ata u demaskuan para popullit si njerëz në shërbim të pushtuesit fashist.

Në atë mbledhje ndodhi edhe diçka e papritur. Aty gjendej edhe një repart xhandarësh, të cilët kishin vajtur për sigurimin e organizatorëve të mbledhjes. Pas fjalimit të Memos dhe kur ai tha: «E shikoni? Këta luftëtarë ballistë kanë ardhur këtu të shoqëruar edhe me xhandarë», ata i hapën sytë dhe filluan të kuptonin se qenë vegla të pushtuesit. Komandanti i tyre, një burrë patriot, u revoltua nga qëndrimi i ballistëve. Ai më në fund u çua dhe, për habinë e të gjithëve, ju drejtua krerëve të Ballit me këto fjalë:

— Unë tani po e shoh që ju ballistët po e gënjëni popullin, e bashkë me të edhe ne. Për luftë jeni ju, apo për të ngrënë pula? Unë që sot e tutje jam kundër jush dhe po hidhem në rreshtat partizane, sepse partizanët janë ata që me të vërtetë po luftojnë për liri. Nga shokët e mi, — ju drejtua ai xhandarëve të tjerë, — kush të dojë le të vijë me mua e kush të dojë le të vejë me tradhëtarët.

Që atë ditë ai, bashkë me shokët e tij, kaloi në anën e partizanëve dhe më pas u dallua si kuadër besnik i Luftës nacionalçlirimtare.

Krerët e Ballit nisën të largoheshin nga mbledhja të hutuar e të turpëruar. Për të ulur efektin e fjalimit të Memo Metos në popull, Abdulla Rama,

jurist dhe një nga krerët e organizatës së Ballit në atë krahinë, para se të ikte, shkoi te Memua dhe në sy të të gjithëve i tha me ton solemn prej avokati:

— Ju uroj, zoti Memo, për mbrojtjen që i bëtë tezës tuaj!

Memua ju përgjigj menjëherë avokatit me ato fjalë që i dëgjuan të gjithë dhe shpejt u bënë të njohura:

— Nuk jam unë i zoti që mbroj një tezë të gabuar, po është teza e drejtë që mbroj unë!

Kështu mbaroi edhe një mbledhje ku Memo Metua përfaqësoi me dinjitet Frontin Nacionalçlirimtar, përfaqësoi më së miri Partinë.



## VIII. ÇDO GJË PËR LUFTËN, ÇDO GJË PËR PARTINË E PËR POPULLIN

«Ne që kemi pasur rastin ta njohim Memon, — shkruajnë kuçiotë në historikun e tyre, — çuditemi me origjinalitetin, bukurinë, rrjedhshmërinë e mendimeve, pasurinë e formave me të cilat ai bënte bisedën, në të njëjtën kohë me forcën bindëse, aq të madhe të fjalës së tij që e çonte peshë popullin...»

Kështu shpjegohen sukseset që arrinte ai mbi kundërshtarët e luftës dhe të interesave të popullit. Memua kishte cilësinë që t'i çmonte e t'i përcaktonte njerëzit me t'i parë e me t'i dëgjuar fjalët e para të tyre. Orientohej shpejt edhe në situatat më të vështira dhe gjente mënyrat dhe metodat më të drejta të veprimit për t'ju vënë kundërshtarit ballë për ballë dhe për ta mposhtur atë politikisht dhe ideologjikisht. Memua që nga ata punëtorë të partisë, të cilët dinë të sulmojnë sipas gjendjes ushtarake të kundërshtarit, herë drejt në front duke u hedhur në zjarr mbi llogoret e armikut, herë duke i marrë krahet.

Gjatë luftës me armikun Memua bënte një punë të diferencuar. Me armiqtë e popullit ai ndizte ba-

rutin dhe hapte luftën pa as një kompromis, kurse me fshatarët e gënjyer punonte me durim.

Duke qenë gjithmonë në kontakt me njerëzit e çdo shtrese e të çdo karakteri, ai u tregua një psikolog i zoti dhe kjo u pa në metodat e punës së tij me njerëz të ndryshëm.

Memua, gjatë mbledhjeve që zhvillonte me popullin e një fshati, arrinte të përcaktonte se ç'bluanin në kokë ata që qenë para tij. Pasi e bënte këtë, ai pa i prekur direkt në sedër njerëzit e lëkundur, vazhdonte të punonte me ta. Për të demaskuar parullat e «Ballit Kombëtar» e të fashizmit, u drejtohej papritur atyre që kishin pikëpamje të paqarta me një pyetje të prerë: «Si thua ti, shoku Kanan, drejt e kanë ata, që nuk duan të luftojnë okupatorin, apo ne që po e luftojmë?»

Shokët habiteshin se si arrinte ai të qëllonte aq mirë në shenjë, duke e njohur menjëherë fshatarin që qe turbulluar nga propaganda e fashizmit, prandaj edhe e pyesnin.

— Nuk është dhe shumë e vështirë, — u përgjigjej Memua. — Gjatë bisedës me popullin shikojini njerëzit në sy dhe do të vini re se, ndërsa të tjerët të shikojnë po ashtu si i shikon ti, drejt, ndonjëri i shmanget shikimit tënd, i hedh sytë në tokë, bën lëvizje nervoze e rudh ballin. Ai njeri që bën këto, diçka ka, me siguri diçka e mundon ndërgjegjen e tij. Dhe në këto kohëra, përveç helmimit nga ana e propagandës së armikut s'mund të ketë gjë tjetër, sepse hallet familjare dhe dëmet nga ana e armikut janë njëlloj për të gjithë popullin e jo për një e për dy veta.

Metodat e punës së Memos me njerëzit qenë nga më origjinalet. Ai, kur informohej se ndonjë nga



fshatarët nuk qe më ai i pari, por lëkundej nga propaganda e armikut dhe po të mos ndihmohej mund të hidhej në humnerën e tradhëtisë, ndërhynte ashtu si ndërhyu doktori i mirë te i sëmuri që ka nevojë për mjekim. Njerëzit e kësaj kategorie Memua nuk i sulmonte hapët. Ai ndiqte një taktikë tjetër: krijonte shkak për t'u takuar me ta dhe me t'i parë që larg u thërriste atyre me buzë në gaz e dashamirësi. Pastaj ju afrohej i qeshur, u hidhte dorën në sup dhe i tërhiqte mënjanë nga të tjerët, për t'u treguar kështu se kishte diçka për t'u thënë, që të tjerët s'duhet ta dinin. Me këtë rast ai u ngarkonte atyre detyra, si për shembull, për të bërë agjitacion me ndonjë fshatar a për të folur me ndonjë grup njerëzish.

Me këto metoda pune Memua bënte që pa i prekur në sedër fshatarët, të qëndronin të fortë në luftën kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve dhe t'u shpëtonin kthetrave që u kishte zgjatur armiku.

Memua kishte aftësinë e rrallë të depërtonte në zemrat e njerëzve. Ai agjitacionin dhe propagandën e partisë e bënte me të gjithë, si me të rriturit edhe me të vegjëlit.

Të rinjtë dhe veçanërisht të vegjëlit e donin shumë Memon. Ai punonte me ta, mbante lidhje të rregullta, u vinte detyra, u kërkonte llogari për kryerjen e tyre. Njihej nga të gjithë fëmijët e fshatrave të Kurveleshit. Kur hynte në ndonjë fshat ata, me ta parë, i afroreshin të kënaqur dhe bënin aq zhurmë saqë mund të merrej vesh deri larg.

Njëherë, gjatë pranverës së vitit 1943, Memua bashkë me një shok tjetër shkoi në fshatin Nivicë për punë partie. Koha ishte e ftohtë dhe me shi. Gjendja ishte e rëndë. Ushtritë fashiste që sapo

ishin larguar nga krahina e Kurveleshit kishin dje-  
gur disa shtëpi, kishin vrarë njerëz, kurse babanë e  
dëshmorit Dalip Seferit e kishin djegur të gjallë.

Memua që dërguar nga organizata e partisë që  
të punonte me fshatarët për mbajtjen lart të moralit  
dhe për të propaganduar në të rinjtë nevojën e shti-  
mit të radhëve të çetave partizane.

Ai, si zakonisht, para se të hynte në fshat, hoqi  
malisherin nga krahu dhe e hodhi në sup. Në mes të  
fshatit qenë burra e gra, aktivistë të luftës, të ci-  
lët e dinin që do të shkonte Memua dhe e prisnin.  
Po aty kishte edhe shumë fëmijë.

Fëmijët, sa e panë Memon që larg, e njohën dhe,  
duke vrapuar në drejtim të tij, filluan të thërrisnin:  
«Erdhi «Grumi», erdhi «Grumi»!<sup>1)</sup>

— Vdekje fashizmit, shoku «Grum!» — i thanë  
të gjithë, kur i vajtën pranë.

Memua ndaloi i prekur, i përqafoi të gjithë me ra-  
dhë dhe i shikoi me kujdes. Shumica e tyre qenë zba-  
thur dhe me leckë në trup. Të ftohtit ua kishte rrë-  
qethur trupin, po ata qenë të gëzuar, të qeshur, donin  
të flisnin me «Grumin».

Memua, herën e fundit që kishte qenë në Nivicë,  
atyre fëmijëve që kishte takuar, u kishte caktuar  
detyra dhe pseudonime. Dhe tani ai i mbante mend.

— Pa na thuaj ti shoku «Barut», ç'ke bërë gja-  
të kësaj kohe? — pyeti ai një djalë dhjetë vjeç, i  
cili i qëndronte afër.

— Kam mbledhur tridhjetë e pesë fishekë për  
dyfeqet e partizanëve, — ju përgjegj djali.

— Bravo! Shumë mirë, shoku «Barut»! — i tha

---

1) Grumi — Pseudonimi i Memo Metos gjatë luftës.



Memua, pastaj u kthye nga një tjetër po i asaj moshe:

— Po ti, shoku «Shigjeta», ç'ke bërë?

— Kam qëlluar me gurë një ballist! — ju përgjegj me krenari fëmija që kishte pseudonimin «Shigjeta».

— E godite? — e pyeti Memua me buzë në gaz.

— E godita në kokë.

— Bravo, edhe ti, shoku «Shigjeta»! Po shoku «Gjerdan», ç'ka bërë? — pyeti ai një tjetër.

— Edhe unë kam mbledhur fishekë dhe një bombë për partizanët, — raportoi edhe «Gjerdani».

— Po shoqja «Trime», — ju drejtua ai një vajze të vogël, që duhej të qe nja tetë a nëntë vjeçe, — ç'ka bërë?

— Unë kam qëndisur yje për partizanët, — ju përgjegj «Trimja», e skuqur në fytyrë nga turpi.

— Shumë mirë, shumë mirë! — e lavdëroi edhe atë Memua

Pastaj ai pyeti fëmijë të tjerë që i njihte e u dinte pseudonimet dhe ata i raportuan për punën që kishin bërë. Kur mbaroi dhe po bëhej gati që të takohej me të rriturit, fëmijët, të cilët nuk i pyeti dhe që deri atëhere nuk kishin as pseudonime, as detyra nuk e lejuan të largohej.

— Po unë kush jam? — e pyeti një fëmijë i shëndoshë e faqekuq.

— Ti je shoku «Prush», — i tha Memua, pasi e shikoi fëmijën për pak sekonda.

— Po unë?

— Ti je shoku «Maliher».

— Po unë?

— Ti je shoqja «Furtuna».

Kur mbaroi së caktuari pseudonime të gjithë atyre që s'kishin dhe u vuri detyra të reja për të ardhmen, Memua u drejtoi fëmijëve pyetjet e zakonshme, të cilat ata i dinin përmendësh dhe qenë mësuar që të përgjigjeshin fort dhe menjëherë të gjithë.

— Kush jeni ju? — i pyeti Memua.

— Jemi trima partizanë, vdesim për liri, bum!

— Ç'është partizani?

— Luftëtar i lirisë!

— Kush është i lig?

— Fashizmi.

— A e luftoni ju fashizmin?

— Po-o-o!

— Rroftë Partia Komuniste!

— Rroftë!

Një punë të madhe bëri Memo Metua në fshatrat e krahinës së Kurveleshit, si dhe në krahina të tjera ku e ngarkonte partia të punonte për forcimin e pushtetit revolucionar — këshillave nacionalçlirimtare. Ai kërkonte që këshillat të ishin pasqyrë e pushtetit të ardhshëm, që anëtarët e këshillave ta justifikonin besimin e masave, të ishin luftëtarë të vendosur dhe të devotshëm për çështjen e popullit.

Interesante është vendimi i marrë nga këshilli nacionalçlirimtar i fshatit Kuç në korrik të vitit 1943. Në atë mbledhje Memo Metua mori pjesë si i deleguar i partisë dhe dha vijën kryesore për formulimin e dokumentit.

Ja disa nga pikat e atij vendimi:

«...Asnjë anëtar i këshillit nuk do t'i mungojë mbledhjes, me përjashtim kur ky ndodhet jashtë katundit, i sëmurë, më ndonjë vdekje ose dasmë...

Asnjë anëtar i këshillit nuk ka të drejtë të japë



dorëheqjen nga detyra e anëtarit, pa lajmëruar më parë para popullit arësyeën që e bën që ky të japë dorëheqjen...

Çdo anëtar i këshillit ka për detyrë, që në çdo kohë dhe në çdo vend të bëjë një propagandë të hapët të luftës së popullit, çdo anëtar duhet që t'i reklamojë këshillit të gjithë ata elementë që dyshohen për propagandë të kundërt...»

Pas nënshkrimeve të gjithë anëtarëve të këshillit të fshatit në fund është edhe firma. «Anëtar partie Memo Metua.»

Të tilla udhëzime jepte Memua edhe në fshatrat e tjera të Kurveleshit dhe afërsisht të tilla vendime merreshin kudo. Memua luftonte me këmbëngulje për forcimin organizativ të këshillave dhe për ngritjen e rolit të anëtarëve të tyre.

Nga ana e tij armiku punonte për dobësimin dhe shkatërrimin e këshillave nacionalçlirimtare. Nga një raport i Memo Metos drejtuar Komitetit qarkor të Fartisë Komuniste Shqiptare për Gjirokastrën, datë 24 korrik 1943, në pjesën «Gjendja e brendshme e çdo fshati» thuhet: «Në Kuç, megjithëse ballistët qenë të maskuar, më datën 22 korrik 1943 bënë një mbledhje të palajmëruar, vetëm me simpatizantët e tyre. U mbledh një grumbull prej 40 vetësh më e shumta kalamaj e pleq... Mbledhja kryesohej nga Hysni Leskua nga Kuçi, ish-oficer milicie. Posa u diktua mbledhja, anëtarët e këshillit dhe luftëtarët vrapuan atje. Menjëherë lajmëruan edhe «Grumin» dhe komandantin e çetës së fshatit Jaho Gjolikun... Prezenca e këshilltarëve dhe e shokëve në këtë mbledhje dhe fjala e tyre nuk u prit me kënaqësi nga ballistët... Populli filloi të akuzonte ballistët se donin ta përçanin. Më datën 23 korrik populli kërkoi të pritej çdo

relacion me ata që përkrahnin Ballin... Mëria ka arritur saqë sonte natën një luftëtar joni të rrahë kushërinë e tij, i cili përkrahte Ballin... Këtë ditë u komunikuam luftëtarëve formimin e çetës së re për plotësimin e batalionit<sup>1)</sup>. Menjëherë dualën vullnetarisht 23 veta».

Po në këtë raport gjendjen në fshatin Bolenë e përshkruan kështu: «Bolena qëndron shembull, e patundur në gjithë rajonin. Më 22 korrik 1943, Xhemil Meçua nga Smokthina, eksponent kryesor i Ballit, me një suitë të madhe agallarësh dhe intelektualësh, u paraqit në qendrën e atij katundi. Kishte kërkuar të mblidhte popullin, kishte përdorur çdo mënyrë, porse as një s'ishte mbledhur, dhe ata të paktë që ishin ndodhur, i kishin përbuzur hapët ballistët...»

Në korrespondencën e tij me qarkorin ai ngrë zërin për një konspiracion të madh dhe për një lidhje të shpejtë e të sigurtë. Në letrën e sipërme që i dërgon Komitetit qarkor të partisë për Gjirokastrën Memua shkruan: «...Janë duke na u dërguar pliko urgjente dhe konspirative me njerëz të papërgjegjshëm, të cilët i lënë andej e këndej...» Më datën 8.7.1943 Komiteti qarkor i dërgon një letër tepër urgjente dhe konspirative «Grumit», që kërkohej të gjendej më 13.7.1943 në Nivan të Zagorisë. Kjo letër mbahej nga një grua stanare nga Gusmari. Pasi shkuan atje rastësisht dy gra nga Kuçi, e morën letrën dhe më datën 17 ora 22 ja dorëzuan «Grumit».

Në letrën e tij të datës 16 korrik 1943 drejtuar qarkorit thuhet: «Plikua urgjente e dërguar nga qar-

---

1) Bëhet fjalë për batalionin «Asim Zeneli», i cili u formua më 7 gusht 1943.



kori më datën 4.7.1943 mbi formimin e Brigadës së parë dhe nxjerrjen e vullnetarëve për në këtë brigadë nga luftëtarët e kësaj krahine, arriti më datën 11 ora 21. 30... Më datën 13.7.1943 filluan konferencat në të gjitha fshatrat e Kurveleshit të Poshtëm. Më në fund dualën vullnetarë :Kuçi 16, Bolena 5, Çorraj 5, Ftera 2. Për shkak të vonesës së postës nuk mundëm të bëjmë më shumë...»

Memua, për të vënë në jetë detyrat që i ngarkonte partia, ishte gjithnjë në lëvizje. Duke bërë një jetë të tillë plot rreziqe të papritura, ai shpeshherë ndodhej ballë për ballë me vdekjen. Por, gjithnjë në raste të tilla, ka treguar një gjakftohtësi të jashtëzakonshme e një trimëri të rrallë.

Një pasdite të muajit korrik të vitit 1943, kur Memua ndodhej në fshatin e tij të lindjes, u lajmërua nga Komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën që të nisej për në Nivicë dhe të nesërmen të ndodhej atje, pasi do të takohej me disa shokë drejtues të Luftës nacionalçlirimtare të qarkut.

Në Nivicë do të bisedohej edhe një herë me disa njerëz, të cilët qenë hedhur në anën e armikut dhe kishin marrë rrugën e tradhëtisë.

Ai, bashkë me partizanin Bajram Korvafën, doli nga fshati dhe u nis lart Shurit të Kuçit që atë pasdite.

— Më mirë e heqim gjysmën e rrugës që sonte freskët, — i tha Memua Bajramit.

— Si të duash tí, — ju përgjegj partizani.

Bajrami ishte një djalë i shkurtër, me trup të shëndoshë, i fortë fizikisht dhe i shpejtë nga këmbët, po mbi të gjitha trim dhe luftëtar i vendosur për çështjen e partisë.

Rrugës Memua i fliste shokut për perspektivat e luftës dhe për të ardhmen e popullit e të Shqipërisë.

Partizani, ndërsa dëgjonte ato që i thoshte Memua, i bënte sytë katër e shikonte nga të katër anët çdo kaçubë, çdo gur e çdo trung peme. Ai e dinte mirë kush që Memo Metua dhe sa përpjekje po bënte armiku për ta vvarë atë.

Po ecnin dy trima me pushkë në krah e me zjarr në zemër. Po nëpër ferra e monopate, duke rrëshqitur fshehtazi si gjarpërinjtë, i ndiqnin edhe tetë veta të tjerë. Këta ishin të vendosur që këtë radhë të vinin në jetë patjetër planin e tradhëtisë.

Memua vazhdonte t'i fliste shokut mbi lumtërinë e popullit në të ardhmen. Kur mbërritën në një vend të bukur plot me lisa shekullorë e me shkëmbinj të mbëdhenj, Memua, papritur, u ndal, u ul mbi një gur dhe nxori blokun e tij nga xhepi, stilografin e zi të zbukuruar me vijëza ngjyrë ari dhe nisi të shkruante.

Bajrami, i habitur nga kjo qëndresë, u bë kurreshtar dhe ju afrua Memos. Partizani e pa që ai po shkruante një vjershë të re. Nuk që hera e parë që Memua, duke qenë në ecje, papritur, ndalonte e shkruante diçka... Ai për vjershat e tij e gjente frymëzimin në aksione, në popull, në natyrë. Ulej, pra, mbi një shkëmb a mbi një trung druri, vinte pushkën para gjunjëve dhe shkruante vjershën, e cila pas disa ditësh mësohej e këndohej nga populli.

Aty nga muzgu i mbrëmjes të dy luftëtarët mbërritën në Buzë të Këmbëzit, në stanin e një plaku patriot nga Gusmari. Plaku u gëzua shumë për vajtjen e partizanëve dhe bëri çmos për t'i kënaqur ata. Memon e çmonte populli dhe e ruante nga e liga, prandaj edhe i zoti i stanit mori masa të sigurta që të mos mundnin të vinin njerëz pa u diktuar...

Nata ishte e errët, vetëm lart në kupën e qiellit



ishin derdhur yjet si rruaza të arta në një copë ka-  
difeje. Zjarri në vatrën e stanit jepte dritë, po dhe  
biseda e luftëtarëve të lirisë me plakun patriot qe e  
ngrohtë. Gjatë kësaj kohe armiqtë po afroheshin për  
të kryer krimin. Mirëpo ata u diktuan nga plaku Re-  
xhep, i cili duke biseduar me Memon, mendjen dhe  
veshët i kishte gjetkë dhe ndiqte çdo lëvizje që  
ndodhte rreth e qark. Me t'u diktuar, armiqtë u largu-  
an dhe humbën në errësirën e natës.

Të nesërmen, Memua bashkë me partizanin, duke  
ecur me kujdes nga ajo rrugë që i porositi plaku, nga  
ora 10 para dite mbërritën në Nivicë.

Aty, bashkë me të dërguarit e qarkorit filluan  
punën.

Ishte pasdrekja e asaj dite. Dielli qe ulur mbi  
malin e Kebuzit, hija qe zgjatur. Memua, pasi e plo-  
tësoi detyrën, u nis së bashku me Bajramin për t'u  
kthyer në Kuç, ku e priste një detyrë tjetër e rëndë-  
sishme e ngarkuar nga partia.

Prapë para tij qenë tradhëtarët. Ata tani i ki-  
shin bërë planet më të studjuara dhe kishin marrë  
të gjitha masat që ai të mos u shpëtonte dot më dhe  
të mos mbetej gjallë. Ata, duke ditur rrugët e kthimit  
për në Kuç, kishin organizuar tri prita: Një nga  
mali i Gusmarit, një nga Qafa e Gomares dhe një  
në Shur të Kuçit.

— Nga do të kalojmë? — e pyeti Memua parti-  
zanin kur mbërritën në Gusmar.

— Nga të duash, — ju përgjegj shkurt shoku.

— Ti s'më ndjek dot të kalojmë nga mali i Gus-  
marit, — bëri shaka Memua, sepse të ngjiteshe andej  
qe më zor.

— Shiko nga është më mirë, — ju përgjegj sho-  
ku, — pa për mua mos ki merak.

— Më mirë po shkojmë nga Shuri, — i tha Memua.

Ai dyshonte për ndonjë pritë nga ana e armikut dhe zgjodhi si rrugë atë më të zakonshmen, të cilën armiku nuk duhej ta vlerësonte edhe aq. Atij s'i shkonte mendja se genë organizuar tri prita.

Vazhduan rrugën. Pas pak zbritën në Shur. Ecnin më të poshtë me hapa të shpejta se donin të mbërrinin sa më parë në Kuç. Memua shkonte në krye. Prita e diktoi atë që larg. Grykët e pushkëve që nga prapa një shkëmbi po ndiqnin lëvizjen e tij. Gishtat e tradhëtarëve qëndronin në këmbëz, kurse sytë në shëqekës.

Grykët e pushkëve të tradhëtarëve ishin nja njëzet metra larg gjoksit të Memos. Ai ndodhej tani në pikën më të afërt, por tradhëtarët ja kishin frikën ta qëllonin drejt, e pritën që ta godisnin pas shpine. Të dy partizanët i kthyen shpinën shkëmbit të rëndë e të errët. Një bataré pushkësh prishi qetësinë e atyre maleve. Krismat ngjanë si shkrepëtima e rufesë në ditën me diell.

Me bataren e parë Memos i prishën pushkën, se plumbi kishte goditur sigurecën e shulit. Maliheri i tij kishte dalë jashtë përdorimit. Me batarenë e dytë Memua u godit në kokë, kurse partizanit i thyen krahun.

Memua mbeti në këmbë në atë vend të zbuluar duke manovruar për t'u shpëtuar plumbave të armikut e duke u munduar të hapte shulin e maliherit. Por kjo qe e pamundur. Atëhere ai u shtri pas një guri të vogël, që u ndodh aty, dhe ja filloi luftës me revolver. Partizani, megjithëse i plagosur rëndë, u hodh me shpejtësi në drejtim të armiqve, u doli atyre anash dhe ja filloi luftës. Ai, për shkak të plagës, e



përdorte me zor pushkën, megjithatë qëlloi shtatë herë kundër armiqve dhe i detyroi ata të iknin, pa ja mbërritur plotësisht qëllimit.

Në atë pritë çdo njëri nga armiqtë shtiu rreth pesëmbëdhjetë herë kundër Memos dhe disa herë kundër shokut të tij. Por trimëria dhe gjakftohtësia e Memos dhe e partizanit që e shoqëronte bënë që edhe këtë radhë tradhëtarët të dështonin në planin e tyre kriminal.

Kush ka patur rast të ketë kaluar nga ato shtigje dhe veçanërisht nga vendi ku ju ngrit prita Memos, në Shurin e Kuçit, e kupton që shpëtimi është i pamundshëm. Po ja që për trimat dhe luftëtarët e lirisë s'ka gjë të pamundur! Duhet të ishe trim si Memua dhe partizan si Bajram Korvafa që t'u shpëtoje plumbave të armikut dhe veç asaj të fitoje duke e vënë atë në ndjekje.

Kur u larguan armiqtë të dy shokët u bashkuan prapë. Memua në fillim nuk e vuri re që shoku i tij që i plagosur, sepse partizani mundahej të mos e tregonte veten. Përveç kësaj po ndiqte me sy largimin e armiqve, sepse kishte hall se mos ata ktheheshin prapë. Memua në fillim i foli atij rreptë, i pakënaqur që nuk mundën t'i asgjësonin, po i lanë të iknin. Ai nuk qortonte vetëm shokun, po edhe veten e tij. Por kur e pa atë të gjakosur dhe me krahun e thyer, u prek shumë dhe e përqafoi. Pastaj shpejt e shpejt grisi një rrip të gjerë nga fundi i këmishës së tij dhe ja lidhi plagën.

U nisën prapë poshtë, për në fshat. Jo shumë larg pritës takuan një nga përkrahësit e ballistëve, i cili kishte ardhur aty të mësonte i pari lajmin e vrasjes së Memo Metos dhe të çonte sihariqin atje ku duhej. Kur ai pa Memon vetë bashkë me shokun

e tij që po ecnin kryelartë, edhe pas gjithë atyre armëve që dëgjoi, uli kokën dhe u kthye mënjanë.

— Kush mbjell erën, korr furtunën! — i thirri atij Memua, dhe fjalët e tij jehuan si një paralajmërim për tradhëtarët e Ballit Kombëtar.

Memua edhe gjatë kësaj periudhe të fundit të jetës të tij, megjithëse i ngarkuar me detyra të shumta partie, asnjëherë nuk e la pas dore edhe poezinë. Pena e tij ishte vënë plotësisht në shërbim të luftës dhe vjershat që dilnin nga dora e tij ngrinin lart idetë e mëdha të partisë dhe demaskonin me forcë qëllimet e errëta të armikut. Gjatë kësaj periudhe në vjershën e tij të bukur «Avazi i zogjve» duket sikur e frymëzon natyra, por menjëherë del në pah qëllimi i tij i vërtetë, për të ngritur një këngë të bukur për çetat partizane.

*Poeti ja fillon:*

*Majës malit po dëgjohet*

*zëri i thëllëzës,*

*Zëri i bilbilut në pyje*

*në burime rrezës,*

*Që të dy ja thonë këngës*

*me plot mallëngjim,*

*Sikur po i thonë botës:*

*«Ngrehu në kushtrim...»*

Dhe më poshtë:

*Dy bilbila po ja thonë*

*përtej asaj ane,*

*Sikur nisin në betejë*

*çetën partizane...*

*Majës pemës mbi blerime*

*bilbili këndon,*



Nën hijen gjelbërore  
çeta po vrapon.  
Çetës lodhur, të përgjumur  
që bëri aksion,  
Bilbili për ta shpëlodhur  
sipër i këndon...

Në vjershën e bukur që u kushtohet vajzave që dualën partizane, ai ngrë lart të rejat shqiptare që rrëmbyen armën për të luftuar krah për krah burrave. Si kjo vjershë ashtu edhe vjershat e tjera të Memos gjetën një përhapje të madhe në popull dhe luajtën një rol agjitativ jo të vogël në mobilizimin e vajzave e grave në luftën e madhe të çlirimit.

Ja si flet vajza që do të dalë partizane:

Dua armë e municion  
se do shkoj,  
Dhe unë e urrej fashizmin  
do luftoj!  
Jam një vajzë shqipëtare  
vajzë malit,  
E kam forcën, e kam zemrën  
si të djalit...

Vajza thotë se edhe ajo është e fortë si një djalë, mund të përdorë njëloj si edhe djali pushkën dhe bombat, mund të durojë shiun, breshërin, furtunën edhe në malet më të larta, sepse, siç thotë vetë:

Duroj se dua lirinë  
e Mëmëdheut,  
Dhe flamurin kuq e zi  
të Skënderbeut...

## IX. BESNIK NDAJ POPULLIT E PARTISË GJER NË VDEKJE

Në shtator të vitit 1943 Italia fashiste kapitulloi. Para Partisë dhe Frontit Nacionalçlirimtar dilte një problem shumë i rëndësishëm dhe delikat. Ushtria e pushtuesit duhej të detyrohej t'i dorëzonte armët Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me të cilën ajo kishte qenë në luftë. Mirëpo reaksioni, i cili jo vetëm nuk kishte hedhur asnjë pushkë kundër pushtuesit, por, përkundrazi, kishte qenë edhe në shërbim të tij, u hodh në aktivitet për ta paraqitur veten sikur kish-te luftuar e derdhur gjak.

Partia veprroi shpejt, mblodhi gjithë forcat dhe i vuri përballë ushtrisë italiane, duke kërkuar dorëzimin e reparteve italiane me të gjitha armatimet dhe materialet e tjera që dispononin.

Shtabi i Zonës së parë operative Vlorë-Gjiro-kastër bëri planin e detajuar të çarmatosjes së forcave italiane, të cilat ndodheshin të dislokuara në disa garnizone, sidomos në atë të Gjirokastrës, Sarandës dhe Himarës. Sipas këtij plani, Memo Metua u cak-tua të drejtonte forcat që do të çarmatosnin trupat italiane të Himarës dhe Porto-Palermos.

Gjatë zhvillimit të këtij operacioni Memua tregoi aftësi prej drejtuesi dhe organizatori. Ai me forcat



që i ishin vënë në dispozicion jo vetëm që mundi t'i çarmatoste repartet italiane që qenë atje, po vendosi edhe një rregull të rreptë në grumbullimin e materialeve të zëna armikut si dhe në tajtimin e rojëve të shumtë.

Në këtë kohë ushtrisë fashiste italiane po ja zinte vendin një ushtri tjetër pushtuese, ushtria hitleriane. Pushtuesi i ri u prit kudo me luftë të ashpër. Në zonën ku ndodheshin forcat që drejtonte Memo Metua, ushtria gjermane erdhi nga Vlora dhe, pasi hyri në Himarë, u drejtua për në Porto Palermo.

Lufta u ndez e ashpër. Kundër kolonave të shumta të armikut, forcat partizane, që kishin në krye Memon, vunë në veprim bateritë e artilerisë bregdetare që kishin pasur italianët, duke i përdorur topat me qitje direkte kundër tankeve. Forcat e armikut u thyen dhe për një kohë të gjatë nuk mundën të kalonin në atë rrugë.

Gjatë luftimeve që u zhvilluan në manastirin e Ksamilit, veç të tjerëve dha jetën edhe komunisti nga Kuçi Sadik Rustua. Memua u prek shumë nga humbja e shokut dhe pas ca ditësh luftëtarët e lirisë këndonin këngën e trimit partizan, të shkruar nga Memo Metua, në stilin që vajtojnë gratë labe.

*More urdhërin e shkove,  
Korba, korba Sadiko,<sup>1)</sup>  
Afër Sarandës qëndrove,  
Hoqe pushkën e qëlllove,  
Kur e pe që ti mbarove,  
Flamurin e kuq kujtove,  
Ngrite grushtin dhe nderove.*

---

1) Përsëritet pas çdo vargu.

Pas këtyre ngjarjeve Memo Metua u caktua sekretar politik i partisë për krahinën e Kurveleshit. Më tepër se çdo herë tjetër, ai tani një rëndësi të dorës së parë i jepte punës për forcimin e vazhdueshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Memua mbledhte organizatat e rinisë nëpër fshatra, fliste me të rinjtë dhe shtronte nevojën e hedhjes së tyre në rreshtat partizane. Për këtë qëllim bënte konferenca me popullin e zhvillonte mbledhje me këshillat. Si përfundim i këtyre përpjekjeve, grupe të rinjsh dhe të rejash niseshin për në repartet partizane.

Gjatë organizimit të Grupit të parë të Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër, Memua punoi me mish e me shpirt. Ky grup në fillim përbëhej nga dy batalione partizane të vjetra e të njohura «Asim Zeneli» e «Perlat Rexhepi»; por me vendim të shtabit të zonës, këto batalione u caktuan për në reparte të tjera, prandaj u desh që ky grup të riorganizohej nga e para e të shtoheshin radhët me partizanë të rinj.

Gjatë dy muajve të fundit të vitit 1943 Memo Metua dhe shokët e tjerë të partisë, që vepronin në këto zona, kaluan në të gjitha fshatrat e Kurveleshit, Kardhiqit e pjesërisht të Tepelenës dhe me një punë të madhe propagandistike dhe agjitative arritën të siguronin forcat e nevojshme për riformimin e grupit. Pas riorganizimit Grupi i parë u bë një repart i rëndësishëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili më pas tregoi qëndresë të lartë dhe shpirt luftarak gjatë ndeshjeve me armikun.

Metodat e punës së Memos me të rinjtë dhe të rejat qenë të thjeshta, të kuptueshme, të afërta për zemrat e të rinjve. Ai i shtronte drejt çështjet. Pasi



fliste me zjarr e plot frymëzim për aktet heroike të rinisë dhe të partizanëve vazhdonte:

— Ka ardhur koha të hidhemi të gjithë në luftë, — u thoshte ai të rinjve, pastaj shtronte pyetjen: — Ka nga ju që s'duan të dalin partizanë? Le të ngrejë dorën kush nuk ka dëshirë.

Kur ai shikonte se asnjë nuk e çonte dorën, i gelur dhe i qeshur në fytyrë thoshte:

— E shikoni? — të rinjtë tanë janë revolucionarë të vërtetë dhe shkojnë atje ku i kërkon partia!

Pastaj Memua shpjegonte se këtë radhë nuk mund t'i dërgonin të gjithë në çetë dhe vetë caktonte kush nga vullnetarët do të shkonte menjëherë e kush më vonë.

Në muajin dhjetor të vitit 1943 në Poliçan të Pogonit u mbledh Konferenca e Këshillit nacionalçlirimtar të qarkut të Gjirokastrës, në të cilën morën pjesë delegatë nga të gjitha krahinat e qarkut. Konferenca pati një rëndësi të madhe për zgjerimin e mëtejshëm të luftës në qark, për forcimin e këshillave nacionalçlirimtare, për ngritjen e rolit të tyre si organe të pushtetit të ri të dalë nga revolucioni popullor, si dhe për t'i dhënë një mbështetje më të madhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila tani po kalonte në formacione më të mëdha.

Memo Metua mori pjesë në konferencë si një nga përfaqësuesit e krahinës së Kurveleshit dhe foli aty në emër të popullit të asaj krahine. Midis të tjerave, ai i siguroi pjesëmarrësit e konferencës, se populli i Kurveleshit do të qëndronte edhe në të ardhmen i papërkulur dhe besnik gjer në fund ndaj Partisë Komuniste Shqiptare dhe Frontit Nacionalçlirimtar.

Memua nuk i ndante fjalët nga veprat. Ai vep-

ronte gjithnjë sipas porosive dhe mësimëve të partisë dhe godiste me forcë çdo shkelje që mund të bëhej prej çdo njeriu goftë.

Aty nga fillimi i vitit 1944 disa forca të Grupit të parë kishin shkuar në fshatin Kardhiq. Aty qenë shtëpitë e disa ballistëve, të cilët prej kohe ishin tre-guar shumë aktivë kundër Luftës nacionalçlirimtare. Sidomos, gjatë operacionit të dimrit, ata dhe bashkëpunëtorët e tyre kishin djegur shumë banesa në fshatrat e Kurveleshit.

Komanda e repartit partizan, që vepronte në këto anë, vendosi të digjte shtëpitë e disa ballistëve që ishin nga krerët e reaksionit në këtë zonë. Urdhëri u dha. Partizanët, pasi nxuarën plaçkat jashtë, i vunë zjarrin shtëpisë së parë. Tymi dhe flaka u ngjiten lart.

Kur çatia e shtëpisë po binte copa-copa dhe çdo gjë po merrte fund, u pa një njeri të hynte me nxitim në fshat. Ky njeri ishte Memo Metua, që vinte nga Fushë-Bardha. Ai ecte shpejt. Djersa i kullonte nga balli dhe gjoksi i hidhej përpjetë nga frymëmarrja e thellë.

— Partizan! Partizan! — i thirri ai sa doli mbi fshat një partizani që ishte roje aty afër.

— Urdhëroni shoku «Grum» — ju përgjegj partizani, që e njihte Memon.

— Çka ndodhur? Ç'është ky zjarr në fshat?

— Po djegin shtëpitë e ballistëve.

— Me ç'urdhër?

— Komanda ka dhënë urdhër.

— Sa shtëpi janë djegur?

— Deri tani një.

Memua vrapoi më të poshtë. Në anë të kalasë së lashtë, atje ku kishte qenë më parë një shtëpi për-



dhese, tani po dilte tym, muret qenë nxirë e në kopsht, ku qenë kthyer përmbys disa koshere ble-tësh, qenë hedhur plaçkat e nxjerra jashtë.

Memua qëndroi për një kohë në këmbë pa folur. Po mendohej. Sytë i kishte ngulur në truallin e nxirë, ku dilte ende tym.

— Thuajuni të vinë këtu komisari dhe komandanti, — urdhëroi ai pas një heshtjeje të shkurtër.

Komisari dhe komandanti nuk e kishin të lehtë që t'i qëndronin zemërimin të tij për këtë urdhër që kishin dhënë.

— Pse digjni shtëpi? — i pyeti shkurt Memua ata.

— Janë të kriminelëve me damkë... — ata deshën të thoshin emrat e kriminelëve, por ai nuk i la të vazhdonin.

— E pastaj?

— Edhe ata kanë djegur shtëpitë tona.

— Po, kanë djegur, nuk e mohon njeri. Po ju si ata do të bëni, apo si na mëson partia?

Komandanti dhe komisari, që kishin dhënë urdhërin për djegjen e shtëpisë, mbetën pa thënë asgjë, kurse Memua vazhdoi:

— Ballistët janë armiq, tradhëtarë, kriminelë, banditë! Kurse ne jemi partizanë. Ne nuk djegim shtëpi, atyre që largohen nga zona e lirë, jau marrim shtëpitë dhe strehojmë në to fshatarët që janë pa strehë.

Pastaj u foli gjatë partizanëve të repartit për figurën morale të luftëtarëve të lirisë dhe për sjelljet e tyre ndaj popullit.

Nga fundi i muajit shkurt 1944 batalioni «Baba Abaz» i Brigadës së gjashtë sulmuese kaloi nëpër fshatrat e Kurveleshit të Sipërm dhe mbërriti në Kuç.

Ishte dimër i fortë, bora në rrugën nga kaloi batalioni që e madhe. Partizanët me vështirësi mundën të kalonin Qafën e Kreshës dhe qenë të lodhur nga rru- ga e gjatë e nga moti i keq. Situata në përgjithësi që e rëndë. Operacioni i dimrit sapo kishte marrë fund. Në Kurvelesh qenë djegur shtëpi të tjera, po- pulli kishte mbetur pa strehë e pa bukë, kishin rënë në fushën e luftës të tjerë djem e vajza e të tjera nëna kishin lidhur shaminë e zezë për gushe. Me gjithë këto morali i popullit po qëndronte lart. Edhe pas operacionit, të tjerë djem e vajza muarën armët dhe shkuan në repartet partizane. Burra dhe gra pu- nonin ditë e natë për të kaluar vështirësitë që krijoi armiku, ndërtonin në vend të shtëpive kasolle për të banuar përkohësisht. Të gjithë i ngrohte fjala e partisë dhe sukseset e partizanëve në luftën kundër push- tuesve dhe tradhëtarëve.

Memo Metua, sekretari politik i partisë për kra- hinën, bashkë me shokët e tjerë, ndodhej përditë mi- dis popullit. Ai, me fjalën e tij të zjarrtë, bënte që populli të mos i ndjente shumë vuajtjet, por të mo- bilizonte të gjitha forcat e tij për të kapërcyer vësh- tirësitë.

Ardhja e batalionit «Baba Abaz» në Kurvelesh në atë kohë dhe morali i lartë i partizanëve, të cilët, megjithëse të lodhur nga luftimet e gjata e nga mar- shimet, ja merrnin këngëve revolucionare sa hynin në çdo fshat, e frymëzoi Memo Meton që të shkruante në atë kohë «Këngën e Brigadës së gjashtë», e cila u bë gjatë luftës një nga këngët më të njohura në La- bëri dhe që këndohej kudo edhe nga partizanët e bri- gadave të tjera.

Memua e fillon këngën e tij duke ju drejtuar nënës Shqipëri.



*Dil nëno të shikosh jashtë,  
moj nëno, nëne!  
Si lufton Brigada e gjashtë,  
moj nëno, nëne!  
Dil nëno të shikosh tanët,  
moj nëno, nëne!  
Gushëverdhë partizanët,<sup>1)</sup>  
moj nëno, nëne!*

Ç'kontrast i madh midis këtyre djemve të popullit dhe armiqve të Ballit Kombëtar!

*Dil shiko këta të djallit,  
moj nëno, nëne!  
Këta katilët e Ballit,  
moj nëno, nëne!..*

Këngën e Brigadës së gjashtë Memo Metua e këndoi vetë për herë të parë me një grup partizanësh të batalionit «Baba Abaz» te Bregu i Dërstilës.

Ishin ditët e fundit të muajit mars të vitit 1944. Memo Metua, me një automatik italian në sup, me një pardesy të vjetëruar nga koha dhe me një bustinë me strehë, në të cilën qe qepur një yll i kuq, i qëndisur bukur nga shoqet partizane, po kalonte nëpër fshatrat e Kurveleshit, Tepelenës, Kardhiqit dhe Rrëzomës...

Shtabi i Përgjithshëm kishte dhënë urdhër për formimin në qarkun e Gjirokastrës edhe të një formacioni tjetër të rëndësishëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Brigadës së tetë sulmuese.

Komiteti qarkor i partisë për Gjirokastrën e kish-

---

1) Partizanët e Brigadës VI mbanin në qafë shami të verdha.

te ngarkuar Memon që të merrej me nxjerrjen e partizanëve të rinj për brigadën, e cila do të përbëhej si nga partizanë të vjetër, efektivë të grupeve të Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër, ashtu edhe nga partizanë të rinj, të cilët duhej të hidheshin sa më parë në rreshtat partizane.

Për këtë qëllim Memua po kalonte nëpër fshatra dhe po zhvillonte biseda e konferenca me të rinjtë e me popullin dhe bënte mbledhje me këshillat nacionalçlirimtare. Shumë djem dhe vajza rreshtoheshin në kompanitë e reja që u shtoheshin batalioneve.

Në fund të muajit mars Memua mbërriti në Fushë-Bardhë. Në këtë kohë aty ndodheshin një batalion i Brigadës së gjashtë dhe një batalion i Grupit të parë të Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastër. Ai me këta të dy batalione organizoi një konferencë. Fjala e tij qe e frymëzuar dhe e zjarrtë. Memua dha një tablo shumë të qartë të luftës në frontet e ndryshme dhe të situatës në vendin tonë. Era e fitores që po afrohej e bënte atë që të fliste me një zjarr të rrallë. Ata që e dëgjuan atë fjalim të Memo Metos nuk mund të harrojnë se me sa dashuri foli ai për Partinë Komuniste Shqiptare, për vijën e drejtë të saj, për sukseset e Luftës nacionalçlirimtare. Kjo konferencë mbahet mend nga ata që e dëgjuan dhe nuk harrohet, jo vetëm mend nga ata që e dëgjuan dhe nuk harrohet, jo vetëm sepse Memo Metua bëri atë ditë një nga ligjëratat e tij më të frymëzuara, por edhe se kjo qe konferenca e tij e fundit para partizanëve dhe partizaneve...

Që nga Fushë-Bardha Memua kaloi në fshatra të tjera, dhe më në fund mbërriti në Fterë dhe Çorraj. Armiqtë që prej shumë kohësh e ndiqnin këmba-këmbës. Ata kishin organizuar një bandë, ku merrnin pjesë kriminelë të stërvitur në kushedi sa krime dhe



Kishin mundur ta kalonin fshehtazi atë në zonën e lirë të Kurveleshit. Kjo bandë vrojtonte lëvizjet e Memos me qëllim që të organizonte edhe një pritë tjetër kundër tij.

Banda u informua që Memo Metua kishte mbërritur në Fterë e Çorraj dhe së andejmi do të kthehej me siguri në Kuç. Prandaj, njerëzit e bandës zunë prita në vende më të përshtatshme nga do të kalonte ai patjetër. Prita kryesore u vendos në mes të rrugës që kalonte nga fshati Kuç për në një bazë kryesore të partisë larg fshatit, në vendin e quajtur Shkëmbi Manale te gryka e Shurit.

Memua mbërriti në fshatin Kuç aty nga pasdrekja dhe qëndroi te kroi afër rrapit të madh. Atje u takua me shokët dhe bisedoi me ta për problemet që kishin përpara. Meqë ishte shumë i lodhur nga rruga e gjatë, ai kishte ndër mend të shkonte diku aty afër për t'u çlodhur, në ndonjë shtëpi. Në këtë kohë e lajmëruan se në bazën e partisë në Plihër kishte ardhur Qazim Kondi nga shtabi i Zonës së parë operative Vlorë-Gjirokastrë. Memua mendoi se ardhja e tij mund të kishte lidhje me ndonjë detyrë të re të rëndësishme. Ndaj nuk pushoi fare, por hodhi automatikun në sup dhe bashkë me partizanin Munedin Malaj u nis për atje. Fshatarët e lutën që të qëndronte aty atë mbrëmje dhe të shkonte të nesërmen i shoqëruar prej tyre. Shahe Lucaj pjesëmarrëse e vjetër e Luftës nacionalçlirimtare, i doli para në rrugë dhe nuk desh ta linte që ai të nisej aq vonë për rrugë.

— Mos shko në Plihër në këtë kohë se mos të kanë zënë pusi armiqtë. Ti e di që armiqtë ty të ruajnë të të vrasin, — i tha Shahja dhe shtoi: — Në kë ndonjë letër ma jep ta shpie.

— Mbi të gjitha është puna e partisë. — ju përgjegj Memua dhe, pasi u përqaftua me të, vazhdoi rrugën.

Kaloi lumin dhe u hodh përtej në drejtim të Gjomitës.

Ishte data 2 prill 1944. Gjethet sapo kishin çelur. Bora nga malet po shkrinte. Bari kishte mbuluar gjithëhaka për reth. Natyra kishte shtruar qilimin e saj të gjelbër e me lule shumë. Çdo gjë po qeshte!

Memua, duke u ngjitur një të përpjete, po shikonte e s'po ngopej së pari natyrën e bukur. Zemra e poetit ndjehej e lehtë. Ai me zë të ulët po përsëriste vargjet e këngës së njohur popullore:


*Hyri prilli e shkriu bora  
maleve,  
Maleve bie këmbora,  
maleve...*

Ai po ecte i qetë dhe mendohej për punën e madhe që e priste, për brigadën e re që po formohej, për fitoren e afërt të revolucionit popullor, të cilit ai i kishte kushtuar gjithë jetën e tij.

Ndodh që ulesh mbi ndonjë kaçube për t'u çlodhur pak. Po aty në atë kaçube, mbi të cilën je ulur, ka një ose disa nepërka shullëri të hidhura e tërë helm. Ti rri i qetë, sepse s'di gjë, ndërsa ato lëvrijnë, lëvizin, rrëshqasin pa zhurmë, afrohen... Ti rri i qetë sepse s'di gjë dhe nuk ndjen gjë, sepse nepërkat rrëshqasin pa bërë zhurmë, mirëpo ato lëvizin, afrohen gjithnjë e më shumë...

Memua doli në një qafë. Ai me kokën lart, ash-





Revolveri dhe stillografi i Memo Metos

tu si e kishte zakon të ecte, vazhdoi rrugën. Po hapi i tij mbeti në vend. Rruga e jetës ju ndërpre...

Një batare pushkësh nga shumë drejtime e goditi atë. Pasuan batareja e dytë, e tretë, e katërt e pestë... Armiqtë qenë shumë dhe që të gjithë po qëllonin mbi trimin, i cili u kishte shpëtuar disa herë kurtheve të tyre. Ata edhe tani nuk besonin se mund ta vrisnin Memo Meton, prandaj po qëllonin e po qëllonin pa pushim. Gjashtë plumba e kishin goditur në gjoks dhe tre në kokë, por ai, edhe i përshkuar nga plumbat e tradhëtarëve, qëndroi në këmbë e qëlloi me automatik kundër armiqve, gjersa mbaroi edhe fishekun e fundit, nga tri karikatorë që kishte me vete. Atëhere pushoi së rrahuri zemra e luftëtarit të lirisë.

Atje ku e goditën plumbat Memon, yje gjaku rodhën nga trupi i tij dhe u derdhën në tokën e mbuluar nga bari i bleruar.

Shahja i dëgjoi armët dhe menjëherë briti për të dhënë alarmin; pastaj ajo me dy plaka të tjera vrapuan te vendi ku i qe zënë pritë Memos. Armiqtë nuk i lejonin ato të afroheshin, duke i qëlluar disa herë me pushkë. Ata kishin qëllim që të bindeshin se Memua kishte vdekur dhe pastaj t'i prisnin kokën e ta merrnin me vete. Aq e madhe qe urrejtja e armikut për Memo Meton!

Pas vrasjes së Memo Metos, urrejtja e papërmbajtur popullore për armiqtë, hakmarrja popullore u shfaqën me tërë forcën e tyre. Haka e luftëtarit të pamposhtur të lirisë u muar. Një partizan i vjetër, me këtë rast, tha: «Ne e muarëm gjakun e Memo Metos. Por armiqtë nuk kanë aq gjak sa të paguajnë për Memon».

Kuçi revolucionar, Kuçi i partisë, i cili u ngrit



që në fillim në këtë luftë të shenjtë dhe dha për çështjen e çlirimit të popullit e të atdheut shumë bij dhe bija të tij, e përcolli Memon me grusht të shtrënguar në banesën e tij të fundit. Bashkëfshatarët dhe shokët e tij të luftës i dhanë nderimet e fundit kundërshtarit të regjimit të Zogut, luftëtarit kundër pushtuesit fashist dhe tradhëtarëve të vendit, propagandistit dhe organizatorit të zot të Luftës nacionalçlirimtare atje ku e kishte caktuar partia, oratorit të flaktë, poetit revolucionar me talent, masovikut të njohur, sekretarit politik të partisë për krahinën e Kurveleshit.

E motra e tij, Hetemja, e prekur shumë nga vdekja e parakohshme e vëllait të saj të dashur, kallëzonte atë ditë: «Një herë vura re midis flokëve të Memos një fije ngjyrë argjendi dhe i thashë: «Memo! Kur do të të shohë motra me nuse?» Memua m'u përgjegj me buzë në gaz: «Pse nuk e njuh nusen time ti? Ja shikoje sa e bukur është» — dhe më tregoi maliherin që mbante në dorë. Pastaj shtoi: «Të qërojmë një herë hesapet me pushtuesin, të çlirojmë popullin nga shtypja, pastaj do të shikojmë edhe për nuse»...

Për merita lufte Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar Memo Meton me «Urdhërin e Flamurit», «Urdhërin Ylli Partizan», «Urdhërin e Trimërisë», «Medaljen e Kujtimit», «Medaljen e Trimërisë» dhe «Medaljen e Çlirimit».

Në Muzeumin e Luftës nacionalçlirimtare në Tiranë njerëz të moshave të ndryshme shkojnë e shikojnë fotografi, dokumenta, makete, skica, harta, armë, që janë përdorur nga partizanët dhe njësitet guerile kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve, materiale të ndryshme propagandistike që ka përdorur partia

e të tjera. Një vend të rëndësishëm zënë në muze te-shat dhe sendet e tjera personale, që janë përdorur nga heronjtë dhe dëshmorët, shumë prej të cilave janë të përshkuara nga plumbat dhe predhat e armiqve dhe të gjakosura.

Në katin e dytë të muzeumit, në mes të sallës së madhe, në një vitrinë të bërë bukur dhe të mbuluar me xham, pranë njëri-tjetrit ndodhen të vendosur një revolver i vogël dhe një stilograf i zi, trupi i të cilit është zbukuruar me vijëza ngjyrë ari. Këto janë sendet personale të përdorura nga Memo Metua. Memua luftoi me pushkë dhe me pendë. Prandaj, revolveri i tij bashkë me stilografin shprehin më së miri partizanin, revolucionarin dhe poetin!

Shumë vizitorë të Muzeut të Luftës qëndrojnë gjatë para asaj vitrine, ku është stilografi i zi dhe revolveri i Memo Metos. Dhe përfytyrojnë aty gjithshka kanë dëgjuar dhe lexuar për të. Para tyre ngrihet oratori i flaktë, trimi i maleve të Labërisë dhe poeti që i këndoi natyrës, dashurisë dhe mbi të gjitha shoqëve dhe shoqeve partizane!

Të shumta qenë këngët që këndoi populli për Memo Meton. Vjershëtorët popullorë i kushtuan atij vjersha nga më të bukurat, të cilat u kënduan atëhere, këndohen sot dhe do të këndohen edhe në të ardhmen. Shumë shkrimtarë e poetë të vjetër e të rinj kanë marrë penën dhe kanë shkruar artikuj, vjersha e poema për Memo Meton.

Emëri dhe vepra e Memo Metos si poet revolucionar, në disa raste, është njohur edhe jashtë kufive të Shqipërisë. Një shkrimtar i huaj, duke folur për letërsinë shqipe, ve në dukje se shkrimtarët shqiptarë jetojnë jetën e popullit dhe në luftën heroike të këtij populli për pavarësi, për liri e për ndër-



## PËRMBAJTJA

	Faqe
Tri të shtëna pushke (në vend të parathënjes ..	7
I. Fëmijni e hidhur .....	10
II. Duke kërkuar shtigje të reja në jetë .....	22
III. Kundër regjimit tiranik të Zogut .....	31
IV. Veprimtaria e tij pas pushtimit fashist të vendit	37
VI. Partia i tregon rrugën .....	47
VI. Kurveleshi ja bëri forra! .....	76
VII. Aktiviteti i tij jashtë krahinës së Kurveleshit ..	91
VIII. Çdo gjë për luftën, çdo gjë për partinë e për popullin .....	104
IX. Besnik ndaj popullit e partisë gjer në vdekje ..	119